

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR AFTËSINË E KUFIZUAR





PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR AFTËSINË E KUFIZUAR

Qershor 2024

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Rr. "Bogdani"

Nr. 1, Tiranë

Tel/Fax: +3554269426

www.adrf.al

E-mail: adrf@albmail.com

Përmbajtja e Lëndës

HYRJE	7
KREU I	
VENDIME NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE	9
1. Çështje e ndjekur kryesisht nga Komisioneri.....	9
2. Fondacionit “Së Bashku”, kundër Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Mat....	12
3. S.K., kundër operatorit të transportit urban “Remi Trans” sh.p.k	15
4. Fondacionit “Së Bashku”, kundër Bashkisë Durrës dhe Operatorëve që ofrojnë shërbimin e transportit publik, Durrës.	18
5. V. K., kundër Ministrisë së Brendshme dhe ALEAT sh.p.k.	22
6. S. L., kundër Bashkisë Tiranë	26
7. D. N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.	29
8. Shoqata “Shpresë për të verbërit”, kundër Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë Shpresa-AI sh.p.k.	33
9. F. S. dhe F. E., Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë së transportit qytetas “Urban Trans Vlorë” sh.p.k.....	36
10. Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a (Zyra Postare Hardhisht).....	39
11. Fondacioni “Së bashku” kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	44
12. Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a (Zyra Postare Qendër Durrës).....	48
13. Fondacioni Së bashku kundër Bashkisë Durrës, Bashkisë Shijak, Bashkisë Krujë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).....	53

14.	Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë kundër Bashkisë Tiranë	59
15.	S.L kundër Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor (TKOBAP)	63
16.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës së Postës Shqiptare sh.a., në qendër të Bashkisë Shijak	67
17.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës së Postës Shqiptare sh.a., në qendër të Njësisë Administrative Sukth.....	70
18.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Kamëz.....	74
19.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Postës Shqiptare sh.a.	77
20.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë	80
21.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Zyrës Postare Kamëz	83
22.	S. C., kundër Postës Shqiptare,	88
23.	Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, kundër Bashkisë Durrës	91
24.	Z. F, kundër: subjektit privat Bar “Le 5 Stelle”, Sarandë dhe Bashkisë Sarandë	94
25.	L.D kundër linjës së transportit Golem-Kavajë	98
26.	M.R kundër Shoqërisë së Transportit “Urban Trans Vlorë” dhe Bashkisë Vlorë	101
27.	M.S kundër Shoqërisë së Transportit të udhëtarëve Tiranë-Durrës, EL-ALBA 1 sh.p.k	104
28.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë	107
29.	H.Ç, përfaqësuar nga Shoqata Kombëtare Shpresë për të Verbërit nga linja e transportit të udhëtarëve	

	Shoqëria LEDJAN sh.p.k, Durrës - Berat	111
30.	Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë kundër Postës Shqiptare sh.a. & Bashkisë Korçë.....	114
31.	Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, kundër Bashkisë së Tiranës	118
32.	M.W kundër Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Shkodër dhe Drejtuesit z.L.K	121
33.	A H kundër Bashkisë Maliq	124
34.	Fondacionit “Së Bashku”, kundër Bashkisë Tepelenë	127
35.	Fondacionit “Së Bashku”, kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Shkodër	130
36.	Fondacioni “Së Bashku”, kundër Hotel Flower.....	134
37.	A.H, kundër Bashkisë Durrës	136

KREU II

VENDIME NË FUSHËN E ARSIMIT

38.	J. H, kundër Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Zyrës Vendore Arsimore Tiranë	140
39.	B. S., kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë.....	143
40.	Fondacioni “Së Bashku” kundër Bashkisë Vorë	146
41.	A.Z kundër Shkollës së Mesme Teknike Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër....	149
42.	Fondacioni Së Bashku kundër Bashkisë Kavajë.....	153
43.	E. L. kundër Shkollës së mesme të bashkuar “Mihal Nako”, Divjakë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Divjakë	

(ZVAP Divjakë).	157
44. P. S., në cilësinë e prindit të fëmijës G. S., kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe.....	160
45. A.B e përfaqësuar nga F.L kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS),	163
46. M. H, i cili pretendon diskriminimin e djalit të tij O. H, nga Gjimnazi “Aleks Buda”, Tiranë, për shkak “aftësisë së kufizuar	167

KREU III

VENDIME NË FUSHËN E PUNËSIMIT	172
47. N. Z, kundër: Qendrës Shëndetësore Qesarat dhe Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Vlorë	172

HYRJE

Ligji Nr. 10221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” u miratua me datë 04.02.2010 dhe hyri në fuqi në mars të vitit 2010. Ligji u ndryshua me ligjin nr.124, datë 15.10.2020. Ky ligj përbën një nga ligjet më të rëndësishme, që e për afron të drejtën kombëtare me standardet ndërkombëtare të OKB-së dhe ato të Bashkimit Evropian, në fushën e mos-diskriminimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është një institucion i pavarur, që organizohet dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Fusha e veprimtarisë së KMD është mbrojtja efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, ku ndër të tjera, parashikohet shprehimisht dhe aftësia e kufizuar.

Veprimtaria e KMD realizohet nëpërmjet shqyrtimit të ankesave të subjekteve që pretendojnë se janë viktime të sjelljeve diskriminuese apo që e nxisin atë, jo vetëm nga administrata publike, por edhe nga subjektet private. Gjithashtu, KMD realizon hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi dhe bën sondazhe dhe monitorime për nivelin e zbatimit të ligjit. Procedura e hetimit administrativ përfundon me vendim të KMD, për të cilët, në rast të moszbatimi, vendosen dhe sanksione me gjobë, sipas parashikimeve ligjore. Të gjitha këto shoqërohen me aktivitete që synojnë informimin dhe sensibilizimin e komunitetit, organeve të administratës publike dhe subjekteve private për të nxitur parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Mbrojtja nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar ka qenë një prej çështjeve në fokus të veçantë të veprimtarisë së KMD, gjatë veprimtarisë së tij.

Thënë kjo, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që ushtron veprimtarinë e tij prej vitit 2010, ka krijuar një praktikë solide dhe të konsoliduar në trajtimin e çështjeve të diskriminimit, veçanërisht përmes vendimeve të diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar. Ajo çfarë evidentohet, është se, pavarësisht rregullimeve në ligje, akte nënligjore apo strategji, sërish personat me aftësi të kufizuara ndeshën me problematika, pengesa apo barriera, të cilat shpeshherë madje rezultojnë dhe nga moszbatimi i këtyre detyrimeve ligjore.

Prandaj, është e rëndësishme që të gjithë personat, veçanërisht grupet e interesit, të njihen me vendimmarrjet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në mënyrë që të identifikojnë më mirë rastet e diskriminimit, të përdorin mekanizmat ligjorë dhe institucional të disponueshëm me qëllim mbrojtjen sa më efektive nga diskriminimi të personave me aftësi të kufizuara.

Kjo përmbledhje ka si qëllim që të jetë sa më afër lexuesit duke e nxjerrë në pah elementët kryesore të çështjes, si faktet dhe rrethanat e saj, legjislacionin e aplikueshëm, konkluzionet dhe gjetjet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke u bazuar në ligj, prova e fakte, të grumbulluara gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, dhe në përfundim, dispozitivin e vendimit, nëpërmjet të cilit KMD konstaton diskriminimin dhe urdhëron marrjen e masave apo rregullimeve, të duhura dhe të përshtatshme, që vlerësohen rast pas rasti, me qëllim rregullim apo ndreqjen e pasojave të ardhura nga diskriminimi.

Theksojmë se, fusha e mosdiskriminimit evoluon dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, po ashtu dhe aftësia e kufizuar. Në këtë kuadër, e konsiderojmë mjaft të rëndësishëm bashkëpunimin me grupet e interesit, të cilët i njohin problematikat në terren, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm, identifikimin e çështjeve të diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara dhe ndjekjen e tyre, duke ezauruar të gjitha rrugët e ankimit, ato administrative dhe gjyqësore.

Shpresojmë që kjo përmbledhje e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fushën e aftësisë së kufizuar t'ju shërbejë edhe të gjithë personave me aftësi të kufizuar që kanë pësuar diskriminim, në mbrojtjen e të drejtave të tyre të shkelura dhe t'i nxisë ata në përdorimin sa më eficient të rrugëzgjidhjeve që ofron ky ligj, me qëllim vendosjen në vend të këtyre të drejtave.

KREU I

VENDIME NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE SHËRBIMEVE

1

ÇËSHTJE E NDJEKUR KRYESISHT NGA KOMISIONERI

Në Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V.” të datës 24.07.2020 (Vali), një nga protagonistet e programit ka përdorur shprehjen: “... o djalë je shumë down”.

Vendim nr. 155, datë 30. 10. 2020

FAKTET: Sipas informacionit të administruar të publikuar në media¹ dhe në rrjetet sociale², në programin Reality Show “REAL TALK me Aventurierët-V.” të datës 24.07.2020, një nga protagonistet e programit (V.), në pjesën prezantuese/hyrëse të emisionit shfaqet duke biseduar në celular me një djalë dhe mes tyre zhvillohet dialogu si më poshtë: *“Të thashë që nuk mundem sot, o djalë je shumë down³, nuk mundem pra, herë tjetër do takohemi normalisht, ok mjeshtër”*

Pavarësisht kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë shpjegimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë, nga ana e televizionit Top Channel nuk u vu në dispozicion asnjë informacion apo argument lidhur me shprehjen e përdorur në adresë të personave me sindromën Down.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 3, 17, 18, 22, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.

1. <https://top-channel.tv/video/real-talk-me-aventurieret-vali/>

2. https://www.instagram.com/p/CC_OoFhj8o7/?fbclid=IwAR2OYoghjrPFDnyJW38EAklm28FE6MS5cGTfwoMl4X71YJvnNEKL4ZyB8c

3. Referuar shprehjes së përdorur në sekondën 10-12 të videos.

- Konventa “Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”
- Rekomandimit të Përgjithshëm të Politikave nr. 15 të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës për “Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”,
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Në çështjen Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v. Firma Feryn NY (Case C-54/07)/ Çështja Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ/ Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 5493/72, 07 dhjetor 1976.
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 92.
- Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 2, 3, 7, 12, 32 dhe 33.

KONKLUZIONE: Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emision, duke përdorur fjalën “down” me qëllim ofendimi, në mënyrë të drejtëpërdrejtë mund të prodhojë përhapjen ose nxitjen e stereotipizimeve negative, stigmatizimeve ose kërcënimeve kundër fëmijëve dhe të rriturve të diagnostifikuar me “sindromën down”.

Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emisionin objekt shqyrtimi është një rast i shkëlqes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes duke patur parasysh gjithmonë ndalimin e të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë, përçmojnë apo denigrojnë një komunitet apo përkatësi të caktuar. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste.

Sa më sipër papërgjegjshmëria e lirisë së fjalës e përdorur në emisionin “Reality Show “REAL TALK me Aventurierët”, çënon dinjitetin dhe personalitetin e personave që vuajnë nga sindroma down për shkak të aftësisë së kufizuar. Në përfundim, për sa

më sipër, Komisioneri vlerëson se shprehja e përdorur në emisionin “Reality Shoë “REAL TALK me Aventurierët”, datë 24.07.2020 në televizionin Top Channel, ka vënë në pozita diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar, personat që vuajnë nga sindroma down në formën e shqetësimit.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të shtetasve me sindromën down, në formën e shqetësimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e televizionit Top Channel.

Televizioni Top Channel, të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës të distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi, cënon dhe prek dinjitetin e personave me sindromën down.

FONDACIONIT “SË BASHKU”, KUNDËR ZYRËS SË GJENDJES CIVILE, BASHKIA MAT

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në Bashkinë Mat për personat me aftësi të kufizuara.

Vendim nr. 129, datë 06. 10. 2020

FAKTET: Sipas palës ankuese, gjatë zbatimit të nismës “Të veprojmë së bashku për aksesueshmërinë” dhe në bashkëpunim me organizatat me të cilat Fondacioni “Së Bashku” bashkëvepron në Bashkinë Mat, ka konstatuar se Zyrat e Gjendjes Civile në këtë bashki, janë të pa aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar. Nga dëshmitë e marra nga personat me aftësi të kufizuar, banorë të kësaj bashkie, pretendohet se janë të diskriminuar, pasi e kanë të pamundur të marrin shërbimet e ofruara nga ky institucion, pasi rampa ekzistuese në hyrje të Zyrës së Gjendjes Civile është e papërdorshme. Sipas tyre, rampa përfundon me 3 shkallë të cilat e bëjnë të pamundur aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, duke u mohuar atyre të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si pjesa tjetër e popullsisë. Personat me aftësi të kufizuar nuk mund të marrin këto shërbime pa ndihmën e familjarëve të tyre, në Zyrat e Gjendjes Civile në Bashkinë Mat. Në këtë kuadër, sipas palës ankuese, situata e sipërcituar përbën mohim të barazisë ndaj këtij komuniteti, duke u diskriminuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë, për shkak të aftësisë së kufizuar, në raport me pjesën tjetër të banorëve të cilët marrin shërbimin pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Bashkinë Mat.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh,
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,

- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar),
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar,
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”,
- Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”,

KONKLUZIONE: Bashkia Mat informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...pas kërkesës suaj, Drejtoria e Shërbimeve bëri inspektimet në Zyrën e Gjendjes Civile Bashkia Mat dhe konstatoi se hyrja e Zyrës së Gjendjes Civile nuk është e pajisur me rampë. U hartua dokumentacioni teknik dhe menjëherë nisi zbatimin e ndërtimit të rampës me parametrat e duhura.”. Bashkëngjitur shkresës, Bashkia Mat vendosi në dispozicion të Komisionerit foto të realizuara gjatë punimeve të kryera prej tyre, për ndërtimin e rampës, në Zyrën e Gjendjes Civile në Bashkinë Mat.

Komisioneri i dërgoi subjektit ankues informacionin e përcjellë nga ana e Bashkisë Mat lidhur me ecurinë e ndërtimit të rampës së Zyrës së Gjendjes Civile, si dhe i kërkoi informacion lidhur me vijimin e mëtejshëm të procedurave të shqyrtimit të ankesës.

Subjekti ankues me anë të e-malit, sqaroi se: “Mendojmë që nuk ka kuptim vazhdimi i çështjes, madje mendojmë që është një shembull shumë i mirë dhe ne është hera e parë që na ndodh, kështu që mund ta mbyllni duke na dërguar një shkresë të dyja

paleve edhe duke i falenderuar dhe përgëzuar Bashkinë Mat edhe nga ana jonë për reagimin e shpejtë, edhe që për ne vërtetë është shembull dhe do ta promovojmë nëpërmjet kanaleve tona.”

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur, lidhur me shqyrtimin e ankesës së Fondacionit “Së Bashku”, pasi është arritur qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.

S.K., KUNDËR OPERATORIT TË TRANSPORTIT URBAN “REMI TRANS” SH.P.K

Trajtimi diskriminues i ankueses nga ofruesi i shërbimit urban ndërqytetas për shkak të aftësisë së kufizuar

Vendim nr. 125, datë 05/10/2020

FAKTET: Ankuesja është invalide e plotë e punës dhe dispononte dëshminë nr. 1551, datë 03.11.2018, të lëshuar nga Shoqata e invalidëve të Punës të Shqipërisë. Vlefshmëria e dëshmisë së sipërcituar ka qenë 1 (një) vit, dmth nga data 03.11.2018 – 03.11.2019. Në datën 12.12.2019, ankuesja ka udhëtuar me njërin nga autobusët e linjës ndërqytetase Tiranë – Vorë – Tiranë. Në kushtet kur, ajo gëzonte statusin e invalidit të punës, në bazë të nenit 11, të Ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidëve Të Punës”, (të ndryshuar), duhet të përfitonte udhëtim me 50 për qind të vlerës së biletës, por ajo pretendon se nuk ka qenë e vetëdijshme për skadencën e këtij dokumenti. Në momentin e paraqitjes së Dëshmisë tek faturino i autobusit, ky i fundit ka konstatuar se vlefshmëria e Dëshmisë së Invaliditetit të ankueses kishte përfunduar prej më shumë se 1 muaji. Pasi është njohur lidhur me faktin e skadencës së dëshmisë së invaliditetit, ankuesja i ka kërkuar faturinos që t’ia kthejë mbrapsht dokumentin dhe të paguajë biletën e udhëtimit. Faturino nuk ka pranuar të kthejë dokumentin pa asnjë shpjegim.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh,
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,

- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar),
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar,
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”,
- Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

KONKLUZIONE: Komisioneri ka konstatuar sjellje jo të denjë të faturinos së autobusit me targë AA 397 TM, të operatorit urban “Remi Trans”, i cili duhet ta kishte vënë në dijeni ankuesen për kalimin e afatit të vlefshmërisë së Dëshmisë së Invaliditetit, pasi e ka konstatuar një fakt të tillë, si dhe t’i kërkonte që të kryente pagesën e plotë të shërbimit urban ndërqytetas, por në asnjë mënyrë nuk ka patur të drejtë t’ia marrë apo sekuestrojë dëshminë e skaduar. Komisioneri gjykon se veprimi i tij është i pajustificueshëm, aq më tepër kur ankuesja i ka kërkuar disa herë me rradhë t’i kthente dëshminë e saj të invaliditetit. Për sa më sipër, faturino i autobusit ka abuzuar me detyrën e tij, duke kryer një veprim të tillë dhe përgjegjësia e drejtpërdrejtë për një ndodhi të tillë është e operatorit urban, që është edhe punëdhënësi i tij. Komisioneri gjykon se sjellja e punonjësit të këtij operatori urban konsiston në mungesë të theksuar respekti ndaj znj. S.K., si dhe qëndrimi i tij është gjithashtu tepër fyes e denigrues ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Komisioneri gjykon se qëndrimi ndaj së cilit ankuesja u ekspozua në datën 12.12.2020, nga ana e faturinos së autobuzit të operatorit Remi Trans konsiderohet jo vetëm i padrejtë dhe disfavorizues, por fyes e denigrues ndaj saj, për shkak se ajo ishte me aftësi të kufizuara. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se ankuesja S. K. është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Remi Trans sh.p.k.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të znj. S.K., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Remi Trans sh.p.k..

Administratori i kësaj shoqërie t'i kërkojë falje ankueses, për mungesën e respektit të treguar nga ana e punonjësit të tij.

Shoqëria "Remi Trans" sh.p.k. t'i kthejë znj. S.K., Dëshminë e Invaliditetit, që ankueses i është sekuestruar padrejtësisht nga faturino i autobusit me targë AA 397 TM.

Shoqëria "Remi Trans" sh.p.k. të marrë masa për mospërsëritjen e situatave të tilla kundrejt personave me aftësi të kufizuar.

FONDACIONIT “SË BASHKU”, KUNDËR BASHKISË DURRËS DHE OPERATORËVE QË OFROJNË SHËRBBIMIN E TRANSPORTIT PUBLIK, DURRËS.

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në transportin publik të Bashkisë së Durrësit për personat me aftësi të kufizuara.

Vendim nr. 26, datë 16. 02. 2021

FAKTET: Nga ana e Fondacionit “Së Bashku”, është evidentuar se mjetet e transportit dhe stacionët e autobusëve, në Bashkinë Durrës, janë të pa aksesueshëm. Pra, në shërbimin e transportit publik, nuk garantohet aksesueshmëria fizike e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Mosofrimi i lehtësive për këtë kategori individësh me aftësi të kufizuara fokusohet në disa aspekte:

- Mungesa e rampave të cilat janë të nevojshme për ta bërë transportin publik të aksesueshëm;
- Mungesa e zbatimit të standardeve teknike për aksesueshmërinë e stacionëve të autobusave të transportit publik;
- Mungesa e afshimit të orareve dhe të itinerareve në stacionet e autobusëve përbën pengesë për personat që nuk flasim dhe dëgjojnë;
- Gjatë lëvizjes së autobuzit nuk njoftohet vendodhja e stacioneve me anë të një shpjegimi audio.

Rastet e parashtuara nga pala ankuese reflektojnë pikërisht mosofrimin e këtyre lehtësive në transportin urban qytetas në qytetin e Durrësit. Gjatë hetimit administrativ të kësaj ankese, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohej ankesa u konsideruan edhe Shoqëritë e transportit “M... B... sh.p.k.” dhe “I... T... sh.p.k.”, autobusët e të cilëve rezultuan se ofronin shërbimin urban qytetas në linjat qytetase, të cilat lidhen me ofrimin e lehtësive për sa i përket aksesueshmërisë fizike në autobus.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh,
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar),
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar,
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”,
- Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”,

KONKLUZIONE: Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e Bashkisë Durrës, rezultoi se një pjesë e mjeteve të transportit publik të operatorëve urban të shoqërive “M... B... sh.p.k.” dhe “I... T... sh.p.k.”, të kontraktuar nga Bashkia Durrës, ishin të pajisura me platformën lëvizëse, që siguron aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuar në autobusë, ndërkohë për pjesën tjetër të këtyre automjeteve nuk u vu në dispozicion informacioni i plotë nëse janë të pajisur me një pajisje të tillë. Mungesa e një platforme lëvizëse në autobusët e këtyre shoqërive, përbën një pengesë në kuptimin e ligjit nr. 93/201, datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, pasi pengon aksesin fizik

në automjetet urbane qytetase, të individëve me aftësi të kufizuara, duke kufizuar mundësinë e tyre për të vetëvepruar.

Komisioneri vlerësoi se grupi i personave me aftësi të kufizuara, janë trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i kishte vendosur ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara që marrin shërbime pranë “M... B... sh.p.k.” dhe “I... T... sh.p.k.”, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Nga faktet dhe provat e administruara nuk rezultoi që Bashkia Durrës nuk kishte marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standarteve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike.

Komisioneri arriti në përfundimin se mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në autobuzët dhe stacionet e qytetit të Durrësit, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara në transportin publik në këtë qytet. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim të drejtëpërdrejtë dhe se Bashkia Durrës dhe Shoqëritë “M... B... sh.p.k.” dhe “I... T... sh.p.k.”, janë në shkëlqje të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Konstatimin e diskriminimit të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga operatorët e shërbimit urban qytetas “M... B... sh.p.k.” dhe “I... T... sh.p.k.”,

Bashkia Durrës, të marrë të gjitha masat e nevojshme, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, në mjetet e transportit të shërbimit urban qytetas dhe përshtatjen e stacionëve të autobuzëve për personat me aftësi të kufizuara.

Shoqëritë e transportit qytetas “M... B... sh.p.k.” dhe “I... T... sh.p.k.”, të marrin të gjitha masat e nevojshme, për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në automjetet e shërbimit urban qytetas, sipas legjislacionit në fuqi.

Rekomandohet Bashkia Durrës që marrja e masave për sigurimin e aksesueshmërisë së transportit publik, si në mjetet e transportit por edhe në stacionet tyre, të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Për shkak se, nga ana e Bashkisë Durrës dhe shoqërive të transportit qytetas nuk u ndërmorrën masa për garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vendosi sanksione me gjobë ndaj tyre.

V. K., KUNDËR MINISTRISË SË BRENDSHME DHE ALEAT SH.P.K.

Mohimi i përshtatjes së arsyeshme, nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe ALEAT sh.p.k., duke mos i ofruar mundësi aksesit të nevojshëm personave me aftësi të kufizuara, të cilët për shkak të gjendjes shëndetësore e kanë të pamundur të paraqiten pranë zyrave të aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identitetit.

Vendim nr. 42, datë 30. 03. 2021

FAKTET: Pretendimi për diskriminim i ankueses V.K. mbështetet në faktin që aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore e vajzës së saj, nuk i lejon që ajo të mund të aplikojë për tu pajisur me kartë identiteti, si të gjithë qytetarët e tjerë, për shkak se ajo e ka të pamundur të aksesojë Zyrat e Kompanisë ALEAT sh.p.k. Gjithashtu, ajo ndodhet përpara faktit që kartës së identitetit të vajzës së saj i ka përfunduar vlefshmëria dhe në këtë situatë ajo e ka të pamundur të përfitojë nga shërbimet shëndetësore të nevojshme. Referuar gjendjes së saj shëndetësore, E.T⁴ përfiton pagesë për aftësinë e kufizuar. Për rinovimin e dokumentacionit për vazhdimin e trajtimit me pagesën e aftësisë së kufizuar, një ndër dokumentat e kërkuar është dhe karta e identitetit.

Shërbimi i kërkuar në kushte banese, mund të ofrohej vetëm me kushtin që të aplikohet për një pasaportë, me një tarifë shërbimi prej 18.000 lekë dhe në momentin e aplikimit bëhet edhe ai i kartës së identitetit me një tarifë prej 1500 lekë. Pra, në këto kushte ankuesja ishte e detyruar për të paguar një tarifë shërbimi të panevojshme për marrjen e pasaportës, kur asaj nuk i shërben dhe nuk mund ta përdorë.

Pra, E.T, ndodhej përpara situatës në të cilën, e ka të domosdoshme të bëjë rinovimin e dokumentacionit sa i përket vijimit të trajtimit me pagesë të aftësisë së kufizuar.

4. Vajza e subjektit ankues

Fakti që ajo ka kartën e identitetit jashtë afateve të vlefshmërisë, bën të pamundur kryerjen e veprimeve të sipërcituara dhe ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar. Kjo situatë mund të sjellë si pasojë pamundësinë për të siguruar barnat apo kushtet mjekësore për trajtimin shëndetësor të saj.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh,
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) *“Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”*, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar,
- Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*,
- Ligji Nr. 57/2019 *“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar,
- Vendimi Nr. 483, datë 29.06.2016, i Këshillit të Ministrave, për miratimin e *“Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020”*,
- Vendimi Nr. 525, datë 08.08.2007 projektin për Koncesionin *“Mbi prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike”*.

KONKLUZIONE: Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Shoqëria ALEAT shp.k. dhe Ministria e Brendshme, nuk vunë në dispozicion asnjë informacion lidhur me:

- Hapat e ndërmarrë apo procedurën e miratuar, për ofrimin e mundësisë së personave me aftësi të kufizuara apo të shtetasve të cilët ndodhen në kushtet e pamundësisë për t'u paraqitur fizikisht pranë Zyrave të Aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identifikimit;

- Procedurën standarte për ofrimin e shërbimit në mënyrë të barabartë me shtetasit e tjerë, për personat me aftësi të kufizuara si në rastin e subjektit ankues;
- Tarifat standarte për ofrimin e shërbimit për pajisjen me Dokumenta Biometrik të Identitetit, për personat në nevojë që përfitojnë nga programet e ndihmës ekonomike apo që trajtohen me pagesë të aftësisë së kufizuar, të cilët nuk ndodhen në të njëjtat kushte me qytetarët e tjerë;
- Procedurën e miratuar, që personat në kushtet e ankueses, të mund të aplikojnë për Kartë Identiteti apo Pasaportë Biometrike, pa patur detyrimin që të paguajnë apo marrin shërbimin për të dy Dokumentat Biometrik të Identitetit njëkohësisht.

Përsa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme, u vërejt se ka patur edhe raste të tjera në kushtet e shtetasës E.T, ku këto subjekte janë vënë në dijeni dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të miratuar një procedurë standarte për lehtësimin e kostos apo të ofrimit të shërbimit për pajisjen me Dokumenta Biometrik të Identifikimit.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se Ministria e Brendshme, me anë të mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore, E.T dhe personat që ndodhen në të njëjtat kushte me të njëjta me të, sa i përket aksesueshmërisë.

Rezultoi se, shoqëria ALEAT sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit, i cili ofron shërbimin e pajisjes me Dokumenta Biometrik të Identitetit, ka refuzuar që të kryejë ndryshimet/ rregullimet e nevojshme për të ofruar shërbimin për t'u pajisur me kartë identiteti në ambientet ku qëndron shtetasja E.T. Ky ndryshim/rregullim i kërkuar në rastin e shtetasës E.T, është e vetmja mënyrë që ajo të përfitojë shërbimin, kjo për shkak se kjo shtetase e ka të pamundur të lëvizë. Në këtë mënyrë, Komisioneri gjykon se kërkesa për të ofruar shërbimin për tu pajisur me kartë identiteti në banesë, është një ndryshim/rregullim i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për rastin e shtetasës E.T. Në kushtet kur rezultoi se ofrimi i këtij shërbimi në banesë nuk përbën një barrë të tepruar, për ofruesin e shërbimit, në rastin konkret për shoqërinë ALEAT sh.p.k, Komisioneri arrin në përfundimin se shoqëria ALEAT sh.p.k. e ka vendosur shtetasen E.T përballë një situatë diskriminuese, të konsumuar në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se shtetasës E.T. i është mohuar përshtatja e arsyeshme, nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k. dhe aksesueshmëria nga ana e Ministrisë së Brendshme, të cilat do të bënin të mundur që E.T të aplikonte për kartë identiteti.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të shtetases E.T. në formën e mohimit përshtatjes së arsyeshme, nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore.

Konstatimin e diskriminimit të shtetases E.T dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, për shkak të aftësisë së kufizuar nga Ministria e Brendshme.

Të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k., për të garantuar ofrimin e shërbimit për pajisjen me kartë identiteti të shtetases E.T, në ambientet e banesës dhe me koston normale të saj.

Të merren të gjitha masat nga ana Ministrisë së Brendshme, për të parashikuar në kontratën koncesionare, procedura konkrete apo mundësi aksesit të nevojshëm që duhen përbushur, për personat me aftësi të kufizuara të cilët e kanë të pamundur të paraqiten pranë zyrave të aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identitetit.

Komisioneri rekomandoi që Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme, brenda 3 (tre) muajve, të hartojnë një skemë/program të mënyrave lehtësuese për përfitimin nga shërbimi për pajisjen me kartë identiteti apo pasaportë biometrike, për personat të cilët janë të pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore apo aftësisë së kufizuar.

Nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k. dhe Ministrisë së Brendshme, u morën masa për garantimin e ofrimin të shërbimit për pajisjen me kartë identiteti të shtetases E.T., në ambientet e banesës me koston normale të saj. Gjithashtu, nga ana e tyre u informua Komisioneri për nisjen e konsultimeve për hartimin e një skeme/programi lehtësues për përfitimin nga shërbimi për pajisjen me kartë identiteti apo pasaportë biometrike, për personat të cilët janë të pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore apo aftësisë së kufizuar.

S. L., KUNDËR BASHKISË TIRANË

Mungesa e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në qendrën e votimit mohon të drejtën e votës për personat me AK.

Vendim nr. 142, datë 03. 08. 2021

FAKTET: Subjekti ankues, në ditën e zgjedhjeve për Kuvend, datë 25.04.2021 është paraqitur pranë qendrës së saj të votimit nr. 1887/1 në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi”. Problematika që ajo hasi lidhej me:

- Mungesën e rampës në hyrje të Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, e cila ishte jashtë çdo standardi teknik që parashikohet në Rregulloren “Për përshtatjen e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara”.
- Nuk kishte përparësi në rradhë si person me aftësi të kufizuara.
- Dhoma e fshehtë ishte e papërshtatur dhe nuk ishte vendosur siç duhet. Për këtë shkak, ankuesja është asistuar nga një person, i cili ka plotësuar fletën e votimit në lartësi, çka ka pamundësuar që ajo të kontrollojë nëse u përbush vullneti i saj.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh,
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave

Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”,
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”,
- Udhëzimi nr. 1, datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”

KONKLUZIONE: Në rastin konkret, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që votuesve më aftësi të kufizuara duhet t’i krijoheshin kushtet për të votuar në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të votuesve, nuk u vendosën në dispozicion të Komisionerit fakte që provojnë se, për zgjidhjen e kësaj situate janë ndërmarrë hapa për t’i garantuar akses të barabartë personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës për të votuar.

Gjatë procedurës të shqyrtimit të ankesës, nga ana e Bashkisë Tiranë, nuk u parashtrua asnjë pretendim në lidhje me faktin, nëse ofrimi i përshtatjes së arsyeshme për rastin e ankueses apo votuesve të tjerë me aftësi të kufizuara, përbënte një barrë disproporcionale dhe të padrejtë, pra një barrë të tepruar, edhe pse ligjërisht është detyrim i saj. Në këtë kuptim dhe referuar legjislacionit të analizuar më sipër, janë pikërisht organet e vetëqeverisjes vendore ato të cilat kanë detyrimin për ti ofruar përshtatjen e arsyeshme dhe aksesueshmërinë e nevojshme, personave me aftësi të kufizuara të cilët duhet të ushtrojnë të drejtën e votës.

Rezultoi se, Bashkia Tiranë, në cilësinë e autoritetit, i cili duhet të siguronte aksesueshmërinë e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka marrë asnjë masë lidhur me këtë. Sigurimi i qendrave të votimit me aksesueshmërinë e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, është e vetmja mënyrë që ankuesja dhe votuesit e tjerë në të njëjtat kushte me të do të mund të ushtronin të drejtën e votës në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Në këtë mënyrë, Komisioneri gjykoj se kërkesa për sigurimin e elementëve të aksesueshmërisë është një përshtatje e domosdoshme për ankuesen dhe personat të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të. Në kushtet kur rezultoi se vendosja e elementëve të aksesueshmërisë në godinën e Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, nuk përbën një barrë të tepruar, për Bashkinë Tiranë, Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Tiranë e ka vendosur ankuesen përballë një situatë diskriminuese, jo vetëm duke mos i siguruar elementët e aksesueshmërisë në qendrën e votimit, por edhe duke konsumuar diskriminim në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Bashkia Tiranë, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesen dhe personat që ndodhen në të njëjtat kushte me të, sa i përket aksesueshmërisë dhe mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të shtetasve S. L. dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, *në formën e mohimit përshtatjes së arsyeshme*, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Konstatimin e mosdiskriminimit të S. L. dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në zgjedhjet e ardhshme, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Tiranë, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në udhëzimet përkatëse.

Të rekomandojë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të kontrollojë dhe të monitorojë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e kriterëve, sa i takon personave me aftësi të kufizuara, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të ardhshme.

Në përgjigje të vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Bashkia Tiranë mori masat për të garantuar elementët e aksesueshmërisë në qendrën e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në udhëzimet përkatëse.

D. N., KUNDËR MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE DHE QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË.

Subjektit ankues, shtetasi D. N., nuk ka marrë sasia e rekomanduar nga mjeku, të medikamentit Faktor IX, nga Farmacia e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, duke e ndikuar në përshpejtimin e invalidizimit të ankuesit.

Vendim nr. 144, datë 05. 08. 2021

FAKTET: Subjektit ankues, është i diagnostikuar me Hemophilia B, forma e rëndë, që në vegjëli. Hemophilia është një sëmundje e rrallë e cila mjekohet me Faktor IX dhe VIII. Për trajtimin e Hemophilia B, forma e rëndë, nga e cila vuan dhe ankuesi, nevojitet mjekimi me Faktor IX. Mungesa e profilaksisë i ka shkaktuar atij, dëme në artikulacione, ku shpesh dëmtimi i tyre është i pariparueshëm.

Ankuesi është trajtuar me gjak të freskët për 9 (nëntë) ditë, në pavionin e Hematologjisë në QSUT, si pasojë e një hemoragjie të rëndë në pjesën Abdominale (Gastrohemoragji). Në fletë-daljen e marrë nga spitali, mjeku ka theksuar faktin që ai duhet të ndiqet rregullisht dhe shumë strikt nga Qendra e Hemofilisë në QSUT. Gjithashtu, thekson se mungesa e trajtimit të rregullt me Faktor IX, ka sjellë pasoja shumë të rënda në gjendjen shëndetësore të ankuesit, duke i dëmtuar artikulacionet dhe duke bërë që ai të jetë pjesë e grupit të I-rë, të personave me aftësi të kufizuara.

Nga mjeku, është rekomanduar që ankuesi të marrë një sasi prej 6000 UI Faktor IX, ndërsa nga Farmacia e QSUT-së i është dhënë një sasi prej 450 UI Faktor IX. Gjithashtu, me të njëjtën situatë ankuesi është përballur edhe në një datë tjetër, ku nga mjeku Hematolog ishte përshkruar marrja e një sasive prej 6000 UI, ndërsa nga Farmacia e QSUT-së sërish i është dhënë vetëm 3000 njësi Faktor IX.

Nga informacioni dhe provat e administruara, rezultoi se ankuesi nuk merr sasinë e rekomanduar nga mjeku hematolog të medikamentit Faktor IX.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh,
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*,
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ),
- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) *“Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”*, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Karta Sociale Evropiane (e rishikuar) (1996),
- Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,
- Vendimi nr. 307, datë 21.05.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”*, i ndryshuar,
- Vendimi nr. 483, datë 29.6.2016, i Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016–2020”*,
- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Sëmundjeve të Lindura të Gjakut (2009 –2010)⁵, të MSHMS,

KONKLUZIONE: Nga analizimi i provave të paraqitura nga pala ankuese rezulton se shtetasi D. N. nuk ka marrë sasinë e rekomanduar nga mjeku të medikamentit Faktor IX. Pikërisht, një gjë e tillë ka ndikuar në përshpejtimin e invalidizimit e ankuesit. Për sa më sipër, Komisioneri gjykoi se institucionet përgjegjëse duhet të kishin marrë masat e nevojshme për sigurimin e plotë të sasisë së Medikamentit Faktor IX për ankuesin, aq më tepër kur predispozicioni i pacientëve me këtë sëmundje është invalidizimi i tyre.

Gjatë shqyrtimit të ankesës Nr. 120, datë 13.08.2018, të shtetasit B. N. (familjar i ankuesit), çështjes së iniciuar kryesisht me Urdhërin nr. 247, datë 12.12.2018 dhe

5. http://www.nationalplanningcycles.org/sites/default/files/planning_cycle_repository/albania/the_national_strategy_for_the_management_of_congenital_blood_2009-2010.pdf

ankesës Nr. 80, datë 08.07.2019, të shtetasit K. M., Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka evidentuar se arsyet që kanë çuar në mospajtimin e Medikamentit Faktor IX, ka qënë fakti që këto medikamente siguroheshin përmes kontratave të prokurimit me operatorë ekonomikë privatë apo përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me vende të tjera, kryesisht donacione.

Në rastin e çështjeve të sipërcituara, personat vuanin nga hemofili e tipit A në formë të rëndë dhe B, si dhe ishin invalid. Në përfundim të trajtimit të këtyre çështjeve, KMD-ja ka konstatuar diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar si pasojë e mosgarantimit të trajtimit në sasisë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor. Në të tre rastet e shqyrtuara, KMD-ja ka udhëruar institucionet përgjegjëse, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT për marrjen e masave të menjëhershme për garantimin e trajtimit me sasinë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor.

Vlen të sillej në vëmendje fakti që vendimet e KMD-së janë kundërshtuar gjyqësisht dhe në përfundim të shqyrtimit në një prej rasteve (Vendimit Nr. 80, datë 08.07.2019, të shtetasit K. M.), gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka rrëzuar kërkesë padinë e QSUT-së dhe ka lënë në fuqi vendimin e KMD-së duke marrë formë të prerë. (Shih vendimin nr. 395, datë 10.02.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë, për shkak se nuk është apeluar nga QSUT).

Mungesa e fondeve buxhetore dhe mos sigurimi i sasisë së mjaftueshme të medikamentit Faktor IX, ka qënë faktor disavantazhues për D. N. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT kanë patur barrën e provës para Komisionerit për të provuar se pavarësisht kufizimeve buxhetore, fondet e administruara janë përdorur në mënyrën më të mirë për të siguruar medikamentin Faktor IX për pacientët me Hemofili B, gjë të cilën nuk e kanë bërë në këtë shqyrtim administrativ të ankesës së D. N.

Pra në përfundim, Komisioneri konstatoi se:

- Pavarësisht faktit që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT, kanë patur dijeni në vazhdimësi për mungesën e sasisë së nevojshme për trajtimin e pacientëve Hemofilik me medikamentin Faktor IX, nuk kanë marrë asnjë masë për zgjidhjen e kësaj situate.
- Edhe pse MSHMS dhe QSUT, u vunë në dijeni të faktit që pas ankesës së paraqitur, D. N. sërish nuk u trajtua me sasinë e nevojshme të medikamentit Faktor IX nga Farmacia e QSUT-së, nuk morën asnjë masë për t'i dhënë një zgjidhje situatës së krijuar.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ndaj ankuesit është konsumuar një formë e rëndë diskriminimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë, pasi përmbushen parashikimet e sipërcituara në nenin 3/1 të LMD-së, së ndryshuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit, për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, të D. N., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).

Konstatimin e diskriminimit në formën e rëndë të tij, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë.

Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të *“gjendjes shëndetësore”*, të D. N., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).

Marrjen e masave të menjëherëshme nga të dy institucionet e mësipërme, për trajtimin e pacientit D. N., me sasinë e rekomanduar nga mjeku hematolog të Medikamentit Faktor IX.

SHOQATA “SHPRESË PËR TË VERBËRIT”, KUNDËR BASHKISË KAMËZ DHE SHOQËRISË SHPRESA-AL SH.P.K.

Mosnjohja e librezës së verbërisë në transportin publik të Bashkisë së Kamëz për personat me aftësi të kufizuara.

Vendim nr. 146, datë 06. 08. 2021

FAKTET: Sipas përfaqësuesve të Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, nga ana e punonjësve të Shoqërisë së Transportit Shpresa-AL sh.p.k, i është mohuar e drejta e transportit publik duke i është thënë se ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, ka ndryshuar që në vitin 2012 dhe me ndryshimet e bëra tashmë të verbërit përfitojnë kompensim dhe nuk mund të udhëtojnë falas në transportin qytetas.

Në përfundim të ankesës së sipërcituar, Shoqata “Shpresë për të verbërit”, pretendon se është diskriminuar nga ana e përfaqësuesve të Shoqërisë së Transportit Shpresa-AL sh.p.k., duke mos i njohur Librezën e lëshuar nga ana e Shoqatës së tyre, por vetëm librezën e lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës, si dhe duke mos zbatuar ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”;
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;
- Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”;
- Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUZIONE: Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Kamëz nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se kësaj kategorie personash me aftësi të kufizuara, sikurse edhe të gjitha kategorive të tjera që bëjnë pjesë në këtë grupim, u është mohuar një e drejtë, e cila u është dhënë nga legjislacioni në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi se Bashkia Kamëz, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një

situatë diskriminuuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesen dhe personat e verbër të përfaqësuar pranë Komisionerit nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, sa i takon ofrimin e transportit pa pagesë të parashikuar në legjislacionin e sipërpërmendur.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të kategorisë së personave të verbër, nga ana e Bashkisë Kamëz.

Të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Kamëz, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.

Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore” (i ndryshuar)*.

Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar)*.

Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacionin dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*.

Në zbatim të vendimit të Komisionerit, Bashkia Kamëz informoi se janë marrë masat në bashkëpunim me Shoqërinë “Shpresa AL”, për ndryshimin e kontratës dhe ofrimin e shërbimit pa pagesë për personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa nga ana e Këshillit të Ministrave nuk është informuar Komisioneri lidhur me marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të dhëna.

F. S. DHE F. E., BASHKISË VLORË DHE SHOQËRISË SË TRANSPORTIT QYTETAS “URBAN TRANS VLORA” SH.P.K.

Mosnjohja e librezës së verbërisë në transportin publik të Bashkisë Vlorë për personat me aftësi të kufizuara.

Vendim nr. 174, datë 20. 09. 2021

FAKTET: F. S. dhe F. E., në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pretendojnë se janë diskriminuar nga ana e shoqërive të transportit urban të qytetit të Vlorës, duke mos i njohur atyre të drejtën që u jep ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, për të udhëtuar falas në transportin qytetas. Gjatë përdorimit të transportit urban, ankuesit pretendojnë se janë detyruar që këtë shërbim ta marrin me pagesë nga ana e shoqërive të transportit qytetas.

Në përfundim të ankesës së sipërcituar, subjektet ankues pretendojnë se janë diskriminuar nga ana e përfaqësuesve të shoqërive të transportit qytetas të Bashkisë Vlorë, duke mos i njohur Librezën e lëshuar nga ana e Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, si dhe duke mos zbatuar ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”*;
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 *“Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”*, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës *“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”*;
- Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, *“Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”*.

KONKLUZIONE: Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara, të verbër, nuk kanë përfitur nga transporti urban pa pagesë në linjën e ofruar nga operatori “Urban Trans Vlora” sh.p.k., nga ana e Bashkisë Vlorë nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj situate.

Komisioneri konstatoi se Bashkia Vlorë nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare. Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesve, sikurse edhe të gjitha kategorive të tjera që bëjnë pjesë në këtë grupim, u është mohuar një e drejtë, e cila u është dhënë nga legjislacioni në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Bashkia Vlorë dhe shoqëria “Urban Trans Vlorë” sh.p.k., me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tyre, kanë vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, subjektet ankues, sa i takon ofrimit të transportit pa pagesë të parashikuar në legjislacionin e sipërpërmendur.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të F. S. dhe F. E., nga ana e Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë së transportit qytetas “Urban Trans Vlorë” sh.p.k.

Të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë së transportit qytetas “Urban Trans Vlorë” sh.p.k., për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kategorisë së personave të verbër.

Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore” (i ndryshuar)*.

Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar)*.

Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*.

Në zbatim të vendimit të Komisionerit, Bashkia Vlorë informoi se janë marrë masat në bashkëpunim me Shoqërinë “Urban Trans Vlorë” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit pa pagesë për personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa nga ana e Këshillit të Ministrave nuk është informuar Komisioneri lidhur me marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të dhëna.

FONDACIONI SË BASHKU KUNDËR POSTËS SHQIPTARE SH.A (ZYRA POSTARE HARDHISHT)

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a. Hardhisht.

Vendim nr. 123, datë 20.06.2022

FAKTET: Fondacioni Së Bashku, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës së Postës Shqiptare sh.a. Hardhisht, diskriminon personat me aftësi të kufizuar. Zyra Postare Hardhisht, është një nga zyrat postare pjesë e Filialit të Postës Shqiptare sh.a., Durrës. Rezulton që shërbimet në Zyrën Postare Hardhisht ofrohen në ambientin e një kioske. Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Posta Shqiptare sh.a., kioska ka një sipërfaqe 27 (njëzetë e shtatë) m². Posta Shqiptare sh.a., prapësoi duke pretenduar se zyra postare përmbush kërkesat që lidhen me aksesueshmërinë për klientët që janë persona me aftësi të kufizuar, sepse kioska ndodhet rrafsh me tokën. Posta Shqiptare sh.a. deklaroi se kjo zyrë postare është vendosur në vitin 2008 dhe që atëherë nuk është kryer ndonjë investim, pasi ambienti është kioskë, por mirëmbahet çdo ditë dhe është në funksion të plotë.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

- Ligji Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;*
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 *“Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr.93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.*
- Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;*
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;*

KONKLUZIONE: Komisioneri thekson se, garantimi i aksesueshmërisë dhe heqja e barrierave infrastrukturore në ndërtesa ose godina, ka si qëllim që të mundësojë dhe të sigurojë aksesin e personave me aftësi të kufizuara shërbimet e ndryshme që ofrohen nga subjektet publike dhe private. Në këtë kontekst, nëse ofruesi i shërbimit ka zgjedhur që të ofrojë shërbimet në një ambient “kioskë” dhe jo në një godinë ose ndërtesë, nuk e zhbën detyrimin e subjektit për të garantuar ofrimin e shërbimeve për të gjithë klientët në baza të barabarta, pa asnjë diskriminim bazuar në aftësinë e kufizuar. Ambienti i zgjedhur nga ofruesi i shërbimit, në rastin konkret Posta Shqiptare sh.a. duhet të jetë i tillë që të mundësojë akses për personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri evidenton se, Posta Shqiptare sh.a. ka një kuptim jo të saktë në lidhje me aksesueshmërinë. Sikurse më sipër rezulton nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, aksesueshmëria nuk është e garantuar nëse objekti nuk ka shkallë ose në prezencë të shkallëve objekti është i pajisur me rampë. Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008.

Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët nga shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., në Zyrën Postare Hardhisht.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, si dhe detyrimet që burojnë nga legjisllacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Zyra Postare Hardhisht nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Hardhisht. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara që marrin shërbime pranë Zyrës Postare Hardhisht, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Posta Shqiptare sh.a. deklaron se Zyra Postare Hardhisht, është vendosur në vitin 2008 dhe në këtë zyrë nuk është kryer asnjë investim, pasi ambienti është "kioskë". Komisioneri vlerëson se, pavarësisht këtij fakti, Posta Shqiptare sh.a. që prej vitit 2008, kur ka filluar veprimtarinë e saj Zyra Postare Hardhisht e deri në vitin 2022, duhet të kishte marrë masa që të përshtaste ambientin ku ofrohen shërbimet, pavarësisht faktit se, ambienti i zgjedhur prej saj është "kioskë". Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pabazuar, nuk ka marrë asnjë masë për të përshtatur ambientin ku ofrohen shërbimet, qoftë duke rishikuar standardet e ambientit "kioskë" apo duke vlerësuar mundësinë e zhvendosjes së ambienteve të Zyrës Postare Hardhisht në një godinë apo ndërtesë që plotëson kriteret dhe standardet e aksesueshmërisë. Komisioneri konstaton se, Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Hardhisht, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara,

në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Hardhisht. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Komisioneri konstaton se:

- Posta Shqiptare sh.a ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a, më shumë se një herë nuk ka garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke mohuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në baza të barabarta me të tjerët, në marrjen e shërbimeve pranë disa zyrave të tjera postare ku Posta Shqiptare sh.a ushtron aktivitetin e saj, sikundër janë: Zyra Postare Qendër Shkodër, konstatuar me vendimin nr. 10, datë 21.01.2021 të Komisionerit, Zyra Postare Qendër Durrës, konstatuar me vendimin nr.111, datë 10.06.2022, të Komisionerit, Zyra Postare Shijak, konstatuar me vendimin nr.115, datë 13.06.2022, të Komisionerit.
- Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a, nuk ka ndërmarë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM nr.1503/2008, miratimin e VKM nr.1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendimit të Komisionerit nr. 10, datë 21.01.2021, ku Posta Shqiptare është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ndaj personave me aftësi të kufizuara është konsumuar një formë e rëndë diskriminimi nga ana e Postës Shqiptare sh.a.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit në *formën e rëndë të tij*, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Hardhisht.

Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa të menjëhershme për:

- Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Hardhisht, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”* dhe nr.1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.
- Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.

Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a. që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

FONDACIONI “SË BASHKU” KUNDËR MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Diskriminim të personave me aftësi të kufizuar që përfitojnë shërbimet shëndetësore në Poliklinikën Qendrore, Bashkia Durrës.

Vendim. 182, datë 21 . 09. 2022

FAKTET: Rezulton se godinat ku ofrojnë shërbimet shëndetësore Ambulanca Arapaj 1, Ambulanca Shkallnur dhe Poliklinika e Specialiteve Durrës nuk përmbushin kriteret e miratuara të aksesueshmërisë që duhet të plotësojnë ndërtesat ku ofrohen këto lloj shërbimesh. Rrjedhimisht personat me aftësi të kufizuar nuk i përfitojnë shërbimet shëndetësore në baza të barabarta me të tjerët për shkak të ekzistencës së barrierave dhe mungesës së aksesueshmërisë fizike në këto godina.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Komenti Nr. 14/2000 “E drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit”, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;

- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.
- Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020-2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 20.05.2020;

KONKLUZIONE: Duke mbajtur në konsideratë se:

- Ambulanca Arapaj 1/Arapaj Poshtë dhe Ambulanca Shkallnur janë ndërtuar para se të jenë miratuar kriteret e detyrueshme në lidhje me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar;
- Nga momenti i ndërtimit të objekteve të mësipërme shëndetësore, MSHMS nuk ka kryer investime të mëtejshme;
- Kriteret e zbatuara në lidhje me përzgjedhjen e QSH/Ambulancave që i nënshtrohen rikonstruksionit gjatë vitit 2022, janë kritere objektive dhe për rrjedhojë është në diskrecionin e MSHMS që duke zbatuar në mënyrë të bazuar këto kritere të përzgjedhë në mënyrën më të mirë objektet shëndetësore;
- Ambulanca Arapaj Sipër/Arapaj 2, e cila është përzgjedhur për t’iu nënshtuar rikonstruksionit për vitin 2022 është pjesë e Qendrës Shëndetësor Rrashbull, nga e cila varen edhe shërbimet shëndetësore që ofrohen në Ambulancën Arapaj 1/ Arapaj Poshtë dhe Ambulancën Shkallnur;
- MSHMS, në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, ka marrë masa duke rikonstruktuar 300 qendra shëndetësore dhe ambulanca në të gjithë vendin, përgjatë viteve 2018-2021,

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me Ambulancën Arapaj 1/Arapaj Poshtë dhe Ambulancën Shkallnur, të dyja objekte shëndetësore në varësi të Qendrës Shëndetësore Rrashbull, të vendosura në Njësinë Administrative Rrashbull, të Bashkisë Durrës, MSHMS arriti të provojë se ka marrë masa për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë e Qendrave Shëndetësore dhe Ambulancave dhe rrjedhimisht, ekziston një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar në këto dy objekte shëndetësore. Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, MSHMS, nuk ka diskriminuar personat me aftësi të kufizuar të cilët marrin shërbime shëndetësore në Njësinë Administrative Rrashbull.

Duke mbajtur në konsideratë se:

- Në Kreun I, pika 16, të VKM nr. 1074/2015, parashikohet se: *“16. Ndalohet dhënia e financimeve ose mbështetja financiare nga ana e shtetit apo enteve publike dhe jopublike/donatorëve për ndërtimin e një vepre, me qëllim ofrimin e shërbimit publik, nëse objekti nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë vendim.”;*
- Pavarësisht se godina e Poliklinikës Qendrore të Specialiteteve Durrës, është ndërtuar përpara miratimit të standardeve të detyrueshme të aksesueshmërisë, në godinë janë realizuar investime të cilat nuk kanë adresuar çështjen e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar. MSHMS nuk shpjegoi se përse në investimin e kryer në godinën e Poliklinikës në vitin 2016 nuk ishte adresuar çështja e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara apo se cilat ishin shkaqet objektive që e kishin vendosur atë në pamundësi për të adresuar aksesueshmërinë në vitin 2016;
- Poliklinika Qendrore e Specialiteteve Durrës, ofron shërbime mjekësore për një numër të madh personash dhe mbulon me shërbim jo vetëm qytetin e Durrësit por edhe Njësitë Administrative dhe fshatrat e kësaj bashkie. Në këtë mënyrë, personat me aftësi të kufizuar që jetojnë në këto zona, nuk kanë alternativa në zona të afërta me vendbanimin e tyre për të marrë shërbimet mjekësore sipas specialiteteve lidhur me nevojat e tyre;
- Shërbimi shëndetësor nga mjekët specialistë në katin e parë, duke zbritur nga kati i dytë dhe i tretë i godinës së Poliklinikës, nuk ofrohet në mënyrë dinjitoze dhe në kushte të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar;

Komisioneri konstaton se, MSHMS në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve Durrës.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve Durrës, ka sjellë mohim të aksesit për

personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet shëndetësore që ofrohen në këtë objekt shëndetësor dhe se MSHMS nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt shëndetësor.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara që marrin shërbimet shëndetësore në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve, Durrës, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët që përfitojnë shërbimet shëndetësore në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve, Durrës, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duhet të marrë masat e mëposhtme:

- Të sigurojë në mënyrë të përshpejtuar aksesueshmërinë në Poliklinikën Qendrore të Specialiteteve, në përputhje me standardet ligjore në fuqi.
- Të sigurojë aksesueshmërinë në Ambulancën Arapaj1/Arapaj Poshtë dhe Ambulancën Shkallnur, e në vazhdimësi në të gjitha Qendrat Shëndetësore dhe Ambulancat në të gjithë vendin, në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme, në përputhje me standardet ligjore në fuqi.
- Të udhëzojë të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor, që të sigurojnë rast pas rasti përshtatjen e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara.
- Të mos ketë pengesa administrative dhe të sigurohen të gjitha lehtësitë në mënyrë që, deri në garantimin e aksesueshmërisë në të gjitha Qendrat Shëndetësore/ Ambulancat, personat me aftësi të kufizuara të marrin shërbimin shëndetësor, në ato ambulanca të cilat janë të aksesueshme.
- Në përfundim të procesit të rikonstruksionit të godinës së Ambulancës Arapaj 2/ Arapaj Sipër dhe marrjes në dorëzim të objektit të përfunduar, të depozitojë pranë Komisionerit dokumentacionin e nevojshëm që provon garantimin e standardeve të miratuara në lidhje me aksesueshmërinë.

Konstatimin e mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët marrin shërbime shëndetësore në Njësinë Administrative Rrashbull, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

FONDACIONI SË BASHKU KUNDËR POSTËS SHQIPTARE SH.A (ZYRA POSTARE QENDËR DURRËS)

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a në qendër të Bashkisë Durrës.

Vendim nr. 111, datë 10.06.2022

FAKTET: Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Pala ankuese pretendon se mungesa e aksesueshmërisë në ambientet e Zyrës Postare Qendër Durrës, një ambient ku ofron shërbimet e saj Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, diskriminon personat me aftësi të kufizuar të cilët për shkak të mungesës së aksesit, nuk mund të marrin në mënyrë të lirë dhe të pavarur shërbimet e ofruara nga ky subjekt.

Zyra Postare Qendër Durrës, është një nga zyrat postare pjesë e Filialit të Postës Shqiptare sh.a., Durrës. Rezultoi që godina ku ofrohen shërbimet nga ana e kësaj zyre postare, ka në hyrje të saj shkallë. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Posta Shqiptare sh.a. deklaroi se kjo zyrë postare do t'i nënshtrohej rikonstruksionit në vitin 2022 ku është parashikuar ndërtimi i rampës hyrëse.

Posta Shqiptare sh.a. nuk dha asnjë informacion në lidhje me përmbushjen e kriterëve dhe parashikimeve në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë të parashikuara nga VKM Nr. 1503/2008 apo ndonjë planifikim për plotësimin e tyre në të ardhmen.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;*
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 *“Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr.93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.*
- Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;*
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;*
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.
- Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020-2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 20.05.2020;

KONKLUZIONE: Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se ndërtesa ku ofrohen shërbimet nga Zyra Postare Qendër Durrës, ka në hyrje të saj shkallë, të cilat përbëjnë pengesa infrastrukturore dhe nuk lejojnë personat me aftësi të kufizuara në lëvizje të cilët janë përdorues të karriges me rrota që të hyjnë në ndërtesë dhe të marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a.

në këtë zyrë postare. Ndërtesa ku ofrohen shërbimet nuk është e pajisur me rampë, që është një nga elementët e parashikuar për eliminimin e pengesave ose barrierave. Shkallët dhe mungesa e rampës, përbëjnë një burim vështirësie për lëvizjen e të gjithë atyre personave që kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, kërkon aplikimin e një sërë standartesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr.1503/2008. Është respektimi në tërësinë e tyre, i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike që mundëson heqjen e barrierave/pengësive për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses dhe të përfitojnë në baza të barabarta me të tjerët nga shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., në Zyrën Postare Qendër Durrës. Ekzistenca e pengësive/barrierave infrastrukturore në ndërtesën ku ofrohen shërbimet nga Posta Shqiptare sh.a., në Zyrën Postare Qendër Durrës, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t'ju mohohet aksesimi për të marrë shërbimet e ofruara.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ndërtesa ku ushtron veprimtarinë Zyra Postare Qendër Durrës, pjesë e Filialit të Postës Shqiptare sh.a. Durrës, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Posta Shqiptare sh.a nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve prej saj. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Qendër Durrës.

Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuara edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme vendosja e një rampe, nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar. Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi gjithashtu se, Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë ose me shikim apo dëgjim të kufizuar

Rezultoi se Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike. Komisioneri arrin

në përfundimin se Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë asnjë masë për të planifikuar dhe për të realizuar aksesueshmërinë për personat me aftësitë kufizuar.

Në kushtet kur Zyra Postare Qendër Durrës, nuk përmbush kriteret teknike dhe rrjedhimisht nuk garanton aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, pavarësisht investimeve të vazhdueshme që Posta Shqiptare sh.a. deklaroi se kryen për krijimin e kushteve më të mira për ofrimin e shërbimeve, faktet dhe provat e administruara tregojnë se, investimet që mund të jenë kryer nuk kanë adresuar në mënyrë të barabartë nevojat midis personave me aftësi të kufizuara dhe pjesës tjetër të qytetarëve që nuk kanë aftësi të kufizuara.

Komisioneri konstaton se, Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/ barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Durrës, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a. dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengësive për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Qendër Durrës. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Durrës.

Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa të menjëhershme për:

- Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Durrës, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008, "*Për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e*

personave me aftësi të kufizuara” dhe nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.

Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a. që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

FONDACIONI SË BASHKU KUNDËR BASHKISË DURRËS, BASHKISË SHIJAK, BASHKISË KRUIJË DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ)

Njësitë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Durrës dhe Bashkia Shijak kanë dështuar për të garantuar aksesueshmërinë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara.

Vendim nr. 41, datë 28.2.2022

FAKTET: Fondacioni Së Bashku, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në kuadër të ushtrimit të të drejtës së votës për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, në Bashkinë Durrës, Bashkinë Shijak dhe Bashkinë Krujë.

Nga monitorimet e kryera pala ankuese ka konstatuar problematika në lidhje me plotësimin e kushteve të QV duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërinë në QV ka sjellë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së votës për Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë. Pala ankuese pretendon gjithashtu se personat me aftësi të kufizuara janë diskriminuar nga udhëzimi nr. 1, datë 5.12.2021, i KQZ-së, pasi sipas saj ky akt nuk garanton mekanizma kontrollipër plotësimin e kushteve në QV për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr. 1 dhe Nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

- Ligji Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;*
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 *“Aksesueshmëria”*, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr.93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*.
- Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;*
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;*
- Udhëzimi i Komisionit Rregullator të KQZ Nr.1, datë 05.12.2020 *“Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”*
- Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr.33, datë 16.12.2020 *“Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”;*

KONKLUZIONE: Komisioneri arriti në përfundimin se qendra votimi në Bashkinë Durrës dhe Shijak ishin të vendosura në ndërtesa që nuk përmbushin standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë këto njësi të vetëqeverisjes vendore, nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit.

Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë për të shprehur të drejtën e votës në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret, në raport me zgjedhësit e tjerë. Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, nuk u konstatuan shkeljet e ngritura nga pala ankuese në lidhje me Bashkinë Krujë.

Në pamje të praktika që ndiqet gjatë procedit zgjedhor është e njëjtë për të gjithë zgjedhësit, të cilët votojnë dhe hedhin votën e tyre në të njëjtat qendra votimi. Pra nuk ka asnjë trajtim të diferencuar midis zgjedhësve me aftësi të kufizuar dhe atyre pa aftësi të kufizuar. Personat me aftësi të kufizuar në pamje të parë nuk kanë patur pengesë që të marrin pjesë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021 dhe për të hedhur votën e tyre në qendrat e votimit respektive, por në realitet për shkak të barrierave në qendrat e votimit, e drejta për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të votuar bëhet e pamundur. Pra, barrierat në qendrat e votimit dhe mungesa e aksesueshmërisë në qendrat e votimit e vendos kategorinë e personave me aftësi të kufizuara në kushte më pak të favorshme në raport me zgjedhësit e tjerë. Barrierat dhe mungesa e aksesit në qendrat e votimit prek në një mënyrë më negative kategorinë e zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

E drejta e votës është e drejtë thelbësore dhe jo privilegj. E drejta e votës universale kërkon që të gjithë qytetarët të kenë të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në jetën politike të vendit, siç parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare dhe në të drejtën kombëtare. Aksesueshmëria e plotë në çdo fazë të procesit të votimit në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara duhet të jetë rregull dhe jo përjashtimi. Aksesueshmëria është një kërkesë e pakushtëzuar dhe nuk mund të zbehet duke referuar tek “barra disproporcionale” pasi është parakusht për gëzimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe shoqërore në pozitë të barabartë me të tjerët.

Në praktikë, aksesit i personave me aftësi të kufizuara në të drejtat e tyre në baza të barabarta me ato të personat pa aftësi të kufizuara shpesh mbetet një mendim i dëshiruar që rezulton ipamjaftueshme, gjë që përkthehet në pjesëmarrje dukshëm më të ulët të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor dhe i margjinalizon më tej këtë pjesë të shoqërisë. Masat alternative ose të përkohshme të aksesueshmërisë nuk duhet të përdoren si zëvendësues i përhershëm, në vend të sigurimit të aksesit të plotë të qendrave të votimit.

Standratet teknike të aksesueshmërisë janë miratuar prej një kohe të gjatë dhe e drejta ndërkombëtare e ratifikuar nga Shqipëria dhe legjislacioni kombëtar vendosin detyrimin për të garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që të garantohet në bazatë barabartë me të tjerët e drejta e tyre për të marrë pjesë në jetën politike të vendit.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që votuesve me aftësi të kufizuara duhet t'i krijoheshin kushtet për të votuar në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të votuesve, nuk u vendosën në dispozicion të Komisionerit fakte që provojnë se, për zgjedhjen e kësaj shtate janë ndërmarrë hapa për t'i garantuar akses të barabartë personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës për të votuar.

Komisioneri arrin në përfundimin se mosplotësimi standarteve të aksesueshmërisë në qendrat e votimit në Bashkinë Durrës dhe në Bashkinë Shijak, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në të drejtën e tyre për të votuar në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 dhe për të marrë pjesë në jetën politike. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri nuk gjen asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Durrës dhe Bashkia Shijak, kanë dështuar që të trajtojnë në mënyrë të diferencuar nëvojat e personave me aftësi të kufizuara për të patur akses në qendrat e votimit, duke i vendosuar ata në një situatë diskriminuese.

Në referim edhe të nenit 31, të Konventës *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, Komisioneri vlerëson se, është e nevojshme që KQZ-ja të përcaktojë dhe të rregullojë mënyrën e mbledhjes së të dhënave në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuara që kanë ushtruar të drejtën e votës. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të identifikuar dhe për të adresuar barrierat me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të të drejtës së votës. Aktualisht gjatë procesit zgjedhor administrohen të dhëna paraprake në lidhje me identifikimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara të regjistruar, por jo se sa prej tyre kanë ushtruar efektivisht të drejtën e votës. Mbledhja dhe analiza e të dhënave, para dhe pas procesit zgjedhor, janë masa thelbësore për monitorimin e politikave dhe ligjeve kundër diskriminimit. Të dhënat para dhe pasprocesit zgjedhor, duhet të ndahen jo vetëm sipas llojit të aftësisë së kufizuar, por edhe sipas kategorive ndërsektoriale.

Komisioneri gjykon se, pavarësisht efikasitetit të mekanizmave të parashikuar në udhëzimin e miratuar nga ana e KQZ-së, përgjegjësia ligjore për të garantuar

aksesueshmërinë e qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara i takon njësisive të vetëqeverisjes vendore.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Durrës.

Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Shijak.

Konstatimin e mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Krujë.

Konstatimin e mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bashkia Durrës, të marrë masa për të garantuar aksesueshmërinë e plotë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara nga legjisllacioni në fuqi.

Bashkia Shijak, të marrë masa për të garantuar aksesueshmërinë e plotë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara nga legjisllacioni në fuqi.

Bashkia Durrës, Bashkia Shijak, Bashkia Krujë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si palë të përfshira në procesin zgjedhor, sipas fushës respektive të përgjegjësisë, duhet të marrin masa për të mbledhur në mënyrë të saktë dhe të qartë dhe për të monitoruar në mënyrë efektive, të dhënat për personat me aftësi të kufizuara, para çdo procesi votimi, me qëllim adresimin e duhur të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Të rekomandojë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për marrjen e masave të mëposhtme:

- të rishikojë Udhëzimin e Komisionit Rregullator nr. 1, datë 05.12.2020 *“Për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”* me qëllim përfshirjen e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë që duhet të plotësojnë qendrat e votimit, sipas legjisllacionit në fuqi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;

- të miratojë udhëzime të posaçme lidhur me procesin e votimit të personave me aftësi të kufizuara dhe të zhvillojë trajnime të posaçme për administratën zgjedhore lidhur me procesin e votimit nga personat me aftësi të kufizuara;
- të kontrollojë dhe të monitorojë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e detyrimeve sa i takon personave me aftësi të kufizuara, para, gjatë dhe pas zgjedhjeve;
- të marrë masa për të mbledhur të dhëna në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuar të regjistruar në zgjedhje dhe atyre që kanë votuar në zgjedhje, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, por edhe sipas kategorive ndërsektoriale, duke përfshirë edhe aspektin gjinor.

SHOQATA E INVALIDËVE PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË, DEGA TIRANË KUNDËR BASHKISË TIRANË

Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë, është përfituese sipas ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” dhe ka kërkuar të pajiset nga ana e Bashkisë, me një ambient pune ku të ushtrojë veprimtarinë e saj. Bashkia nuk e ka pajisur Shoqatën me zyrë/ambient pune, duke e diskriminuar atë për shkak të aftësisë së kufizuar.

Vendim nr. 180, datë 19.09.2022

FAKTET: Me anë të Vendimit nr. 662, datë 08.05.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Tiranë” (në vijim cituar Shoqata), është regjistruar si person juridik/organizatë joqeveritare, me seli në Tiranë, me kohëzgjatje të papërcaktuar.

Përfaqësuesi i Shoqatës, i është drejtuar disa herë Bashkisë Tiranë për pajisjen me zyrë për përdorim të Shoqatës, për të mundësuar ushtrimin e veprimtarisë së saj, por nuk ka gjetur mbështetje dhe zgjidhje nga ana e Bashkisë. Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, njeh rolin aktiv të shoqatave në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve. Në këtë kontekst, shteti financon veprimtarinë e Shoqatës sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të saj mjedise pune, të cilat ua jep në përdorim.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;

- Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane, e rishikuar;
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 *“Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji nr. 10112, datë 9.4.2009 *“Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 *“Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”*;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- VKM nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”*;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE: Komisioneri konstaton se, referuar periudhës kohore kur janë nënshkruar një pjesë e kontratave të qirasë, kohëzgjatjes së tyre, si dhe periudhave kohore kur janë paraqitur kërkesat e Shoqatës pranë Bashkisë për pajisjen me

ambjente pune, për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, Bashkia ka pasur mundësi konkrete për të përmbushur detyrimin e saj ligjor lidhur me kërkesën e përsëritur të Shoqatës.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, Shoqata, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Tiranë, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar.

Subjekti ankues ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Tiranë, përmes mosofrimit të një mjedisi pune/zyrë, megjithëse ligji, subjekt i të cilit janë, ua njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e Shoqatës.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, Shoqatës, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata deri në muajin shkurt 2022, i kishin vënë në dispozicion asaj, mjedise pune (në pronësi të Bashkisë), për përdorim pa kundërshtim nga ana e Shoqatës.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur. Mundësia e posedimit të një mjedisi të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqatës, e cila në fokus të veprimtarisë së saj ka mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, është një element i rëndësishëm në garantimin e ushtrimit dhe funksionimit të punës së tyre, për të cilën ajo ekziston si e tillë.

Bashkia nuk solli asnjë parashtrim, dokumentacion, fakt apo provë, lidhur me sa më sipër, megjithë detyrimin e saj për t'u përgjigjur e për të bashkëpunuar insitucionalisht me KMD-në, në funksion të sqarimit e zgjidhjes së problematikës së shqyrtuar, megjithëse kishte marrë dijeni shkresërisht për të.

Komisioneri vlerëson si të pranuar prej Bashkisë, faktin se nga ana e saj nuk është ndërmarrë asnjë veprim apo hap procedural në përmbushje të së drejtës së Shoqatës për t'u pajisur me një mjedis të përshtatshëm pune/zyrë në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Komisioneri konstaton se Bashkia Tiranë, me mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, "Shoqatën e Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë Dega Tiranë",

në të drejtën e saj për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për posedimin e një mjedisi të përshtatshëm pa kundërshtim, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

VENDIM: Konstatim i diskriminimit të subjektit ankues, “Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë e Tetraplegjikë, Dega Tiranë”, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Komisioneri kërkoi nga Bashkia Tiranë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

S.L KUNDËR TEATRIT KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR (TKOBAP)

S.L dhe personat me aftësi të kufizuara janë diskriminuar nga TKOB lidhur me çmimin e biletave të shitura për shfaqjen “La Boheme”, të datës 15.12.2021 dhe mungesën e vendeve të dedikuara për PAK në sallën e shfaqjeve të TKOBAP.

Vendim nr. 57, datë 18.03.2022

FAKTET: “Më datë 15.12.2021, kam blerë biletën për të ndjekur operan “La Boheme” në TKOBAP. Pasi parashtrova se jam person me aftësi të kufizuar (PAK) m’u komunikua që bileta ime ishte në radhën E, karrigia nr.32, dhe se çmimi i biletës ishte 1000 lekë, tarifë e cila ishte e njëjtë për të gjithë, megjithëse unë si person me aftësi të kufizuar duhet ta përfitoja me çmim të përgjysmuar. Pasi u paraqita në ambjentet e TKOBAP, stafi nuk kishte informacion se ku ishin vendet e dedikuara për PAK dhe vendi që më ishte caktuar në biletë ishte i paaksesueshëm nga ana ime sepse ishin të pranishme shkallët. Pasi kontaktova me stafin, i sqarova që duhet të qëndroj në një hapësirë të sheshpushimit afër me karrigen e një radhe tjetër. Gjithashtu, në lidhje me kërkesën time për tarifën e biletës, m’u komunikua se nuk kanë një udhëzim të veçantë të miratuar për PAK”.

Lidhur me sa më lart, ankuesja ka pretenduar se është diskriminuar, së pari, si individ, nga ana e TKOBAP, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke iu mohuar dy të drejta që duhej t’i njiheshin e siguroheshin nga ana e subjektit TKOBAP (Teatri), siç janë: përfitimi i biletës për të ndjekur shfaqjen me çmim të përgjysmuar, si dhe qëndrimi në vendet e dedikuara për PAK, në ambjentet e sallës ku jepen shfaqjet e Teatrit, dhe së dyti, në tagrin e përfaqësueses së Fondacionit “Së Bashku”, ka pretenduar se diskriminohet e gjithë kategoria e PAK, me të njëjtën aftësi të kufizuar si ajo, përmes mohimit të aksesimit të vendeve të dedikuara për PAK.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, neni 4 dhe 5;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane, e rishikuar;
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 *“Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 *“Për statusin e invalidit”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”*;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE: Ankuesja ka pretenduar se është diskriminuar nga ana e Teatrit, pasi në sallën e shfaqjeve ku ajo ka ndjekur operan, nuk ka patur vende të dedikuara për të, si person me AK, me status tetraplegjiku, në pëmbushje të specifikimeve të bëra në VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*.

Ky pretendim i ankueses rezulton të jetë i vërtetë, pasi një fakt i tillë është pranuar si i mirëqenë nga ana e TKOBAP, madje dhe ka shprehur vullnetin se: *“Nëse në të ardhmen me vendimarrje të përbashkët me Ministrinë e Kulturës mund të vendoset të heqim disa karrige për të mundësuar qëndrimin e personave me aftësi të kufizuar, mund të bëhet e mundur dhe akomodimi i tyre”*.

Nisur nga fakti se godina e TKOBAP-së është rikonstruktuar së fundmi, dhe VKM-ja sipërcituar i ka shtrirë efektet ligjore që prej vitit 2008 e aktualisht, përcaktimet e saj lidhur me numrin e vendeve të dedikuara për PAK, në proporcion me numrin total të kapacitetit të vendeve ulur të Teatrit, duhet të ishin marrë në konsideratë paraprakisht nga ana e Institucionit.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues/PAK me status tetraplegjiku, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Teatrit, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata kishin shprehur vullnetin për të përmbushur detyrimin ligjor përsa i takon rimbursimit të biletës së shfaqjes, si dhe për të ndihmuar në akomodimin e saj në ndjekjen e shfaqjes së datës 15.12.2021.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur dhe me dinjitet. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson vullnetin e shprehur nga ana e TKOBAP për të ndërmarrë hapa konkretë lidhur me mundësinë për sigurimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) vendeve të dedikuara për PAK, proporcionalisht me numrin në total të vendeve të sallës së Teatrit, por, thekson se, mungesa e këtyre vendeve aktualisht, dhe deri në momentin e krijimit të tyre, konform parashikimeve ligjore sipërcituar, i vë ata në pozita të pabarabarta e të pafavorshme me të tjerët që nuk posedojnë shkakun e mbrojtur, duke çenuar dinjitetin e tyre, përmes sistemimit të tyre në vende të tjera, që nuk janë të dedikuara për ta, duke bërë që ata të ndjehen të diferencuar e të ekspozuar në vendet e përshtatura (siç është përshtatja e hapësirave në rreshtin me korridorin më të gjerë/ rreshti I, i protokollit G, cituar në përgjigjen e TKOBAP drejtuar Komisionerit).

Komisioneri arrin në përfundimin se salla e shfaqjeve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor, nuk përmbush të gjitha standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë TKOBAP, si subjekti i cili duhet të kishte siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë.

Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, përfshirë edhe të drejtën për një jetë sociale e kulturore, Komisioneri vlerëson se mospërmbushja e standardeve teknike të miratuara, me qëllim sigurimin e 16 (*gjashtëmbëdhjetë*) vendeve të dedikuara për PAK, në kuadër të aksesueshmërisë dhe eliminimit të

barrierevae arkitektonike, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara (*përfshirë edhe subjektin ankues si individ i veçantë*) ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret, në raport me pjesën tjetër të publikut.

Komisioneri konstaton se TKOBAP, me mosveprimin e tij, ka diskriminuar subjektin ankues, dhe të gjithë PAK, në të drejtën e tyre për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për aksesim në vendet e dedikuara për PAK.

VENDIM: Konstatimi i diskriminimit të shtetases S. L dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, nga ana e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Komisioneri kërkoi të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e TKOBAP, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë për vendet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*.

Komisioneri i rekomandoi TKOBAP, në kuadër të marrjes së masave pozitive për PAK, të marrë masa konkrete për reduktim të çmimit të biletës, për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

FONDACIONI “SË BASHKU” KUNDËR ZYRËS SË POSTËS SHQIPTARE SH.A., NË QENDËR TË BASHKISË SHIJAK

Mungesa e standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Shijak, ka vënë në pozita të pafavorshme dhe ka diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar personat PAK.

Vendim nr. 115, datë 20. 06. 2022

FAKTET: Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjekti ankues pretendon se personave me aftësi të kufizuara i është mohuar trajtimi i barabartë dhe janë diskriminuar lidhur me mungesën e standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Shijak, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996);

- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 *“Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar (në vijim, Kodi Civil);
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 *“Për statusin e invalidit”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”*;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE: Rezultoi e provuar se Zyra Postare Qendër Shijak nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Qendër Shijak. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara që marrin shërbime pranë Zyrës Postare Qendër Shijak, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë së Zyrës Postare Qendër Shijak, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a. dhe marrjen e masave për heqjen

e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Qendër Shijak. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a., në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Shijak.

Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa të menjëhershme për:

- Plotësimin e të gjitha standarteve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Shijak, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”* dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.

Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a. që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

FONDACIONI “SË BASHKU” KUNDËR ZYRËS SË POSTËS SHQIPTARE SH.A., NË QENDËR TË NJËSISË ADMINISTRATIVE SUKTH.

Mungesa e standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare në qendër të Njesisë Administrative Sukth, ka vënë në pozita të pafavorshme dhe ka diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar personat PAK

Vendim nr. 124, datë 20. 06. 2022

FAKTET: Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjekti ankues pretendon se personave me aftësi të kufizuara i është mohuar trajtimi i barabartë dhe janë diskriminuar lidhur me mungesën e standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare në qendër të Njesisë Administrative Sukth për shkak të aftësisë së kufizuar.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim, Kodi Civil);
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE: Komisioneri, në praktikën e tij, ka konstatuar shkelje të ndalimit të diskriminimit të parashikuar nga LMD, në çështje të ngjashme, ku Posta Shqiptare sh.a., nuk kishte marrë masa për heqjen e pengesave/barrierave dhe për të përmbushur detyrimin për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, në një tjetër zyrë postare të saj⁶.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në Zyrës Postare Qendër Sukth, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerësoi se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Qendër Sukth. Për rrjedhojë Komisioneri arriti në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe

6. Shih: *Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a.*, vendimi nr.10, datë 21.01.2021, i Komisionerit; *Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a.*, vendimi nr. 111, datë 10.06.2022, i Komisionerit; *Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a.*, vendimi nr. 115, datë 13.06.2022, i Komisionerit.

më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri konstatoi se:

- Posta Shqiptare sh.a. ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a., më shumë se një herë nuk ka garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke mohuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në baza të barabarta me të tjerët, në marrjen e shërbimeve pranë disa zyrave të tjera postare ku Posta Shqiptare sh.a. ushtron aktivitetin e saj, sikundër janë: Zyra Postare Qendër Shkodër, konstatuar me vendimin nr. 10, datë 21.01.2021 të Komisionerit; Zyra Postare Qendër Durrës, konstatuar me vendimin nr. 111, datë 10.06.2022, të Komisionerit dhe Zyra Postare Qendër Shijak, konstatuar me vendimin nr. 115, datë 13.06.2022, të Komisionerit.
- Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a., nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM nr. 1503/2008, miratimin e VKM nr. 1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendimit të Komisionerit nr. 10, datë 21.01.2021, ku Posta Shqiptare është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit *në formën e rëndë të tij*, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Qendër Sukth.

Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a., të marrë masa të menjëhershme për:

- Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Qendër Sukth, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

- Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.

Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a. që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

FONDACIONI “SË BASHKU” KUNDËR BASHKISË KAMËZ

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në rrugët dhe trotuarët kryesorë të Bashkisë Kamëz, për personat me aftësi të kufizuara, vendos këto persona në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të AK.

Vendim nr. 197, datë 27.10.2022

FAKTET: Nga informacioni i administruar rezulton se, “Bulevardi Nënë Tereza”, që përbën dhe objektin kryesor të ankesës, është e paaksesueshme, në mënyrë të pavarur nga personat me aftësi të kufizuara.

Aksi rrugor i Bulevardit Nënë Tereza në Bashkinë Kamëz, veçanërisht ishulli për këmbësorë i këtij bulevardi ka bordurë, e cila përbën pengesë infrastrukturore dhe nuk lejon personat me aftësi të kufizuara në lëvizje të cilët janë përdorues të karrigës me rrota, që të kalojnë nga njëra anë e rrugës në tjetrën. Lartësia e bordurës dhe mungesa e fushës relievore, përbëjnë një burim vështirësie për lëvizjen e të gjithë atyre personave që kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;

KONKLUZIONE: Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislatiioni në fuqi, rezultoi e provuar se Bashkia Kamëz, kryesisht në gjatësinë e Bulevardit Nënë Tereza, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë, Bashkia Kamëz, parashtroi se është duke marrë të gjitha masat e nevojshme për hartimin, projektimin dhe zbatueshmërinë lidhur me përshtatshmërinë e rrugëve me qëllim funksionimin e tyre nga të gjitha grup-moshat me karakteristika të veçanta. Bashkia Kamëz nuk paraqiti asnjë informacion dhe dokumentacion përpara Komisionerit lidhur me planifikimin e fondeve për përshtatjen/ aksesueshmërinë e rrugëve/trotuareve kryesore për personat PAK dhe afatet kohore për realizimin e këtyre investimeve.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në aksin rrugor të Bulevardit Nënë Tereza, të Bashkisë Kamëz, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Kamëz dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave

për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Kamëz.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Bashkia Kamëz nuk kishte marrë masa për të siguruar standardet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Bashkisë Kamëz, i standardeve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Kamëz, në lidhje me aksesueshmërinë e këtyre personave në aksin rrugor të Bulevardit Nënë Tereza.

Bashkia Kamëz, të marrë masa të menjëhershme për:

- Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në aksin rrugor të Bulevardit Nënë Tereza, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008.
- Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

FONDACIONI “SË BASHKU” KUNDËR POSTËS SHQIPTARE SH.A.

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare në qendër të Njësisë Administrative Ishëm vendos personat me aftësi të kufizuara në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të AK.

Vendim nr. 142, datë 19.07.2022

FAKTET: Zyra Postare Ishëm, që përbën edhe objektin e ankesës, është një nga zyrat postare pjesë e Filialit të Postës Shqiptare sh.a, Durrës. Nga pamjet fotografike të Zyrës Postare Ishëm, të vëna në dispozicion nga pala ankuese, rezulton që godina ku ofrohen shërbimet nga ana e kësaj zyre postare, ka në hyrje të saj disa shkallë dhe si pasoje e paaksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese);
- Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;

- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;

KONKLUZIONE: Komisioneri konstatoi se, Posta Shqiptare sh.a., në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive dhe brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në ofrimin e shërbimeve nga ana e saj.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Ishëm, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Postës Shqiptare sh.a dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet e ofruara në Zyrën Postare Ishëm. Në këto kushte, Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a., nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM nr. 1503/2008, miratimin e VKM nr. 1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendimit të Komisionerit nr. 10, datë 21.01.2021, ku Posta Shqiptare është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Posta Shqiptare sh.a. nuk kishte marrë masa për të siguruar standardet teknike të aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë plotësimi nga ana e Postës Shqiptare sh.a., i standardeve teknike të aksesueshmërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Komisioneri evidenton ndër të tjera edhe nevojën për kryerjen e trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere nga ana e Postës Shqiptare sh.a., për të gjitha strukturat e saj, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në nenin 9/2/c, i KDPAK, rritja e ndërgjegjësimit lidhur me aksesueshmërinë, konsiderohet si një nga masat e duhura për eliminimin e pengesave/barrierave dhe garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Lloji dhe natyra e shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a., shërbime të cilat kanë ndikim në jetën e personave me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike, kërkon me forcë marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit *në formën e rëndë të tij*, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj, pranë Zyrës Postare Ishëm. Posta Shqiptare sh.a., të marrë masa të menjëhershme për:

- Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Ishëm, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”* dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.
- Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.

FONDACIONI “SË BASHKU” KUNDËR BASHKISË VORË

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë së trotuareve në territorin e Bashkisë Vorë vendos personat me aftësi të kufizuara në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të AK.

Vendim nr. 202, datë 07. 11. 2022

FAKTET: Subjekti ankues pretendon se personave me aftësi të kufizuara i është mohuar trajtimi i barabartë dhe janë diskriminuar lidhur me mungesën e standardeve të aksesueshmërisë së trotuareve në territorin e Bashkisë Vorë.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996);
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar;

- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE: Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, Komisioneri konstatoi se, Bashkia Vorë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj. Gjithashtu, rezulton se rruga “Unaza” që përbën edhe objektin kryesor të ankesës, ndodhet përpara godinës së Bashkisë Vorë, çka pamundëson aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të barabartë me personat e tjerë. Rezulton se në aksin rrugor “Unaza”, janë të vendosura dhe ofrojnë shërbime të përditshme institucione publike dhe private që ofrojnë shërbime kryesore të nevojshme për banorët e këtij qyteti si: Bashkia, Posta Shqiptare, etj. Për të funksionuar në mënyrë efektive dhe të sigurt në punë, arsim dhe jetën e përditshme, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë akses fizik në të njëjtat hapësira, punësim, mallra, shërbime dhe pjesëmarrje në komunitet, si të gjithë qytetarët e tjerë.

Komisioneri arriti në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në rrugën “Unaza”, të Bashkisë Vorë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barrierë/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Vorë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në territorin e saj. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Vorë, në lidhje me aksesueshmërinë e këtyre personave në aksin rrugor, rruga “Unaza”.

Bashkia Vorë, të marrë masa të menjëhershme për:

- Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në aksin rrugor, rruga “Unaza”, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”* dhe nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.
- Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

FONDACIONI “SË BASHKU” KUNDËR ZYRËS POSTARE KAMËZ

Zyra Postare Kamëz nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi duke diskriminuar personat me aftësi të kufizuar, pasi ndërtesa, ku ushtron funksionet e saj nuk plotëson kriteret e aksesueshmërisë fizike për këtë kategori.

Vendim nr. 222, datë 20.12.2022

FAKTET: Fillimisht, Fondacioni “Së Bashku” e bën me dije KMD-në se që prej muajit prill 2022, është duke zbatuar nismën “Të rinjtë për gjithëpërfshirjen”, në Bashkitë Kamëz, Vorë dhe Kavajë. Nga takimet e zhvilluara me personat me aftësi të kufizuar në Bashkinë Kamëz, është konstatuar se godina pranë së cilës ushtron funksionet e saj Zyra e Postës Shqiptare Kamëz nuk plotëson kushtet e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuar.

Njëkohësisht, ankuesi ka sjellë edhe foto të ambienteve të brendshme të godinës dhe thekson faktin se në to mungojnë standardet ligjore për garantimin e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuara të parashikuara në Vendimin e nr. 1503, datë 19.11.2008, e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”. Subjekti ankues thekson faktin se në këtë godinë nuk ekzistojnë gjithashtu as standardet e aksesueshmërisë fizike për personat që kanë probleme me shikimin dhe me dëgjimin.

Subjekti ankues pretendon se Zyra Postare Kamëz nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi duke diskriminuar personat me aftësi të kufizuar, pasi ndërtesa, ku ushtron funksionet e saj nuk plotëson kriteret e aksesueshmërisë fizike për këtë kategori vulnerabël.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Konventën e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*
- Ligji nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*7,
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*.
- Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.
- Vendimi nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*
- Ligji nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*,
- Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar*

KONKLUZIONE: Rezulton e provuar se Zyra Postare Kamëz nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që marrin shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a., pranë Zyrës Postare Kamëz. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se grupi i personave me aftësi të kufizuara, trajtohet në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara që marrin shërbime pranë Zyrës Postare Kamëz, të cilët nuk përballen me barrierë/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

7. Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KDPAK.

Sipas KDKPAK, edhe pse sigurimi i aksesit në mjedisin fizik, transport, informacion dhe komunikimi dhe shërbimet e hapura për publikun është shpesh një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, sigurimi i aksesueshmërisë mund të arrihet përmes realizimit progresiv.

Realizimi progresiv kupton se heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Komisioneri e vlerëson të pabazuar pretendimin e Postës Shqiptare, lidhur me pamundësinë për të ndërtuar rampë, qoftë edhe rampë të lëvizëshme, në hyrje të godinës së saj për të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuara. Përpos kësaj, kjo shoqëri nuk ka përmendur në asnjë rast plotësimin e kritereve të aksesueshmërisë fizike për personat e verbër dhe ata që nuk dëgjojnë. Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e kategorive të personave me aftësi të kufizuara edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu që, vendosja e një rampe, nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi gjithashtu se, Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë për personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë ose me shikim apo dëgjim të kufizuara.

Rezultoi gjithashtu se Posta Shqiptare sh.a. nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe për të planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”* dhe është rekomanduar në mënyrë specifike nga ana e Komisionerit me vendimin e tij nr. 10, datë 21.01.2020.⁸

Komisioneri thekson se, në praktikën e tij, ka konstatuar shkelje të ndalimit të diskriminimit të parashikuar nga LMD, të ndryshuar, në çështje të ngjashme, ku Posta Shqiptare sh.a., nuk ka marrë masa për heqjen e pengesave/barrierave dhe për të përmbushur detyrimin për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, në një tjetër zyrë postare të saj⁹.

8. Nëpërmjet këtij vendimi, KMD ka rekomanduar Postën Shqiptare sh.a. që brenda 6 (gjashtë) muajve të hartonte një plan masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Sipas këtij rekomandimi, pjesë e planit të masave duhet të ishte planifikimiprogresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

9. Shih: *Fondacioni Së bashku kundër Postës Shqiptare sh.a.*, vendimi nr.10, datë 21.01.2020, i KMD.

Komisioneri arrin në përfundimin se mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në Zyrës Postare Kamëz, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a. në këtë zyrë postare. Komisioneri konstaton se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Komisioneri konstaton se:

- Posta Shqiptare sh.a. ka kryer më shumë se një herë sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Rezulton se, Posta Shqiptare sh.a., më shumë se një herë nuk ka garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, duke mohuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në baza të barabarta me të tjerët, në marrjen e shërbimeve pranë disa zyrave të tjera postare ku Posta Shqiptare sh.a. ushtron aktivitetin e saj, sikundër janë: Zyra Postare Qendër Shkodër, konstatuar me vendimin nr. 10, datë 21.01.2021 të Komisionerit; Zyra Postare Qendër Durrës, konstatuar me vendimin nr. 111, datë 10.06.2022, të Komisionerit dhe Zyra Postare Qendër Shijak, konstatuar me vendimin nr. 115, datë 13.06.2022, të Komisionerit.
- Sjellja diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, pasi Posta Shqiptare sh.a., nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar aksesueshmërinë në zyrat postare ku ofron shërbimet, pavarësisht faktit se standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë janë miratuar që prej vitit 2008, me VKM nr. 1503/2008, miratimin e VKM nr. 1074/2015, ku janë përcaktuar masat për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara, si dhe vendimit të Komisionerit nr. 10, datë 21.01.2021, ku Posta Shqiptare është rekomanduar që të hartojë një plan të detajuar masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit nga ana e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria.

Komisioneri evidenton ndër të tjera edhe nevojën për kryerjen e trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese nga ana e Postës Shqiptare sh.a., për të gjitha strukturat e saj, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në nenin 9/2/c, i KDPAK, rritja e ndërgjegjësimit lidhur me aksesueshmërinë, konsiderohet si një nga masat e duhura për eliminimin e pengesave/barrierave dhe garantimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Lloji dhe natyra e shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a., shërbime të cilat kanë ndikim në jetën e personave me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike, kërkon me forcë marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit në formën e rëndë të tij, të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me mosgarantimin e standardeve të aksesueshmërisë fizike, në godinën ku ushtron funksionet e saj, Zyra Postare Kamëz.

Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa të menjëhershme:

- Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Kamëz, sipas parashikimeve në Vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe në Vendimin nr.1074, datë 23.12.2015 e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.

Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a. që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

S. C., KUNDËR POSTËS SHQIPTARE

Zyrës Postare Tiranë Nr. 15 nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi duke diskriminuar personat me aftësi të kufizuar, pasi ndërtesa, ku ushtron funksionet e saj nuk plotëson kriteret e aksesueshmërisë fizike për këtë kategori.

Vendim nr. 21, datë 03. 02. 2021

FAKTET: Ankuesi pretendon se është paraqitur pranë Zyrës Postare Tiranë Nr. 15, për të marrë një mandat pagese. Kur ka mbërritur në këtë zyrë postare, ankuesi ka konstatuar faktin se mungon aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuar, duke i mohuar atij të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara në mënyrë të lirë dhe të pavarur. Në këto kushte, i është drejtuar një punonjëseje të Zyrës Postare, duke i kërkuar ti ofronte shërbimin në ambjentet e jashtme të zyrës, duke qënë se ai e kishte të pamundur të aksesonte ambjentet e Zyrës Postare Nr. 15, në mungesë të rampës. Sipas ankuesit, punonjësja e Zyrës Postare, i është përgjigjur duke i thënë se nuk ka një urdhër të tillë për t'i shërbyer atij në ambjentet e jashtme të zyrës.

Në këtë kuptim, mungesa e aksesueshmërisë së Zyrës Postare Nr. 15, ka bërë që ankuesi të mos marrë shërbimin e nevojshëm si të gjithë qytetarët e tjerë, duke u vënë kështu në kushte të pabarabarta dhe diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese ndaj tij, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe të zbatohet legjislacioni sa i përket përshtatshmërisë.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese);
- Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;

KONKLUZIONE: Nga korrespondenca me Posten Shqiptare sha Komisioneri u informua:

Në investimet e programuara për Zyrat Postare është pasur në vëmendje krijimi i ambjenteve bashkëkohore me përshtatshmëri dhe për shtresat me aftësi të kufizuara, por duhet theksuar se duke qënë se Zyra Postare Nr. 15, është një ambient i marrë me qira, Shoqëria “Posta Shqiptare” po merr te gjitha masat për të mundësuar aksesueshmërinë në këtë zyrë. Në kuadër te strategjisë së “Posta Shqiptare” sh.a., për përmirësimin e vazhdueshëm të ambjenteve në të cilën kryhen shërbimet, Posta Shqiptare investon në rikonstruksionet e ambjenteve, ku një nga kriteret është dhe krijimi i aksesit për shërbimet ndaj personave me aftësi të kufizuara.”.

Posta Shqiptare sh.a,informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“.. është firmosur Proces-Verbali me nr. 1678 prot., mes z. F. H., me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, dhe znj. D. T., pronare e objektit, në të cilin mes palëve është dakordësuar që brenda muajit Dhjetor 2020 nga ana e znj. D. T. do të merren masat e menjëhershme për*

të ndërhyrë në pjesën e përparme të objektit, për vendosjen e një rampe, për të mundësuar në këtë mënyrë kryerjen e shërbimeve programeve postare të ofruara nga Zyra Postare Nr. 15, edhe për personat me aftësi të kufizuara...”

Në vijim, pas kontaktit të marrë me Postën Shqiptare sh.a., më datë 01.02.2021, nga ana e tyre u përcoll pranë Komisionerit, foto gjatë dhe pas realizimit të rampës në pjesën e përparme të objektit të Zyrës Postare Nr. 15 Tiranë.

Komisioneri vlerëson frymën bashkëpunuese të Postës Shqiptare sh.a., lidhur me marrjen e masave për zgjidhjen me efektivitet të problematikës së paraqitur nga ana e shtetasit S. C.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerësoi, se kërkesa e S. C., është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim.

Në përfundim, Komisioneri mbështetur në llojin dhe natyrën e shërbimeve që ofrohen nga Posta Shqiptare sh.a, shërbime të cilat kanë ndikim në jetën e personave me aftësi të kufizuara, siç janë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike, në vijim kërkon marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë në Zyrat Postare të saj në të gjithë Republikën e Shqipërisë

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur, lidhur me shqyrtimin e ankesës së S. C., pasi është arritur qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore dhe ankuesi është tërhequr nga ankesa.

SHOQATA KOMBËTARE “SHPRESË PËR TË VERBËRIT”, KUNDËR BASHKISË DURRËS

Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Bashkisë Durrës dhe zgjidhjen e problematikës për pajisjen me zyrë për përdorim të Shoqatës, për të mundësuar ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Vendim nr. 192, datë 11.10. 2021

FAKTET: Sipas shpjegimeve të dhëna, përfaqësuesi i Shoqatës, në mes të tjerash informon se: *“Në cilësinë e presidentit të Shoqatës i jam drejtuar disa herë Bashkisë Durrës për pajisjen me zyrë për përdorim të Shoqatës, për të mundësuar ushtrimin e veprimtarisë së saj. Nëpërmjet shkresave¹⁰ të ndryshme kemi përsëritur disa herë kërkesën tonë për pajisjen me zyrë, por nuk kemi gjetur mbështetje dhe zgjidhje nga ana e Bashkisë. Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” njih rolin aktiv të shoqatave në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbëve. Në këtë kontekst, shteti financon veprimtarinë e Shoqatës sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të saj mjedise pune, të cilat ua jep në përdorim”.*

Moszgjidhjen e kësaj problematike nga ana e Bashkisë, Shoqata, e sheh si një diskriminim që i bëhet asaj, pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar, duke i mohuar një të drejtë që buron nga parashikimet ligjore.

Në përfundim të ankesës, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e problematikës me anë të ndërmjetësimit, për marrjen e masave nga ana e Bashkisë Durrës për pajisjen me zyrë të Shoqatës.

10. Kërkesë me nr. 13201 prot., datë 05.12.2019

Kërkesë me nr. 13353/1 prot., datë 05.11.2020

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese);
- Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;

KONKLUZIONE: Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹¹, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, Shoqata, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Durrës, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar.

Ankuesit kanë pretenduar se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Durrës, përmes mosofrimit të një ambjenti pune, megjithëse ligji, subjekt i të cilit janë, ua njeh këtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e Shoqatës.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, Shoqatës, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata kishin shprehur vullnetin për të gjetur ambiente në pronësi të saj, për përdorim pa kundërshpërblim nga ana e Shoqatës.

¹¹. Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur. Mundësia e posedimit të një ambjenti të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqatës, e cila në fokus të veprimtarisë së saj ka mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, është një element i rëndësishëm në garantimin e ushtrimit dhe funksionimit të punës së tyre, për të cilën ajo ekziston si e tillë.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve (Shoqatave), duhet të sigurohet që t'i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Durrës, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, Shoqatën Kombëtare "Shpresë për të Verbërit", në të drejtën e saj për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për posedimin e një ambjenti të përshtatshëm pa kundërshtëpërlim, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Për rrjedhojë Bashkia Durrës, ka shkelur dispozitat e ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur të subjektit ankues nga ana e Bashkisë Durrës, dhe kjo mund të realizohet:

- Ose nëpërmjet ofrimit nga ana e Bashkisë, të një ambjenti të përshtatshëm për ushtrimin e funksionit dhe aktivitetit të Shoqatës, (bazuar në kërkesën e saj), në ambjentet e ish-URT-së;
- Ose në pamundësi të sa më sipër, përkohësisht, nëpërmjet realizimit të pagesës së qirasë së një ambjenti tjetër të përshtatshëm, me dakordësinë e Shoqatës, deri në momentin kur nga ana e Bashkisë të krijohet mundësia e sistemimit të Shoqatës në një nga ambjentet në pronësi të saj, pa kundërshtëpërlim.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, Shoqatës Kombëtare "Shpresë për të Verbërit", në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Bashkia Durrës, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

Z. F, KUNDËR: SUBJEKTIT PRIVAT BAR “LE 5 STELLE¹²”, SARANDË DHE BASHKISË SARANDË,

Pengesa e aksesueshmërisë së apartamentit nga subjekti privat Bar “Le 5 Stelle” dhe mosveprimet e Bashkisë Sarandë, kanë vënë ankuesin në kushte të pafavorshme për shkak të aftësisë së kufizuar.

Vendim nr. 234, datë 10. 12 . 2021

FAKTET: Subjekti ankues, Z. F¹³, në vitin 2015 ka blerë një apartament nga kompania “Noku-O-S-2008” sh.p.k, në lagjen nr.1, Sarandë, sipas kushteve të rëna dakord dhe të nënshkuara nga të dyja palët, në Kontratën e Sipërmarrjes të datës 28.07.2015, përpara noterit Th. K.

Ankuesi në parashtrimet e tij, shprehet se, në momentin e blerjes së apartamentit dhe garazhit, kushtet e specifikuar sipas Kontratës së Sipërmarrjes kanë qenë të respektuara dhe të zbatuara. Në objektin e kësaj Kontrate, specifikohet se: “*Ashensori do të ketë përmasa minimale me hapje të derës 90 cm, me gjatësi 1,40 cm x 1,20 cm. Objekti do të ketë hyrje dhe nga vendi i parkimit për hyrje të personave me aftësi të kufizuar si dhe djathtas hyrjes kryesore, ku objekti ndodhet në nivelin e rrugës*”.

Z. F shprehet se: “*Deri në vitin 2018 ka qenë e ndërtuar një rampë në krahun e djathtë të portës hyrëse në pallat, e cila shfrytëzohej nga ana ime për të shkuar në apartament. Kur erdha në muajin qershor 2021, rampa ishte hequr nga personi që zotëron një biznes privat në katin e parë të ndërtesës. Personi që zotëron këtë biznes, Bar “Le 5 Stelle”, ka prishur pjesën e rampës duke marrë gjysmën e ballkonit*

-
- 12.** Gjatë shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues ka hequr dorë nga pretendimi për diskriminim nga ana e subjektit privat “Le 5 Stelle”, duke ia ngarkuar përgjegjësinë Bashkisë Sarandë, si organ përgjegjës dhe pretendon për diskriminim nga ana e Bashkisë.
 - 13.** Bazuar në pasaportën e ankuesit dhe deklaratimet e tij, ai rezulton me shtetësi suedeze dhe origjinë nga Kosova.

që ka qenë si shesh pushimi dhe e ka ndërtuar me shkallë, gjë që bën të pamundur lëvizshmërinë time si invalid (me karrocë) që jam”.

Ankuesi i është drejtuar Bashkisë Sarandë, duke i kërkuar që të marrë masa për detyrimin e pronarit të lokalit për rindërtimin e rampës, pasi zgjerimi i ambjenteve të biznesit të tij, ka cënuar hapësirën e përbashkët në të cilën ishte e vendosur rampa dhe në këto kushte ai e ka të pamundur të aksesojë banesën e tij.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të marrë masa për ndalimin e diskriminimit të tij, duke detyruar subjektin privat Bar “Le 5 Stelle” dhe Bashkinë Sarandë, të marrin masa për rivendosjen e rampës.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
 - Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
 - Vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese);
 - Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;*
 - Ligjit nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;*
 - Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;*
 - Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
 - VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;*
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;*

KONKLUZIONE: Aksesueshmeria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për

të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Ankuesi ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë, përmes mosofrimit të mundësisë për të aksesuar banesën e tij (ndërtimit të rampës në mënyrë që ai të aksesojë vajtjen deri tek ashensori, për në banesë), megjithëse ligji, subjekti i të cilit janë, ua njehtë të drejtë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e tij.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, si dhe mundësisht t'u garantojë jetesa e pavarur.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve, (përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara) duhet të sigurohet që t'i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe në raport me të drejtat e tyre ligjore të parashikuara, të njohura dhe të detyrueshem për t'u zbatuar për këtë kategori personash.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje, analizimit të fakteve, provave të shqyrtuara, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që ankuesi është person me aftësi të kufizuar, i cili lëvizën me karrocë me rrota, atij i është mohuar dhe shkelur e drejta ligjore lidhur me aksesueshmërinë në banesë, masë e cila duhet të ishte marrë nga ana e Bashkisë.

Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Sarandë nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë konkretisht për zgjidhjen e kësaj situatë.

Bashkia, kishte barrën e provës që të provonte, që megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Sarandë nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të garantuar aksesin e ankuesit për në banesën e tij, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë efektive dhe përfundimtare.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Sarandë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, përse i takon mosmarrjes të masave për zgjidhjen efektive të ankesës së tij, lidhur me realizimin e aksesueshmërisë së lëvizjes së tij për në banesë.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, Z. F, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Sarandë, për shkak të aftësisë së kufizuar. Bashkia Sarandë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

L.D KUNDËR LINJËS SË TRANSPORTIT GOLEM-KAVAJË,

Subjektit ankues, person me aftësi të kufizuara i është mohuar e drejta e transportit sipas parashikimeve të ligjislacionit në fuqi.

Vendim nr. 86, datë 09.06. 2023

FAKTET: Bazuar në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesi L.D pretendon se ka udhëtuar me autobusin me targë AA021OB në linjën Golem-Kavajë. Gjatë udhëtimit ankuesi pretendon se është diskriminuar, pasi i është kërkuar nga fatorino i autobusit që të paguaj biletën e plotë dhe jo gjysmën e çmimit të biletës, duke mos i'u njohur e drejta për të udhëtuar sipas parashikimeve të ligjit nr.8098, datë 28.03.1996. Ankuesi shprehet se, fatorino i tha se, nuk pyeste njëri dhe nuk e njihnte librezën dhe ligjin sepse ishte privat. Ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit biletën me të dhëna “Seria N/22”, me të cilën pretendon se është pajisur gjatë këtij udhëtimi.

Përfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për eliminimin e pasojave.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”* (Ndryshuar me ligjin nr. 26, datë 15.03.2012).
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- VKM nr. 277, datë 18.06.1997 *“Për përfitimet nga statusi i të verbërit”*, i ndryshuar,
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;

KONKLUZIONE: Në kushtet që, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Golem-Kavajë, me të cilën kishte udhëtuar në datën 13.04.2023, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese, Komisioneri, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi i kryer nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës rezulton se autobusi me targë AA021OB, i takon tatimpaguesit I.K, shoqëri e transportit publik e pajisur me biletat me të dhëna “Seria N/22”, (seria N/22 tregon distancën deri në 22 km), me NIPT XXXXXXXXXX. Tatimpaguesi i sipërcituar, ka tërhequr për herë të fundit bileta interurbane me distanca 22 km, më datë 06.09.2019.”*

Gjatë procedurës hetimore subjekti kundër të cilit drejtohet ankesa pranon situatën dhe justifikohet me faktin që faturina nuk ka patur dijeni sa i takon te drejtave të personave AK. Subjekti kërkon mundësinë e rregullimit të situatës duke premtuar që në vijim nuk do të ndodhin më situata të ngjashme nga subjekti në ofrimin e shërbimit për personat AK. Me dakortësinë e ankuesit ceshtja u mbyll me tërheqjen e ankesës dhe rregullimin e situatës.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka

filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb dhe pala ankuese zyrtarisht ka deklaruar se tërhiqet nga ankesa, pasi ka arritur në një zgjidhje me mirëkuptim të problematikës së bashku me subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesën, personit fizik I.K me NIPT XXXXXXXXXXXX.

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

Rekomandohet Personi Fizik I.K, me NIPT XXXXXXXXXXXX, që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:

- Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit pa pagesë për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
- Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
- Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.

M.R KUNDËR SHOQËRISË SË TRANSPORTIT “URBAN TRANS VLORE” DHE BASHKISË VLORE

Subjektit ankues, person me aftësi të kufizuara i është mohuar e drejta e transportit sipas parashikimeve të ligjislacionit në fuqi.

Vendim nr. 87, datë 09.06.2023

FAKTET: Subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Për shkak të nevojave shëndetësore më është dashur që të përdor shërbimin publik të transportit urban dhe më është dashur që të paguaj biletë urbane sa herë që kam udhëtuar me linjën e urbanit brenda qytetit dhe më kanë thënë se shërbimi është me pagesë dhe ti nuk përjashtohesh nga kjo tarifë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen masave për eliminimin e pasojave që shkakton mosnjohja e të drejtës së tij për transport pa pagesë.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese);
- Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” (Ndryshuar me ligjin nr. 26, datë 15.03.2012).
- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar,
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;

KONKLUZIONE: Shoqëria “Urban Trans Vlorë”, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Shoqëria “Urban Trans Vlorë” e cila ushtron aktivitetin në transportin publik në Bashkinë Vlorë nuk u merr lekë personave të cilët kanë dokumente që përfitojnë nga ligji për udhëtim falas në urban. Nisur nga rasti, z. M.R ka patur një konflikt me faturinon për shkak të mungesës së raportit mjekësor. Nga ballafaqimi që patëm me zotërinë dhe përfaqësuesin e Bashkisë Vlorë, verifikuam rastin dhe e zgjidhem si problem¹⁴. Ne ramë dakord që zotëria të udhëtojë pa pagesë në urban, por të jetë i pajisur me librezë dhe raport mjekësor. Ju bëjmë me dije se të gjithë personat që janë të pajisur me librezë dhe raporte mjekësore, udhëtojnë pa pagesë sipas ligjit dhe për këtë shërbim, ne si kompani nuk kemi marrë asnjë subvencion”.

Bashkia Vlorë, informoi Komisionerin se: “Bashkia Vlorë, Shoqëria “Urban Trans Vlorë” shpk dhe z. M.R, në datë 18.05.2023 patën diskutime dhe ballafaqime lidhur me shqetësimin e paraqitur nga qytetari, të cilit i kërkojnë të paguaj biletë në transportin urban dhe qytetari shpreh shqetësimin se është invalid i verbër i grupit të II dhe për këtë arsye nuk duhet të paguaj. Në këtë takim u arrit që ankuesi të udhëtojë falas në shërbimin urban, por duke qenë i pajisur gjithmonë me librezën e verbërisë së bashku me raportin mjeko ligjor.

14. Referuar procesverbalit datë 18.05.2023 të mbajtur mes ankuesit, përfaqësuesit të Bashkisë Vlorë dhe Administratorit të Shoqërisë Urban Trans Vlorë.

Në bazë të Kontratës për transport udhëtarësh në linjat urbanë nr. 1382, datë 20.02.2017, mes Bashkisë Vlorë dhe subjektit Urban Trans Vlorë, në nenin 9 parashikohet se: “Kontraktori detyrohet që të garantojë udhëtimin e të gjithë kategorive të udhëtarëve që sipas legjislacionit përfitojnë lehtësira në udhëtim si: udhëtimi me bileta pajtimi (abone), udhëtimi pa pagesë kundrejt paraqitjes së dokumentacionit që parashikon ligji, etj.”, subjekti ta kryejë këtë transport urban sipas akteve nënligjore.

Me subjektin “Urban Trans Vlorë” shpk, Bashkia Vlorë ka pasur korrespondenca lidhur me këtë shqetësim të qytetarëve ku janë pasqyruar dhe është theksuar se ky subjekt, do të sigurojë lehtësi në qarkullimin e transportit urban të personave të verbër, ku këta persona do të udhëtojnë falas, kundrejt paraqitjes së dokumentit të verbërisë të lëshuar nga organet e autorizuar dhe raportet përkatëse.

Aktualisht ky shërbim kryhet falas nga subjekti “Urban Trans Vlorë” shpk, për të gjithë personat e verbër, që disponojnë dokumentet e sipërcituara”.

Ankuesi M.R, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar masat e marra nga Shoqëria “Urban Trans Vlorë”, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për zgjidhjen e ankesës së tij, lidhur me udhëtimin pa pagesë në linjën e transportit urban në qytetin e Vlorës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës, të M.R, pasi është arritur qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

M.S KUNDËR SHOQËRISË SË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE TIRANË - DURRËS, EL-ALBA 1 SH.P.K,

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen masave për eliminimin e pasojave që shkakton mosnjohja e të drejtës së tyre nga kjo linjë transporti.

Vendim nr. 93 , datë 09 . 06 . 2023

FAKTET: Subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Më datë... hipa në Terminalin e Autobusave në Tiranë, në autobusin e linjës Tiranë-Durrës me targë AA.....NJ. Në momentin që faturino vjen për të mbledhur lekët e biletave, unë i paraqita librezën dhe i dhashë 100 (njëqind) lekë të reja ashtu siç e përcakton ligji, se bileta e plotë është 180 (njëqind e tetëdhjetë) lekë të reja. Ai mori librezën dhe ja çoi shoferit për ta kontrolluar. Shoferi tha paguaj biletën e plotë se unë nuk e njoh këtë librezë. Ai ma mbajti librezën deri në fund të udhëtimit. Në fund të udhëtimit, unë i kërkova faturinos të më kthej librezën, në të cilën kisha edhe dokumenta të tjera. Faturino më tha se e ka shoferi dhe nuk më dha librezën dhe pastaj u drejtova tek shoferi i cili më tha paguaj biletën e plotë, pastaj të jap librezën. Ai përsëri nuk ma dha librezën dhe më tha se unë nuk dua t’ja dij për askënd, as për shtetin se e kam blerë autobusin me lekët e mia dhe bile më ka ofenduar me fjalë shumë të rënda. Mbasi e pashë që ai e kishte gojën e çthurur, u largova pa marrë librezën me mendimin për ta denoncuar në polici. Pasi u largova më shumë se 100 metra nga autobusi, ai dërgoi faturinon të më sillte librezën”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen masave për eliminimin e pasojave që shkakton mosnjohja e të drejtës së tyre nga kjo linjë transporti.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”* (Ndryshuar me ligjin nr. 26, datë 15.03.2012).
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- VKM nr. 277, datë 18.06.1997 *“Për përfitimet nga statusi i të verbërit”*, i ndryshuar,
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;

KONKLUZIONE: Rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara përfitojnë lehtësira në udhëtim, subjekti ankues, nuk ka përfituar nga transporti ndërrurban në linjën e ofruar nga operatori EL-ALBA 1. Nga ana e Shoqërisë EL-ALBA 1 nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj situate konkrete dhe as në vijimësi. Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Shoqëria EL-ALBA 1, kundrejt subjektit ankues, si person me aftësi të kufizuar, i verbër dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Shoqëria EL-ALBA 1 duhet të përmbushte dy kushtet e përmendura më sipër. Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Shoqëria EL-ALBA 1, nuk ka zbatuar legjislacionin në fuqi, lidhur me lehtësimin e transportit ndërqytetas për personat me aftësi të kufizuar, të verbër.
- Shoqëria EL-ALBA 1, në rastin e ankuesit ka konstatuar veprime abuzive nga pronari i mjetit, që është njëkohësisht dhe aksioner i Shoqërisë, por nuk ka marrë asnjë masë për shkeljen e konstatuar.
- Shoqëria EL-ALBA 1, nuk ka informuar për veprime konkrete të ndërmarra për mos përsëritjen në të ardhmen të situatave të tilla.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, subjektit ankues i është mohuar një e drejtë, e cila i është dhënë nga legjislacioni në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Shoqëria EL-ALBA 1, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesin, përse i takon ofrimit të transportit me gjysëm pagese të parashikuar në legjislacionin e sipërpërmendur.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria EL-ALBA 1, nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion dhe dokumentacion në lidhje me masat konkrete, për njohjen e Librezës së Verbërisë dhe të udhëtimit me gjysëm pagese në transportin ndërqytetas, për kategorinë e personave të verbër.

Komisioneri konstaton se të gjitha veprimet dhe mosveprimet në shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi bazën e të cilave rregullohet transporti urban ndërqytetas, nga ana e Shoqërisë EL-ALBA 1, kanë krijuar një mjedis frikësues dhe ofendues ndaj ankuesit për shkak të aftësisë së kufizuar.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj subjektit ankues, M.S, pasi rezultoi se Shoqëria EL-ALBA 1, nuk ka marrë masa për të siguruar të drejtat ligjore të tij, lidhur me udhëtimin me gjysëm pagese në transportin ndërqytetas si dhe në formën e shpetësimin, nga ana e kësaj shoqërie.

Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit dhe garantimin e udhëtimit me gjysëm pagese në transportin ndërqytetas, për personat me aftësi të kufizuar, të verbër, bazuar në legjislacionin në fuqi.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe në formën e shqetësimin, të shtetasit M.S, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë EL-ALBA 1 shpk. Shoqëria EL-ALBA 1 shpk të marrë masa të menjëhershme për ndalimin e shqetësimin dhe mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.

15. Në vijim do t'i referohemi me "Pala ankuese"

FONDACIONI “SË BASHKU”¹⁵ KUNDËR BASHKISË VORË, ME PRETENDIMIN PËR DISKRIMINIM TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR, LIDHUR ME GARANTIMIN E VENDEVE TË PARKIMIT TË REZERVUARA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR.

Mungesa e garantimit të vendeve të parkimit të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara nga Bashkisë Vorë vendos këta persona nëkushte të pafavorshme dhe diskriminuese.

Vendim nr.142, datë 26. 07. 2023

FAKTET: Pala ankuese parashtron se, në kuadër të aktivitetit të saj, nga inspektimi në terren në Bashkinë Vorë është konstatuar problematika në lidhje me garantimin e vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.

Sipas Palës ankuese, në Bashkinë Vorë, në të gjitha rrugët dhe sheshet ku është e mundur parkimi i makinave, nuk ka asnjë vend të vetëm parkimi për personat me aftësi të kufizuar, duke krijuar kështu vështirësi për personat me aftësi të kufizuar për të dalë dhe për të marrë shërbime në të gjithë këtë bashki. Hapësirat e parkimit janë një kërkesë ligjore dhe në numra të ndryshëm, vende parkimi mund të gjenden me shumicën e bashkive të Shqipërisë. Vora është një nga ato bashki, ku nuk mund të gjenden vende parkimi.

Me tej, pala ankuese thekson se, në parkimet dhe garazhet publike, si dhe pranë objekteve ndërtimore 5 % e vendeve përshtaten në raport me numrin total të vendparkimeve, por jo më pak se një. Në Bashkinë Vorë nuk ka vende parkimi të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga Bashkia Vorë në lidhje me garantimin e vendeve të parkimit të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.
- Ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*;

KONKLUZIONE: Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se Bashkia Vorë, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në lidhje me garantimin e parkimit të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë.

Bashkia Vorë nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion, në lidhje me planifikimin e fondeve dhe afateve kohore për përmbushjen e detyrimit ligjor për parkimet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara sipas standardeve teknike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Bashkia Vorë parashitroi se, në lidhje me këtë çështje informacioni disponohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, si njësia zbatuese për rindërtimin e Njesisë Administrative Vorë dhe Njesisë Administrative Marikaj, Bashkia Vorë, kjo në zbatim të Vendimit Nr.66 datë 29.01.2020, të Këshillit të Ministrave *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillimin e Njesisë Administrative Vorë, Bashkia Vorë,*

dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Njësi Zbatuese” dhe Vendimit nr.223, datë 07.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.66, datë 29.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillimin e Njësisë Administrative Vorë, Bashkia Vorë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Njësi Zbatuese”.

Komisioneri vlerësoi se, fakti që Fondi Shqiptar i Zhvillimit është caktuar njësi zbatuese në zonën e përcaktuar nga vendimi i mësipërm, nuk i heq Bashkisë Vorë përgjegjësinë dhe kompetencat që kjo njësi e vetëqeverisjes vendore ka në kuadër të Ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, për sa i përket sigurimit të vendeve të parkimit sipas standardeve ligjore të miratuara për personat me aftësi të kufizuar. Bashkia Vorë, është autoriteti që në bazë të ligjit, ka detyrimin që të sigurojë vendet e parakimit për personat me aftësi të kufizuar dhe sipas standardeve ligjore të miratuara. Për të gjitha të mirat apo shërbimet për të cilat Bashkia Vorë ka përgjegjësinë për t'i ofruar në juridiksionin e saj, kjo bashki, është gjithashtu përgjegjëse që, cilido subjekt apo njësi zbatuese në territorin e administruar prej saj të veprojë sipas kërkesave ligjore apo që produktet, shërbimet apo investimet ku përfitues apo përgjegjësinë ligjore për ofrimin e tyre është Bashkia Vorë, të jenë në përputhje me parashikimet ligjore.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se Bashkia Vorë nuk ka marrë masa për hartimin e një plani masash për të identifikuar dhe planifikuar përmbushjen e standardeve të aksesueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, sikurse kërkohet nga VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

Për të siguruar aksesueshmërinë, KDPAK kërkon miratimin e disa standardeve minimale që duhet të përmbushen, standarde këto që rezultojnë të jenë miratuar, sikundër është parashikuar edhe më sipër në këtë vendim.

Komisioneri konstaton se, Bashkia Vorë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë në mënyrë efektive, brenda afateve kohore të arsyeshme, pavarësisht miratimit të standardeve teknike¹⁶ që prej vitit 2008 dhe detyrimit për të marrë masa për të identifikuar dhe planifikuar në mënyrë progresive dhe efektive eliminimin e pengesave/barrierave në territorin e administruar prej saj.

16. VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me AK”*.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi standardeve të aksesueshmërisë në lidhje me sigurimin e parkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Vorë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara, të cilët nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri vlerëson se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për mosveprimin nga ana e Bashkisë Vorë dhe marrjen e masave për heqjen e barrierave/pengesave për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Bashkisë Vorë.

Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Bashkisë Vorë, në lidhje me garantimin e parkimeve të personave me aftësi të kufizuara në territorin e bashkisë.

Bashkia Vorë të marrë masa për hartimin e një plani të detajuar për parkimet publike për personat me aftësi të kufizuara në territorin e saj. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për sigurimin e parkimeve publike për personat me aftësi të kufizuara.

H.Ç, PËRFAQËSUAR NGA SHOQATA KOMBËTARE SHPRESË PËR TË VERBËRIT NGA LINJA E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE SHOQËRIA LEDJAN SH.P.K, DURRËS – BERAT

Ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga ofruesi i shërbimit të transportit pasi është invalide dhe është e pajisur me librezë, por shoferi i është përgjigjur se nuk e njuh librezën dhe e ka detyruar me forcë, me imponim, për t'i dhënë pjesën tjetër të lekëve.

Vendim nr. 175, datë 11 .09 . 2023

FAKTET: Znj. H.Ç deklaroi se, është invalide me statusin e verbër. Znj. Ç shpjegon se, në datën 11.01.2023, orari 8 i mëngjesit, ka udhëtuar me linjën e transportit publik nga Durrësi (Plepa) për në Berat, me autobuzin AA 761 CT dhe ka zbritur në Urën Vajgurore. Në momentin që ka zbritur, ankuesja shpjegon se, i ka dhënë lekët që sipas saj i takonte që të jepte, por kur ka zbritur shoferi e ka ndjekur nga mbrapa duke i kërkuar lekët për biletën e plotë. Ankuesja i ka shpjeguar se është invalide dhe është e pajisur me librezë, por shoferi i është përgjigjur se nuk e njuh librezën dhe se duhet t'ia kishte thënë që në momentin që kishte hipur në autobus. Më pas ai e ka detyruar me forcë, me imponim, për t'i dhënë pjesën tjetër të lekëve dhe në këto kushte ankuesja është detyruar që t'ia japë.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

- Ligjit nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;*
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;*
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”* (Ndryshuar me ligjin nr. 26, datë 15.03.2012).
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;*
- VKM nr. 277, datë 18.06.1997 *“Për përfitimet nga statusi i të verbërit”*, i ndryshuar,
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;*

KONKLUZIONE: Rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara përfitojnë lehtësira në udhëtim, ankuesja nuk ka përfituar nga transporti ndërrurban në linjën e ofruar nga operatori LEDJAN sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria LEDJAN sh.p.k, nëpërmjet komunikimit shkresor, njeh dhe zbaton detyrimin e saj në kuadër të ofrimit të shërbimeve të transportit ndërqytetës që ajo ofron sipas licencës përkatëse. Shoqëria LEDJAN sh.p.k, mbajti qëndrimin se ngjarjet e paraqitura nga ankuesja kishin ndodhur nga punonjës të shoqërisë, por që nuk përfaqësojnë qasjen që shoqëria ka në lidhje me ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, shoqëria parashtrroi se, në mbledhjen e ortakëve të shoqërisë u dënua veprimi i kryer nga ky punonjës, duke theksuar se ishte një punonjës i jashtëm.

Pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga shoqëria LEDJAN sh.p.k, Komisioneri vlerëson se, në cilësinë e ofruesit të shërbimit të transportit, ky subjekt mbart detyrimin që ta ofrojë këtë shërbim konform parashikimeve ligjore në fuqi për personat me aftësi të kufizuara. Shoqëria LEDJAN sh.p.k, në cilësinë e ofruesit të shërbimit, është subjekti i cili mban përgjegjësi ndaj të tretëve në rast mosrespektimi të detyrimeve ligjore në

fuqi që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve për të cilat ai është licensuar. Detyrimi i Shoqërisë LEDJAN sh.p.k për të respektuar legjislacionin në lidhje me personat me aftësi të kufizuar pasqyrohet edhe në licencën me të cilën ky subjekt është pajisur. Me marrjen e licencës subjekti ka pranuar dhe një detyrimet që burojnë nga legjislacioni në lidhje me ofrimin e transportit për personat me aftësi të kufizuar dhe ka detyrimin që ti garantojë këto të drejta. Pavarësisht se shoqëria pranon dhe një këto të drejta ajo nuk rezulton të ketë marrë masa efektive për të parandaluar që sjellje të tilla të ndodhin në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit.

Sikurse pranohet nga vetë Shoqëria LEDJAN sh.p.k, kjo sjellje përbën një rast të përsëritur për këtë subjekt. Rezulton se, pranë Komisionerit është paraqitur dhe shqyrtuar një tjetër ankesë nga një person me aftësi të kufizuar kundër kësaj shoqërie për mosrespektim të të drejtës për të udhëtuar në transportin urban ndërqytetas, me biletë me gjysëm çmimi. Me vendimin nr. 137, datë 26.07.2023, Komisioneri ka konstatuar se, Shoqëria LEDJAN ka shkelur dispozitat e LMD. Pavarësisht, këtij rasti të ndodhur me herët, Shoqëria LEDJAN sh.p.k, nuk ka marrë masa efektive që shkelje të ngjashme të mos përsëriten.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të ankuases H.Ç, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë LEDJAN shpk. Shoqëria LEDJAN sh.p.k shpk të marrë masa të menjëhershme për mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie. Me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, Shoqëria LEDJAN sh.p.k duhet të marrë masat e mëposhtme:

- Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
- Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
- Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.

SHOQATA E TË VERBËRVE TË SHQIPËRISË KUNDËR POSTËS SHQIPTARE SH.A. DHE BASHKISË KORÇË

Sipas Shoqatës, personat e verbër që përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar kanë të drejtë të zgjedhin vetë se ku mund të tërheqin këtë pagesë, por personave të verbër që jetojnë në territorin e Bashkisë Korçë nuk i është ofruar kjo mundësi. Nga muaji korrik i vitit 2022, këto pagesa, personat e verbër të qytetit të Korçës i tërheqin pranë Postës Shqiptare, e cila sipas palës akuese, i mban për çdo shërbim një komision prej 100 lekë të rinj.

Vendim nr. 194, datë 09. 10. 2023

FAKTET: Shoqata në parashtrimet e cituara në ankesë thekson ndër të tjera se, bazuar në Ligjin nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të Verbërit”, të ndryshuar dhe VKM-në nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, personat e verbër trajtohen me pagesë për shkak të verbërisë. Personat e verbër të Bashkisë Korçë, më parë e kanë tërhequr pagesën pranë Bashkisë Korçë. Më pas e kanë marrë pranë bankave të nivelit të dytë. Kjo situatë ka vijuar deri në muajin korrik të vitit 2022. Sipas palës ankuese, bankat nuk i mbanin komision për veprimet e kryera, vetëm 90 lekë për mirëmbajtjen e kartës. Nga muaji korrik i vitit 2022, këto pagesa, personat e verbër të qytetit të Korçës i tërheqin pranë Postës Shqiptare, e cila sipas palës akuese, i mban për çdo shërbim një komision prej 100 lekë të rinj.

Sipas Shoqatës, personat e verbër që përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar kanë të drejtë të zgjedhin vetë se ku mund të tërheqin këtë pagesë, por personave të verbër që jetojnë në territorin e Bashkisë Korçë nuk i është ofruar kjo mundësi. Nga ana e Shoqatës theksohet se: “...në qytetet e tjera si Durrësi, Berati, Erseka, Pogradeci, Tirana etj., ligji zbatohet në mënyrë të drejtë dhe qytetarët e verbër nuk dëmtohen me komisione të cilat nuk duhet të paguhen nga vetë ata, dhe

si rrjedhojë Posta Shqiptare nuk e mban këtë tarifë për shërbimin që ofron. Nuk e dimë se ku bazohet Posta Shqiptare për Bashkinë Korçë që të mbajë këtë tarifë... për disa persona tarifa mund të jetë diçka normale, por për këtë kategori është shumë, pasi ka burrë e grua plus shoqëruet, në disa raste ka që kanë edhe fëmijët, i shkon kjo tarifë 800 lekë në muaj për këtë shkak". Përsa më sipër Shoqata sqaron se: "Ndihe mi të diskriminuar dhe jemi të pa qartë nëse personat përgjegjës pranë Bashkisë Korçë, Postës Shqiptare, Shërbimit Social Rajonal Korçë i bazojnë këto veprime në ndonjë VKM, apo po kryejnë një diskriminim të pastër ndaj komunitetit të të verbërve që jetojnë në këtë qytet".

Shoqata thekson se kanë marrë takim me përfaqësues të Postës Shqiptare të Korçës dhe janë vënë në dijeni se tarifa e mbajtur duhet paguar nga ana e Bashkisë Korçë dhe jo prej tyre. Ndërkohë nga ana e Bashkisë Korçë nuk kanë marrë asnjë zgjidhje lidhur me këtë problem.

Në përfundim, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për heqjen e tarifës së shërbimit nga ana e Bashkisë Korçë.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 "Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së "Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara";
- Ligji nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara";
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar;
- VKM-ja nr. 722, datë 11.11.2019, "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre",
- VKM-ja nr. 597, datë 4.9.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"

- Udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 47, datë 11.01.2018 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar”,*

KONKLUZIONE: Nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët në proces, referuar ankesës, personat me aftësi të kufizuar, të verbër, që mund të marrin njëkohësisht pagesat e invaliditetit, aftësisë së kufizuar, pagesat shtesë për paketë të veçantë higjeno-sanitare dhe pagesën e ndihmës ekonomike, në zbatim të aktmarrëveshjes së sipërcituar, do të jenë të detyruar të paguajnë për secilin shërbim komision apo tarifën e parashikuar. Pra, janë të detyruar të paguajnë në varësi të numrit të pagesave që kanë për të tërhequr nga ana e Filialit i Postës sh.a. Korçë.

Sakaq, referuar provave të përcjella nga ana e subjektit ankues, konstatohet që personat e verbër të Bashkisë Korçë, në momentin që kanë tërhequr pagesën e invaliditetit apo të aftësisë së kufizuar, i është mbajtur komision prej 100 lekë për secilin shërbim.

Në analizë përse më sipër, konstatohet që të njëjtin person i cili ka marrë pagesën e të verbërit apo edhe të aftësisë së kufizuar, i është mbajtur për secilin shërbim nga 100 lekë komision. Gjithashtu, konstatohet se tre anëtarët e një familje (E. L., J. L. dhe L. L.) që kanë tërhequr pagesat e tyre, kanë paguar komision prej rreth 400 lekë.

Mbështetur në informacionin e administruar, personat e verbër në Bashkinë e Korçës, të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike, pagesë të aftësisë së kufizuar, apo edhe pagesa të tjera si pasojë e saj, janë vënë përpara detyrimit që t'i tërheqin pranë Filialit të Postës sh.a. Korçë dhe sa herë të tërheqin këto pagesa, të tarifohen me një komision prej 100 apo 50 lekë, për çdo shërbim në varësi të shërbimeve të marra.

Në analizë të përcaktimeve të akteve të sipërcituara, vlerësohet se:

- personat me aftësi të kufizuara, të verbërit, si dhe ata që përfitojnë ndihmë ekonomike, duhet t'i marrin këto pagesa të plota dhe pa paguar tarifa apo komision shërbimi;
- përfituesit e aftësisë së kufizuar, ku përfshihen dhe të verbërit, përzgjedhin vetë alternativën se ku duan t'i tërheqin pagesat, nëpërmjet shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare;
- Bashkitë kanë detyrimin që të marrin masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe mos të tarifohen/komisionohen;

Nga informacioni i administruar, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, pavarësisht detyrimeve të përcaktuara në aktet e sipërcituara, kanë nënshkruar akt-marrëveshje në shkelje të tyre, duke i vendosur tarifa/komisione për shërbimet që marrin si pasojë e aftësisë së kufizuar dhe duke mos i marrë të plota përfitimet apo kompensimet që personat me aftësi të kufizuara apo të verbërit përfitojnë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Korçë, pa marrë më parë miratimin e përfituesve, në rastin konkret të verbërve të Korçës, ka përzgjedhur institucionin ku ata duhet të marrin shërbimin pa dakordësinë e tyre, në shkelje të përcaktimeve ligjore në fuqi.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tyre, kanë diskriminuar kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, në të drejtën e tyre për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për përzgjedhjen e institucionit (shërbimin postar apo bankar) ku ata do të marrin shërbimin dhe marrjen e tij pa tarifa apo komisione.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar, të verbër, të Bashkisë Korçë, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, të marrin masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ndaj kategorisë së personave të verbër të Bashkisë Korçë, duke i dhënë atyre mundësinë të zgjedhin vetë subjektin për tërheqjen e pagesave, si dhe të zbatojnë legjislacionin duke i përjashtuar nga pagesa e tarifave/komisioneve për shërbimet që ata marrin¹⁷.

Bashkia Korçë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ndaj kategorisë së personave të verbër të Bashkisë Korçë, duke i kthyer atyre të gjitha shumat e mbajtura që nga momenti (periudha) kur ka nisur aplikimi i tarifave/komisioneve në shërbimet e marra përmes shërbimit postar dhe atij bankar.

17. Pagesë paaftësie, pagesë verbërie, ndihmë ekonomike etj.

SHOQATA KOMBËTARE “SHPRESË PËR TË VERBËRIT¹⁸”, KUNDËR BASHKISË SË TIRANËS

Konstatimi i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar (PAK), nga ana e Bashkisë së Tiranës dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës së krijuar për eliminimin e barrierave të aksesueshmërisë, për personat e verbër, në rrugën “Xhorxh W Bush”, Tiranë.

Vendim nr. 212, datë 25.10.2023

FAKTET: Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, subjekti ankues, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, ka ngritur pretendime lidhur me problematikën e hasur prej tyre, duke parashtruar si më poshtë vijon:

“...Në rrugën “Xhorxh W Bush” në Tiranë, u konstatua se, ndërkohë që nga ana e Bashkisë Tiranë vijonin punimet për rikonstruksionin e saj, mbi trotuar nuk ishin vendosur shiritat vijëzues dhe elementët e tjerë sinjalistikë për të verbërit.

Në këto kushte, iu drejtuam shkresërisht Bashkisë Tiranë, duke kërkuar informacion nëse projekti i miratuar prej saj për rikonstruksionin e rrugës në fjalë, është konform zbatimit të akteve ligjore e nënligjore për aksesueshmërinë e personave të verbër, konkretisht nëse ka të parashikuar vendosjen e sinjalistikës për personat e verbër.

Bashkia Tiranë në përgjigjen e saj ka parashtruar se:

“Objekti “Rikonstruksion i rrugës “Xhorxh W Bush”, i cili është drejt përfundimit, po zbatohet sipas projektit të miratuar me Vendim të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, me nr. 1, datë 24.01.2019 dhe se në projekt nuk është parashikuar vendosja e shiritave vijëzues për të verbërit.”

18. Në vijim referuar si Shoqata.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara (PAK), nga ana e Bashkisë së Tiranës, për shkak të aftësisë së kufizuar (AK) dhe marrjen e masave për rregullimin e situatës së krijuar për eliminimin e barrierave të aksesueshmërisë, për personat e verbër, në rrugën “Xhorxh W Bush”, Tiranë.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligji nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;*
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;*
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.
- Ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;*
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;*

KONKLUZIONE: Rezultoi e provuar se rruga “Xhorxh W Bush”, në territorin e Bashkisë së Tiranës, nuk është konform standardeve teknike dhe ligjore të aksesueshmërisë për PAK. Për rrjedhojë shërbimi i ofruar krijon pamundësi apo vështirësi që të aksesohet dhe të përdoret nga personat me aftësi të kufizuara/që nuk shikojnë.

Një fakt i tillë është pohuar e pranuar nga ana e Bashkisë, duke cituar se, planimetria e përgjithshme e projektit të kësaj rruge, nuk parashikon pllaka apo shirita sinjalizues për të verbërit. Sipas dokumentacionit të depozituar, daton se, punimet në këtë objekt/rrugën “Xhorxh W Bush”, kanë filluar më datë 24.11.2022 dhe kanë përfunduar më

datë 24.07.2023, ndërkohë që, legjislacioni i brendshëm rregullator për sigurimin e garantimin e aksesueshmërisë për personat me AK, ka hyrë në fuqi dhe ka qenë i detyrueshëm për zbatim shumë kohë përpara se të miratohej Vendimi nr. 1, datë 24.01.2019, i Këshillit Teknik, dhe po ashtu edhe përpara fillimit të punimeve në objektin/rrugën “Xhorxh W Bush”, Tiranë.

Bashkia nuk arriti të tregojë apo dëshmojë vullnetin e saj, se pavarësisht sa më sipër, ajo kishte hartuar apo do të hartonte në një të ardhme të afërt një plan masash, me afate konkrete se kur do të realizohej një ndërhyrje e tillë, në përputhje me kriteret teknike të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi. Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t’u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, si dhe mundësisht t’u garantohet jetesa e pavarur. Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të individëve, (përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuar) duhet të sigurohet që t’i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme. Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuar, me statusin e të verbërit, pasi rezultoi se Bashkia e Tiranës nuk ka marrë masa për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar në rrugën “Xhorxh W Bush”, Tiranë.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga ana e Bashkisë së Tiranës, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë të sinjalistikës rrugore, për personat me aftësi të kufizuara, me statusin e të verbërit, në rrugën “Xhorxh W Bush”, Tiranë.

Bashkia e Tiranës, të marrë masa konkrete për të siguruar në mënyrë efektive, aksesueshmërinë e këmbësorëve në rrugën “Xhorxh W Bush”, Tiranë, në përputhje me stadardet ligjore në fuqi kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, me statusin e të verbërit.

Bashkia e Tiranës, rekomandohet të mbajë gjithmonë në konsideratë, zbatimin e parashikimeve ligjore për aksesueshmërinë e PAK, në të gjitha investimet e saj aktuale dhe në të ardhmen.

M.W KUNDËR DREJTORISË VENDORE TË KUFIRIT DHE MIGRACIONIT SHKODËR DHE DREJTUESIT Z.L.K¹⁹, NË TË CILËN PRETENDOHET DISKRIMINIM PËR SHKAK TË MOSHËS, GJENDJES SHËNDETËSORE DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR.

Ankuesja deklaron se, është me origjinë franceze, është diplomuar si albanologe antropologe dhe ka 15 vite që jeton në Shqipëri. Ajo pretendon se, policia e migracionit në Shkodër nuk dëshiron që t'i rinovojë lejen e qëndrimit me preteksin se është në moshë dhe është e sëmurë me kancer.

Vendim nr.263, datë 28.12. 2023

FAKTET: Ankuesja deklaron se, është me origjinë franceze, është diplomuar si albanologe antropologe dhe ka 15 vite që jeton në Shqipëri. Ankuesja pretendon se, policia e migracionit në Shkodër nuk dëshiron që t'i rinovojë lejen e qëndrimit me preteksin se është në moshë dhe është e sëmurë me kancer.

Ankuesja shpjegon se, është e apasionuar pas kulturës tradicionale shqiptare dhe se gëzimi i saj më i madh është t'i tregojë botës bukurinë e madhe të kulturës tradicionale shqiptare dhe që banon në një vend të cilit i kushton respekt të thellë. Ajo punon me komunitetet baritore bjeshkatar në Shqipërinë e Veriut dhe i mbështet ato që të organizohen dhe strukturohen në grupe baritore dhe të bëjnë zërin e tyre të dëgjohet. Aktualisht është këshilltare në Ministrinë e Bujqësisë dhe punon krah për krah me Zyrën Rajonale të Bujqësisë Shkodër. Bashkëpunon gjithashtu me Agjensinë e Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare. Si kryetare e shoqatës “Shtëpia e bariut dhe bjeshkimit” dhe antropologe është anëtare e ANRD.

19. Në vijim të procedurës është saktësuar mbiemri nga “K” sipas pretendimeve të ankueses në “K”, pas saktësimit të përcjellë nga DVKM Shkodër, nëpërmjet shkresës nr.05/2 prot. datë 15.12.2023.

Ankuesja shprehet se, ndihet thellësisht shqiptare dhe gjithë jetën ia ka kushtuar popullit shqiptar dhe dëshiron që të vazhdojë të japë kontributin e saj.

Ankuesja pretendon se po diskriminohet nga z. L.K, drejtues i Zyrës së Emigracionit në Shkodër, pasi ky i fundit është shprehur se, ajo nuk mund të qëndrojë në Shqipëri pasi është në moshë të thyer dhe e sëmurë me kancer. Ankuesja pranon se ka kaluar kancer, por aktualisht është shumë mirë dhe kjo nuk mund të jetë shkak për të mos rinovuar lejen e saj të qëndrimit në Shqipëri.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;*
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;*
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr.79, datë 24.06.2021 *“Për të huajt”;*
- VKM-së Nr.858, datë 29.12.2021 *“Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar
- Vendimi Nr.252, datë 29.04.2022 *“Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”.*

KONKLUZIONE: Shtetasja M.I.P.W ka një periudhë të gjatë e paisur me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka shërbyer në komunitet e Barinjve në Njësinë Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe.

Kjo shtetase ka aplikuar për leje qëndrimi nëpërmjet Portalit E-Albania, duke pasqyruar motivin Studim-Kërkues Shkencor dhe ka ngarkuar në sistem dokumentat të cilat

dispononte. Aplikimi i ardhur në sistem është deleguar tek Specialisti i Migracionit Nënkomisar L.K me datën 15.11.2023.

Nga verifikimi i dokumentave nga specialisti z. L.K, ka rezultuar se dokumentat e paraqitura ishin me mangësi dhe konkretisht, me datën 07.12.2023, nëpërmjet sistemit E-Albania shtetasës i është dërguar elektronikisht “Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit” të kërkuar në bazë të të VKM-së Nr.858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kapitulli III, ku përcaktohet dokumentacioni i përgjithshëm dhe i nevojshëm për të gjitha llojet e lejeve, si dhe shkronja “C”, pika 2, germa “dh”, dokumentacioni shtesë për motivin e kërkuar nga shtetasja duke lënë afat deri me datën 20.12.2023.

DVKM Shkodër, sqaron se, baza ligjore për trajtimin e të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë është: Ligji Nr.79, datë 24.06.2021 “Për të huajt”; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.858, datë 29.12.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimi Nr.252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”.

Nëpërmjet *e-mailit* drejtuar Komisionerit ankuesja ka informuar se i është miratuar dhe vendosur në dispozicion Leja e Qëndrimit Provizore si dhe i është dorëzuar leja e qëndrimit provizor dhe se i kërkon Komisionerit që të mbyllë çështjen dhe procedurën e shqyrtimit të ankesës së paraqitur prej saj kundër DVKM Shkodër dhe z. L.K. Ndër të tjera, ankuesja kërkon që të konsiderohet i pavlefshme çdo pretendim për diskriminim i ngritur kundër këtyre subjekteve, që ndaj tyre të mos rëndojë asnjë pasojë apo masë, pasi diskriminimi nuk ka ardhur prej tyre, por ka qenë një keqkuptim i tmerrshëm dhe një ndërthurje e disa rrethanave.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të LMD, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga znj. M.W kundër DVKM Shkodër dhe z. L.K pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi për të cilin ka filluar procedura administrative.

A H KUNDËR BASHKISË MALIQ

Mungesa e rimbursimit të tarifës së transportit së shkollës nga Bashkia Maliq, të fëmijës së ankuesit, person me aftësi të kufizuar e vendos atë në kushte diskriminuese për shkak se vendbanimi është 20 km nga shkolla ku djali ndjek procesin mësimor.

Vendim nr.28 , datë 30. 01. 2024

FAKTET: “Jam banues në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas e Bashkisë Maliq. Gëzoj statusin e të verbërit, dhe kam një problematikë të cilën e konsideroj diskriminuese. Njëri prej fëmijëve, ndjek mësimet në Shkollën e Mesme Profesionale të Ndërtimit në Korçë dhe largësia nga banesa ime tek shkolla e djalit është mbi 20 km. Djali im shkon çdo ditë në shkollë me anë të transportit publik, dhe lidhur me tarifën e transportit duhet të rimbursohet nga Bashkia, pasi ai është përfitues, pasi unë jam kryefamiljari dhe jam me aftësi të kufizuar, dhe po ashtu edhe për shkak se vendbanimi është 20 km nga shkolla ku djali ndjek procesin mësimor. Nuk kam të ardhura të mjaftueshme financiare që të përballoj transportin e fëmijës dhe kjo gjë do më bëjë që të heq fëmijën nga shkolla dhe ta privoj atë nga drejta e arsimimit.”

Subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfshirjen e emrit të të birit në listën e hartuar nga Bashkia, për marrjen e rimbursimit të transportit, përfitimin e pagesës, pasi ai ndjek mësimet në klasën e 11-të, në Shkollën e Mesme të Ndërtimit, në degën “Termohidraulikë”, Korçë, ndërsa vendbanimin e ka në fshatin Bregas/Bashkia Maliq.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollin 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.69/2012 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, për caktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, Vendimit nr. 110, datë 19.12.2022, të Këshillit Bashkiak.
- Udhëzimi Nr.14, datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave.

KONKLUZIONE: Bashkia Maliq, njoftoi Komisionerin se: “...ju bëjmë me dije se, fëmija O. H ka përfituar bursë për vitin shkollor 2022-2023, sipas VKB Maliq. Përsa i përket përfitimit të bursës për vitin shkollor 2023-2024, fëmija e përfiton automatikisht duke u rikonfirmuar kushtet social-ekonomike të familjes me vendimin e Këshillit Bashkiak Maliq, të muajit Dhjetor 2023. Bashkia Maliq konfirmon dhe miraton listën me emrat përfitues, sipas kriterëve dhe numrit të kuotave të çelura nga MFE, në numrin e llogarisë së çdo nxënësi përfitues. Sapo të kalojë në Këshill vendimi përkatës do jua përcjellim me e-mail.”

Në vijim të sa më sipër, subjekti ankues ka falenderuar Komisionerin për angazhimin e tij dhe ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës pranë KMD-së, duke cituar ndër të tjera se:

“Deklaroj se heq dorë nga ankesa ime pranë Komisionerit, pasi u njoftova nga Bashkia Maliq për përfitimin e bursës së djalit tim O. H, për vitin shkollor 2023-2024. Vlerësoj dhe e konsideroj të zgjidhur problematikën time nga ana e Bashkisë.”

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së, duke konsideruar se është arritur efektiviteti për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

FONDACIONIT “SË BASHKU”, KUNDËR BASHKISË TEPELENË

Ndërtesa e Institucionit të Bashkisë Tepelenë, nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që i vë ata në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën e tyre për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët.

Vendim nr. 44, datë 13. 02. 2024

FAKTET: Fondacioni “Së Bashku”, ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e hasur prej tyre, duke parashtruar se, ndërtesa e Institucionit të Bashkisë Tepelenë, nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që i vë ata në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën e tyre për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët, në respektim të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “Konstatimin e diskriminimit dhe përmirësimin e situatës dhe plotësimin e standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), nga ana e Bashkisë Tepelenë”.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;

- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;

KONKLUZIONE: Sipas Bashkisë shërbimet për marrjen e certifikatave të Gjendjes Civile dhe pajisjen me pasaportë dhe kartë ID, kryheshin në një ambient që i plotësonte kushtet për marrjen e këtyre shërbimeve dhe aksesueshmërinë nga personat me aftësi të kufizuara (PAK) tek ish-Prokuroria e Rrethit Tepelenë, me të cilën Bashkia kishte marrëdhënie kontraktuese, deri në vitin 2025, por, kjo marrëdhënie u ndërpre në mënyrë të njëanshme nga ana e Prokurorisë. Në këtë situatë, për vazhdimin e kryerjes së shërbimeve të ofruara, Bashkia Tepelenë u gjend në vështirësi për krijimin e ambienteve për të dhënë këto shërbime dhe për më tepër, ambiente që të plotësojnë kushtet për aksesueshmëri nga PAK.

Bashkia Tepelenë e ka vlerësuar këtë shqetësim të komunitetit dhe ka parashikuar në buxhetin e vitit 2024 “Rikonstruksion të ambienteve të Njësisë Administrative Qendër”, ndodhur në katin e parë për t’u vënë në dispozicion këto shërbime.” Bashkia Tepelenë, ka dërguar kopje të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 80, datë 21.09.2023 “Për miratimin e projektdokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, të Bashkisë Tepelenë, bashkëlidhur edhe Tabelën nr. 3, të këtij Vendimi, me titull: “Tabela e investimeve për periudhën afatmesme 2024-2026, dokumenti i parë. Investimet nga transferata e pakushtëzuar”.

Gjithashtu Bashkisë Tepelenë ka dërguar pranë Komisionerit, Projekt-Zbatimin me objekt: “Rikonstruksion objekti, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Tepelenë. Relacioni PAK” Ky dokument parashikon që objekti që rikonstruktohet shtrihet në qytetin e Tepelenës, pas objektit të Bashkisë Tepelenë, në një distancë prej 50 metrash nga qendra e qytetit. Në të citohet, ndër të tjera, se:

“Përsa i përket rikonstruksionit të objektit, ky projekt është mbështetur përpos DP, në hartimin e preventivit, çmimet e referencës sipas legjislacionit në fuqi, në kushtet

teknike të projektimit dhe standardet e Republikës së Shqipërisë (KTP, STASH, ENSTASH), në normat dhe rekomandimet e IEC, EV, dhe në VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 "Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e PAK" ...Rregullorja ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike...

Pasi është njohur me dokumentin sipërcituar Fondacionit "Së Bashku", është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar reagimin e Bashkisë dhe masat e ndërmarra prej saj, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, në kuadër të zbatimit të projektit: "Rikonstruksion objekti, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Tepelenë. Relacioni PAK", për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së aksesueshmërisë në zbatim të kriterëve teknike të përcaktuara në VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 "Për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara"".

VENDIM: Komisioneri deklaroi të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës, pasi është arritur qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

Bashkia Tepelenë, në përfundim të rikonstruksionit të godinës së Njesisë Administrative Qendër, (në zbatim të Projekt-Zbatimit, me objekt: "Rikonstruksion objekti, Njësia Administrative Qendër, Bshkia Tepelenë, Relacioni PAK"), të informojnë Komisionerin lidhur me zbatimin e kriterëve të aksesueshmërisë, sipas VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 "Për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara"". Të depozitojnë pranë KMD-së dokumentacionin përkatës dhe fotot ilustruese, lidhur me respektimin e kriterëve teknike e ligjore të aksesueshmërisë, sipas VKM-së respektive.

FONDACIONIT “SË BASHKU”, KUNDËR DREJTORISË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR (DRSHSSH) SHKODËR

Ndërtesa e Institucionit të DRSHSSH Shkodër nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që i vë ata në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën e tyre për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët.

Vendim nr. 45, datë 13. 02. 2024

FAKTET: Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e hasur prej tyre, duke parashtruar se, ndërtesa e Institucionit të DRSHSSH Shkodër nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që i vë ata në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën e tyre për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët, në respektim të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “Përmirësimin e situatës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, nga ana e DRSHSSH Shkodër”.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;

- Ligjit nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;

KONKLUZIONE: DRSHSSH Shkodër, ka dërguar pranë Komisionerit parashtrimet lidhur me qëndrimin përsa i takon çështjes në fjalë, duke cituar si më poshtë:

“...lidhur me mungesën e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar (PAK) në ambientet e DRSSSH Shkodër, theksojmë se mungesa e rampës është një nga problematikat që është ngritur edhe nga ana e Drejtorisë tonë.

DRSHSSH Shkodër, duke qenë se ushtron aktivitetin e vet në ambiente të marra me qira për ndërhyrje në infrastrukturën e objektit, mjediset e tij dhe territorit përreth, qofshin këto përshtatje apo shtesa, duhet të marrë miratimin me shkrim nga subjekti qiradhënës.

Bazuar në kërkesën me nr. 79 prot., datë 10.05.2022, të Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër, Drejtoria jonë i është drejtuar me shkresë²⁰ subjektit qiradhënës, që në një nga hyrjet e ambienteve të dhëna me qira për zyra, të ndërtohet një platformë e pjerrët (rampë) duke krijuar akses për personat me aftësi të kufizuar.

Subjekti qiradhënës ka kërkuar takim me drejtuesin e institucionit dhe gjatë takimit të realizuar nuk ka dhënë dakordësinë e tij, pasi kjo nuk është e mundur nga ana teknike.

Kontrata e institucionit tonë me subjektin qiradhënës, bazuar në Kontratën e qirasë me nr. Rep. 16 dhe Nr. Kol. 16, datë 04.01.2023, është e vlefshme deri më datë

20. Shkresa me nr. 1421/1 prot., datë 20.05.2022, e DRSHSSH Shkodër.

31.12.2023, ndërkohë që pritet ndryshimi i ambienteve të DRSHSSH Shkodër, qofshin këto ambiente shtetërore apo private.

Lidhur me praktikën e ndjekur për ofrimin e mundësisë për akses në ambientet e institucionit, theksojmë se, DRSHSSH Shkodër, ka në fokus të punës së saj t'i shërbejë çdo qytetari, dhe deri tani nuk besojmë se ka munguar ofrimi i shërbimeve nga ana e institucionit tone për çdo qytetar i cili ka kërkuar të marrë informacione apo dhe ankesa lidhur me asistencën sociale.

Infrastruktura nuk ka qenë asnjëherë arsye për të cilën punonjësit e institucionit tonë të mos ofrojnë shërbimin e çdo qytetari që ka kërkuar të marrë shërbime nga Drejtoria jonë.

Gjithashtu, në kuadër të reformës së decentralizimit dhe ofrimit të shërbimeve sa më pranë qytetarëve, shërbimet për personat përfitues të statusit të paraplegjikut dhe tetraplegjikut dhe statusit të të verbërit, ofrohen pranë vendbanimit të tyre nga Administratorit Shoqëror, të tilla si: dorëzimi i dokumentacionit për vlerësim, rivlerësim, datën e intervistës, komunikimin e vendimit të KMCAP/KMPV, ankimimit, etj.”

Komisioneri, i rekomandoi DRSHSSH Shkodër që, lidhur me gjetjen e ambienteve ku Drejtoria do të ushtrojë veprimtarinë e saj, (brenda muajit janar 2024) të ketë në konsideratë që ato (qofshin ambiente shtetërore apo private) duhet të përmbushin kriteret ligjore lidhur me aksesueshmërinë e PAK, në respektim të kërkesave të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

DRSHSSH Shkodër ka informuar KMD-në se: “Subjekti qiradhënës, në zbatim të detyrimeve kontraktuale të Kontratës së Qirasë me nr. 453 Rep., dhe nr. 280 Kol., datë 29.01.2024, ka proceduar me ndërtimin e rampës në një nga hyrjet e godinës, duke siguruar aksesueshmëri për PAK, si dhe ka bashkëlidhur fotot e rampës.

Pasi është njohur me dokumentin sipërcituar, përfaqësuesja e Fondacionit “Së Bashku, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar reagimin e DRSHSSHsë dhe masat e ndërmarra prej saj, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për sigurimin e aksesueshmërisë për PAK në ambientet e këtij institucioni, në zbatim të kriterëve teknike të përcaktuara në VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 176 Regj., datë 22.09.2023, të Fondacionit “Së Bashku”, kundër DRSHSSH Shkodër, pasi është arritur qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

DRSHSSH Shkodër, nëse në të ardhmen, do ndryshojë godinë (qoftë shtetërore apo private), të ketë në konsideratë plotësimin e zbatimin e kriterëve të aksesueshmërisë, sipas VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”.

FONDACIONI “SË BASHKU”, KUNDËR HOTEL FLOWER

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në hotel Flower ka vendosur në kushte të pafavorshme dhe diskriminuese personat me aftësi të kufizuara pjesmarrës në trajnim.

Vendim nr. 58, datë 06 . 03. 2024

FAKTET: Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon se: “Me datë 19.09.2023 kishim trajnim me personat me aftësi të kufizuara por rampa në hyrje të hotelit është jashtë standardeve të miratuara dhe e rrezikshme. U detyruam të futemi nga pas hotelit dhe aty e papërshtatshme dhe na u desh ndihma e disa personave që të mos dështonte trajnimi. Banaku i recepsionit ishte i lartë dhe nuk ka tualet të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara”. Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmirësimin e situatës dhe plotësimin e të gjitha standardeve për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin

e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;

- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;*

KONKLUZIONE: Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës Komisioneri përdori të gjitha mjetet ligjore për të mbledhur dhe verifikuar faktet dhe provat sa i takon pretendimeve të subjektit ankues mbi mungesën e aksesueshmërisë.

Gjatë inspektimit të hotel Flower u evidentua fakti se, rampa në hyrje të hotelit ishte bërë e re, në hollin e hotelit ishte vënë një tavolinë e pajisur me kompjuter e cila do të shërbente si recepsion për personat me aftësi të kufizuara, në dysheme ishte vendosur sinjalistikë për personat me vështirësi në shikim dhe tualeti për personat PAK ishte në katin e dytë të hotelit, i cili ishte i aksesueshëm nëpërmjet ashensorit.

Pasi është njohur me informacionin dhe fotot e videot e bëra gjatë inspektimit, përfaqësuesja e Fondacionit është tërhequr nga ankesa e bërë pranë Komisionerit, pasi ka vlerësuar masat e ndërmarra nga ana e Hotel Flower, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për zgjidhjen e situatës së aksesimit të personave me aftësi të kufizuara në mjediset e Hotel Flower.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb.

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës të Fondacionit “Së Bashku”, pasi është arritur qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

A.H, KUNDËR BASHKISË DURRËS

Ndërtesa e Institucionit të Bashkisë Durrës nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që e vë ankuesin në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët

Vendim nr.72, datë 19.03 . 2024

FAKTET: Subjekti ankues, znj. A. H, ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e hasur prej saj, duke parashtruar se, ndërtesa e Institucionit të Bashkisë Durrës nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që e vë atë në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët, në respektim të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, i cili parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Ankuesja shpreh se: “Mungon rampa në hyrje të Bashkisë Durrës dhe aksesin në katet e brendshme mungon gjithashtu. Si person me AK, me status paraplegjik-tetraplegjik, kam hasur vështirësi edhe në sallën e Këshillit Bashkiak Durrës, ku është e vështirë hyrja për shkak të shkallëve. Pra, mungesa e rampave dhe ashensorit apo platformës ndihmëse, kanë bërë që unë të ndihem e diskriminuar dhe e rrezikuar për shkak të paafhtësisë sime fizike, sa herë që jam ftuar për të marrë pjesë në dëgjuesat publike në sallën e Këshillit Bashkiak apo dhe e privuar për të marrë ndonjë shërbim në Institucionin e Bashkisë.”

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “Konstatimin e diskriminimit dhe përmirësimin e situatës dhe plotësimin e standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), nga ana e Bashkisë Durrës”.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligjit nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;*
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;*
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;*
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;*

KONKLUZIONE: Bashkia Durrës informon Komisionerin:

“...Në VKM nr.1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, neni 21 “Shmangia dhe zgjidhjet alternative”, në pikën 2, parashikohet se: “Në ndërtesat ekzistuese lejohet shmangia nga kërkesat e kësaj Rregulloreje në rast të një pamundësie teknike, të faktuar, lidhur me elementë të strukturës teknike të ndërtesës ose me elementë të planit territorial vendor apo kombëtar.” Sa më sipër sqarohet se, ndërtesa e Bashkisë Durrës është një ndërtesë e ndërtuar në vitin 1929, në sheshin tradicional të qytetit. Ky objekt ka strukturë me muraturë mbajtëse në të cilën është e pamundur teknikisht ndërhyrja në të, për të shtuar, apo ndërhyrë në elementët konstruktiv. Gjithashtu është për tu theksuar se edhe në fasadën e poshtme të ndërtesës është e pamundur vendosja e elementëve shtesë, sepse ndërpret elementë të planit territorial, siç është rruga mbrapa Bashkisë, e cila është një rrugë lidhëse për banorët dhe subjektet që banojnë dhe operojnë në atë zonë. Përsa më sipër, çdo individ që kërkon të përmbushë një të drejtë, një detyrim apo një pretendim drejtuar Institucionit të Administratës Publike, për rastet e pamundësisë teknike të përshtatjes së ndërtesave ekzistuese, të faktuar, lidhur me elementë të strukturës teknike të ndërtesës ose me elementë të planit territorial vendor apo kombëtar, trajtuar më sipër, për të cilat lejohet shmangia nga rregullorja ““Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave

me aftësi të kufizuara”, miratuar me VKM nr. 1503/2008, e përmbush këtë detyrim nëpërmjet mënyrave alternative.

Ju bëjmë me dije se, kërkesat, ankesat, apo çdo korrespondencë me institucionin e Bashkisë apo me Këshillin vendor përkatës bëhet me shkresë zyrtare nëpërmjet institucioneve postare, postës elektronike, si dhe nëpërmjet Zyrës së Marrëdhënieve me Publlikun, e cila ndodhet në katin përdhe të institucionit. Specialistët e kësaj Zyre, janë të gatshëm në çdo moment që të bëjnë të mundur adresimin e pretendimeve të personave me aftësi ndryshe, në drejtoritë përkatëse të institucionit të Bashkisë.

Njëkohësisht, përsa i përket temave që trajtohen në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, sqarojmë se: ato janë transparente, rendi i ditës publikohet në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë, po ashtu edhe vendimet e Këshillit Bashkiak.

Komisioneri inspektoi Bashkinë Durrës. Në urdhrin e inspektimit KMD, kishte kërkuar paraprakisht që nga ana e Bashkisë Durrës, të vihej në dispozicion të grupit të inspektimit, për efekt të procesit hetimor, dokumenti shkresor i përpiluar nga ekspertët e fushës apo strukturat përgjegjëse përkatëse, i cili fakton apo dëshmon për pamundësinë teknike të përshtatjes së ndërtesës aktuale të Bashkisë Durrës, lidhur me ndërhyrjet ndërtimore për aksesueshmërinë e ambienteve të kësaj bashkie, në zbatim të VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara.

Në vijim të sa më sipër, Bashkia Durrës, përcolli pranë KMD-së, kopjen e Relacionit Teknik, me objekt: “Aksesueshmëria e PAK në godinën e Bashkisë Durrës”, të hartuar nga ekspertët e fushës të këtij institucioni. Relacioni teknik paraqet në mënyrë të detajuar se si do të jetë planimetria e godinës pas ndërhyrjes që mendohet të realizohet lidhur me aksesueshmërinë e PAK. Referuar parashtrimeve dhe Relacionit Teknik bashkëlidhur, Bashkia Durrës, informon Komisionerin se, inxhinierët dhe arkitektët, pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike të Bashkisë Durrës, kanë studiuar dy variante për zgjidhjen e aksesueshmërisë së PAK në godinën e Bashkisë, duke theksuar faktin se varianti i dytë i hartuar nga ekspertët e Bashkisë, është më i realizueshëm se varianti i parë i prezantuar prej tyre. Bashkia informon se, variantit më të mundshëm për realizim, pasi të konsultohet me specialistët e fushës, do t’i jepet prioritet zgjidhjes teknike të tij, nëpërmjet një projekt-preventivi, si dhe përmes parashikimit në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Pasi është njohur me dokumentin sipërcituar, subjekti ankues është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar reagimin e Bashkisë dhe

masat e ndërmarra prej saj, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për sigurimin e aksesueshmërisë për PAK në godinën e këtij institucioni, në zbatim të kritereve teknike të përcaktuara në VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 236, datë 30.10.2023, të subjektit ankues A. H kundër Bashkisë Durrës, pasi është arritur qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

Bashkia Durrës, pas miratimit të Projekt-preventivit, në zbatim të Relacionit Teknik, me objekt: *“Aksesueshmëria e PAK në godinën e Bashkisë Durrës”*, si dhe miratimit të tij në buxhetin përkatës, të depozitojnë pranë KMD-së kopje të dokumentacionit provues për sa më sipër.

Bashkia Durrës, në përfundim të realizimit dhe zgjidhjes përfundimtare të aksesueshmërisë së PAK në godinën e Bashkisë Durrës, të depozitojnë pranë KMD-së dokumentacionin përkatës dhe fotot ilustruese, lidhur me respektimin e kritereve teknike e ligjore të aksesueshmërisë, sipas VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”.

KREU II

VENDIME NË FUSHËN E ARSIMIT

38

J. H, KUNDËR BASHKISË TIRANË DHE MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, ZYRËS VENDORE ARSIMORE TIRANË

Mungesa e aksesueshmërisë në shkollën 1 Maji Tiranë ka vendosur në kushte të pafavorshme ankuesen R.N me aftësi të kufizura, duke i mohuar të drejten për arsim.

Vendim nr. 47, datë 14.02.2024

FAKTET: Pala ankuese parashtron se, vajza R. N. është nxënëse në klasën e I-rë në Shkollën “1 Maji”, Tiranë. Vajza është me aftësi të kufizuar (*qëndron në karrocë*) dhe nuk akseson dot shkollën pasi shkolla nuk ka ashensor. Vajza ka ndjekur parashkollorin në këtë shkollë gjatë vitit akademik 2022-2023 dhe klasa ka qenë e vendosur në katin e parë të shkollës dhe nuk pengohej aktiviteti mësimor. Gjatë këtij viti akademik, vajza u hodh në klasë të parë dhe klasa është në katin e tretë të shkollës, pasi kati i parë nuk ka klasë mjaftueshëm. Për këtë arsye, vajza ngjitet në klasë në krahë nga familjarët dhe zbritet po ashtu në krahë. Gjatë aktivitetit mësimor ajo asistohet nga mësuesja kujdestare, mësuesja ndihmëse (2 orë) dhe stafi psiko-social. Vështirësitë e vajzës në këtë shkollë qëndrojnë në këto aspekte:

- Nuk ka një tavolinë dhe karrige për fëmijët me aftësi të kufizuar.
- Nuk ka një tualet të përshtatshme me gjithë përpjekjet e shkollës dhe drejtueses për ta realizuar.
- Nuk akseson dot laboratorët e ndryshëm si laborator i IT (*informatikës*), palestrën, ambientet e jashtme të shkollës. Nevojitet ashensor.

Për vendosjen e ashensorit kam vënë në dijeni me kërkesë me shkrim Zyrën Arsimore Tiranë, Bashkinë Tiranë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Shoqatën Tetra-Paraplegjikëve. Pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit, rregullimin e situatës me vendosjen e ashensorit, tualetit, bankat për fëmijët me aftësi të kufizuar, mësuese ndihmëse me kohë të plotë sipas kërkesës dhe nevojës së fëmijës.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollin 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr.69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.
- Vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*
- Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021,
- Plani i ri Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025

KONKLUZIONE: Rezultoi e provuar se, Shkolla 9-vjeçare “1 Maji”, në Bashkinë Tiranës, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Shkolla 9-vjeçare “1 Maji” përveç rampës në katin e parë për të aksesuar hyrjen në shkollë nuk plotëson kushtet/standartet për të mundësuar aksesimin e ambjenteve të tjera në këtë shkollë nga personat me aftësi të kufizuara, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Rezultoi se, Bashkia Tiranë nuk depozitoi asnjë informacion në lidhje me përmbushjen e aspekteve që lidhen me aksesueshmërinë e shkollës për personat me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi. Çfarë investimesh janë realizuar ndër vite në institucionet arsimore dhe a kanë prekur këto investime aspekte që kanë të bëjnë me aksesueshmërinë e godinave. Çfarë masash janë marrë për evidentimin e nevojave

për përshtatshmërinë e godinës së shkollës. A është bërë një planifikim i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatet kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithpërfshirës dhe i të mësuarit gjatë gjithë jetës për personat me aftësi të kufizuara është një ndër qëllimet politike të PKVPAK. Objektivat specifike në kuadër të këtij qëllimi, të parashikuara në këtë plan përcaktojnë: (i) Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me lloje të ndryshme të AK-së; (ii) Shndërrimi i shkollave të specializuara në qendra burimore, duke përfshirë dhe mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës. Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Shkollën 9-vjeçare “1 Maji” në Bashkinë Tiranë, ka sjellë mohim të aksesit për fëmijën R. N, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Tiranë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt arsimor.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të fëmijës R. N, në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Tiranë.

Bashkia Tiranë, duhet të marrë masa për të siguruar në mënyrë të përshtatshme aksesueshmërinë në Shkollën 9-vjeçare “1 Maji”, Tiranë, në përputhje me standartet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Bashkia Tiranë, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve arsimore, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet aksesueshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

B. S., KUNDËR DREJTORISË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR KORÇË

Përrjashtimi nga e drejta për të përfituar trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, gjatë ciklit të dytë të studimeve (Master).

Vendim nr. 241, datë 14. 12. 2021

FAKTET: Në vitin 2014 ankuesi është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, për të ndjekur ciklin e studimeve Bachelor në degën Filozofi-Sociologji. Referuar Diplomës Universitare të B. S., rezulton që ai ka përfunduar studimet Bachelor më datë 30.10.2018.

Sipas informacionit të administruar, studimet e ciklit të parë Bachelor për ankuesit kanë zgjatur për katër vite akademike. Pra, kanë zgjatur 1 (një) vit më shumë nga kohëzgjatja normale e tyre. Për këtë arsye ankuesi, ka përfituar edhe për 1 (një) vit shtesë, trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar.

Në vijim, referuar vërtetimit datë 06.01.2021 të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, ankuesi ka vijuar ciklin e dytë të studimeve Master Profesional në programin e studimit Mësues në Shkenca Sociale, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane. Sipas informacionit të parashtruar më sipër nga palët, në 2 (dy) vitet e para, ankuesi ka përfituar trefishin e pagesës për shkak të verbërisë.

Më pas ankuesi, nuk ka arritur të përfundojë ciklin e dytë të studimeve Master, brenda kohëzgjatjes normale. Për të përmbyllur studimet i është dashur që në vitin e tretë të kërkojë sërish pagesë për shkak të verbërisë. Në këtë kuptim, pretendon se është diskriminuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, për shkak se është përjashtuar nga e drejta për të përfituar pagesën për 1 (një) vit plus, duke bërë që ai të mos përfundojë programin e studimeve Master.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Vendimi i Këshillit të Miniatrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE: Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, B. S., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë VKM-ja nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, e ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj.

Ankuesi ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, përmes mohimit të të drejtës për të përfitur pagesën e verbërisë gjatë ndjekjes së ciklit të dytë të studimeve edhe për një vit shtesë, megjithëse aktet nënligjore të sipërcituara, subjekt i të cilit është, ia njeht këtë të drejtë, dhe po ashtu

përcakton dhe detyrimin e shtetit, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror në këtë rast, për të përmbushur kërkesën e ankuesit.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, akuesi ka përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga VKM-ja nr. 277, datë 18.6.1997 *“Për përfitimet nga statusi i të verbërit”*, e ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj, pagesën e verbërisë edhe gjatë ndjekjes së ciklit të parë të studimeve në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerësoi se trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar subjektin ankues, B. S., në të drejtën e saj për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës ligjore për përfitimin e të mirave nga zbatimi i VKM-së nr. 277, datë 18.6.1997 *“Për përfitimet nga statusi i të verbërit”*, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të saj.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, B. S., në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në referim të pikës 1, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimi Social Shtetëror, të marrin masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues.

Në zbatim të vendimit të Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Shërbimi Social Shtetëror, informuan se janë marrë masat për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të subjektit ankues, duke i ofruar atij pagesën e verbërisë edhe gjatë ndjekjes së ciklit të dytë të studimeve në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë.

FONDACIONI “SË BASHKU” KUNDËR BASHKISË VORË

Mungesa e elementëve të aksesueshmërisë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori” Prezë, Bashkia Vorë vendos personat me aftësi të kufizuara në kushte të pafavorshme duke i diskriminuar për shkak të AK.

Vendim nr. 201, datë 07. 11. 2022

FAKTET: Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Subjekti ankues pretendon se personave me aftësi të kufizuara i është mohuar trajtimi i barabartë dhe janë diskriminuar lidhur me mungesën e standardeve të aksesueshmërisë në në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori” Prezë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, i Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Social Europiane (e rishikuar) (1996);

- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 *“Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*;
- Ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 *“Për statusin e invalidit”*, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike”*;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE: Bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe detyrimet që burojnë nga legjislati në fuqi, rezultoi e provuar se Shkolla e Mesme e Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Bashkia Vorë ka investuar një vlerë të konsiderueshme duke rindërtuar Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, në vitin 2018, në kundërshtim me standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, i cili ndalon çdo financim, nëse objekti nuk përmbush kërkesat dhe standardet e aksesueshmërisë. Pretendimi i Bashkisë Vorë se nuk kanë patur nxënës me aftësi të kufizuara në shkollës dhe për këtë arsye nuk ka patur problematika në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë, është i pabazuar dhe vjen në kundërshtim me detyrimet e mësipërme ligjore.

Bashkia Vorë, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë. Rezulton se, Bashkia Vorë nuk ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë e objektit të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, në juridiksionin e saj për personat me aftësi të kufizuara. Komisioneri arrin në përfundimin se,

mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Vorë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt arsimor.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, Bashkia Vorë.

Bashkia Vorë, duhet të marrë masa për të siguruar në mënyrë të përsheptuar aksesueshmërinë në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Shaban Sheshori”, Prezë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.

Bashkia Vorë, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

A.Z KUNDËR SHKOLLËS SË MESME TEKNIKE PYJORE “KOLË MARGJINI”, SHKODËR

Institucioni arsimor profesional refuzon të regjistrojë vajzën e ankuesit, për shkak se është me aftësi të kufizuar, grupi i parë.

Vendim nr. 32 , datë 03.02.2022

FAKTET: Ankuesi është babai i një vajze me aftësi të kufizuar. Bazuar në vendimin e Komisionit Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), Rrethi Tiranë, Niveli i Parë Neurologji-N/Kirurgji, F.Z është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar, grupi i parë. Referuar këtij vendimi, KMCAP, gjithashtu ka vlerësuar se, F.Z, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër. Vajza e ankuesit, F.Z, ka përfunduar arsimin 9 vjeçarë, në Shkollën 9-vjeçare Speciale “3 Dhjetori”, Shkodër. Me qëllimin që vajza e tyre të integrohej dhe të fitonte aftësi profesionale që mund ti përdorë në të ardhmen, ankuesi ka kërkuar që vajza e tij të regjistrohej në një shkollë profesionale dhe konkretisht në Shkollën e Mesme Teknike të Pyjeve “Kolë Margjini”, Shkodër, klasa X, dega përpunim druri. Shkolla ka refuzuar të regjistrojë vajzën e ankuesit. Shkolla nuk i ka dhënë ankuesit një përgjigje të arsyetuar dhe në formë shkresore, në lidhje me arsyet e refuzimit të regjistrimit të vajzës në shkollë.

Gjatë shqyrtimit, Shkolla parashtroi disa arsye në lidhje me refuzimin për të regjistruar vajzën e ankuesit, faktin se ankuesi nuk kishte depozituar epikrizën e vajzës; për shkak se vajza e ankuesit nuk plotësonte kriterin e moshës, pasi ishte më e madhe se 18 vjece; shkolla nuk kishte në organikë mësues ndihmës dhe proceset e praktikës në shkollë ishin të rrezikshme për vajzën e ankuesit, pasi ajo kishte nevojë për kujdesin e vazhdueshëm të një personi tjetër.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollu 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;*
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr.69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr.15, datë 16.02.2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;*
- Ligji Nr.57/2019 *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;*
- Udhëzimi Nr.14, datë 27.05.2021 *“Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”*, të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave.
- Udhëzimi N.26, datë 25.11.2019 *“Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.*

KONKLUZIONE: Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ndjekjen e arsimit profesional nga personat me aftësi të kufizuara, nuk parashikojnë rregullime të posaçme për të vlerësuar nëse një nxënës me aftësi të kufizuara mundet ose jo të ndjekë arsimin e mesëm profesional. Në rastin e vajzës së ankuesit, ndohemi në një situatë kur sjellja e pretenduar si diskriminuese është konsumuar duke i refuzuar vajzës së ankuesit regjistrimin në shkollë. Drejtuesja e Shkollës, në mungesë të rregullimeve të posaçme dhe pa patur asnjë kompetencë për të kryerë ajo vlerësimin e F.Z si person me aftësi të kufizuara, ka konkluduar se ndjekja e shkollës nga vajza e ankuesit do të përbënte një rrezik të lartë për të dhe në atë nivel, që në mungesë të një mësuesi ndihmës

ose një personi tjetër që mund ta shoqëronte e kishte të pamundur që të ndiqte shkollën në drejtimin e përzgjedhur. Drejtuesja e institucionit, sikurse rezulton edhe nga informacioni i administruar nuk rezulton që, minimalisht, nëpërmjet një komisioni të brendshëm në shkollë, në kushtet kur nuk ka rregullim ligjor, të ketë vlerësuar në praktikë aftësitë e F.Z për të ndjekur ose jo praktikatat profesionale në shkollë. F.Z, sikurse pretendohet nga Shkolla ka qëndruar në ambientet e Shkollës vetëm për pak orë në ditën e fillimit të vitit shkollor dhe nuk rezulton që të jetë përfshirë në ndonjë praktikë profesionale. Drejtuesja e Shkollës ka arritur në përfundimin se, vajza e ankuesit nuk mund të kryejë praktikatat profesionale, jo duke gjykuar në mënyrë konkrete dhe objektive, por duke paragjykuar aftësitë e F.Z, vetëm për faktin se ajo është person me aftësi të kufizuara që ka nevojë për ndihmësin personal, për kapërcimin e pengesave në jetën e përditshme.

Rezulton se, F.Z i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm e të pabarabartë edhe në raport me nxënësit e tjerë me aftësi të kufizuara të cilët janë regjistruar në shkollë. Kjo diferencë në trajtim midis F. dhe nxënësve të tjerë me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollë bazohet në llojin/shkallën e dëmtimit. Ndërsa F.Z është vlerësuar person me aftësi të kufizuara grupi i parë, nxënësit e tjerë janë vlerësuar si persona me aftësi të kufizuara grupi i dytë. Është pikërisht lloji/shkalla e dëmtimit që kushtëzon edhe nevojën për përfitimin ose jo të ndihmësit personal/kujdestari nga personi me aftësi të kufizuara.

Komisioneri vlerëson se, vajza e ankuesit në momentin e fillimit të vitit të ri shkollor 2021-2022, ka qenë jo më shumë se 18 vjeçe, në përputhje me kriterin e moshës të vendosur nga udhëzimi nr.14/2021, duke mos patur pengesa në drejtim të moshës për regjistrimin e saj në klasë X të arsimit të mesëm profesional pranë kësaj shkolle. Komisioneri konstaton se, nëse mosha do të ishte një shkak që pengonte regjistrimin në shkollë, atëherë nuk do të ishte e nevojshme që shkolla t'i drejtohej ZVAP Shkodër për vendosjen në dispozicion të Komisionit Multidisiplinor ose të kërkonte vendimin e KMCAP. Justifikimi i Shkollës se praktika profesionale përbën rrezik për F.Z, në kushtet kur mosha mund të përbënte një shkak të bazuar për refuzimin e regjistrimit, është i panevojshëm.

Komisioneri arriti në përfundimin se, nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis qëllimit të ligjshëm të synuar, që është mbrojtja e shëndetit dhe jetës së vajzës së ankuesit dhe mjetit të përdorur në rastin konkret, pra refuzimit për ta regjistruar F.Z në klasën e X të arsimit të mesëm profesional, pranë kësaj Shkolle. Nuk rezultoi e provuar se është bërë një vlerësim i vërtetë, objektiv dhe i individualizuar për rastin e vajzës së ankuesit. Komisioneri gjykoi se, justifikimi i

shkollës për refuzimin e regjistrimit të F.Z, nuk është objektiv dhe i arsyeshëm. Për rrjedhojë, në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, trajtimi diferencues dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar F.Z, përbën diskriminim.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të F.Z, në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Shkollës së Mesme Teknikë Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër.

Në referim të pikës 1, të këtij vendimi, Shkollës së Mesme Teknikë Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër, duhet të marrë masa urgjente për regjistrimin e F.Z në shkollë.

Me qëllim parandalimin në të ardhmen të sjelljeve diskriminuese, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duhet të marrë masa urgjente për miratimin e aktit nënligjor përkatës përpërcaktimin e kriterëve, procedurës së vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës, për personat me aftësi të kufizuara ndjekin arsimin dhe formimin profesional.

Rekomandohet Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër, që të rishikojë mundësinë e mbledhjes dhe vlerësimit nga komisioni multidisiplinar në juridiksionin e saj, të rasteve për të cilat shkolla ka paraqitur kërkesën, deri në rregullimin e posaçëm të situatës lidhur me vlerësimin dhe caktimin e mësuesit ndihmës në arsimin e mesëm profesional.

FONDACIONI SË BASHKU KUNDËR BASHKISË KAVAJË

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, Kavajë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët.

Vendim nr. 189, datë 10.10.2022

FAKTET: Fondacioni Së Bashku, një organizatë jofitimprurëse, paraqiti një ankesë që lidhet me interesa kolektive, duke pretenduar se mungesa e aksesueshmërisë, diskriminon personat me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, në Kavajë.

Bashkia Kavajë informoi Komisionerin se, shkolla nuk garanton aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe problematika ishte konstatuar në vitin 2022. Në lidhje me këtë problematikë, Bashkia ka bërë kërkesë për investim me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Protokollin Nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Komenti i Përgjithshëm Nr.6 (2018), *mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara;

- Komenti i Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;

KONKLUZIONE: Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr.1503/2008. Është respektimi i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike, në tërësinë e tyre, që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në arsim në baza të barabarta me të tjerët. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukturore në ndërtesën e Shkollës 9-vjeçare “Rilindja” në qytetin e Kavajës, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t’ju mohohet akses në arsim.

Është në përgjegjësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore që të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar. Objekt i ankesës në shqyrtim është Shkolla 9-vjeçare “Rilindja”, e cila është pjesë e sistemit shkollor parauniversitar dhe është një shkollë në juridiksionin e Bashkisë Kavajë. Rrjedhimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, është në përgjegjësinë e Bashkisë Kavajë, si njësi e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e të cilës është Shkolla 9-vjeçare “Rilindja”, të sigurojë aksesueshmërinë e ndërtesës së kësaj shkolle.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ndërtesa e Shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, në qytetin e Kavajës, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Bashkia Kavajë nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht

që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në raport me personat e tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuara .

Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret në raport me personat e tjerë që ndjekin arsimin në këtë objekt arsimor. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, personat me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak se mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara dhe nuk përballen me barriera/pengesa sikundër personat me aftësi të kufizuara.

Aksesueshmëria është një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara, përfshi edhe të drejtën për arsim. Megjithatë sipas KDPAK, sigurimi i aksesueshmërisë arrihet përmes realizimit progresiv. Realizimi progresiv do të thotë që heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Nga faktet dhe provat e administruara rezultoi se, Shkolla 9-vjeçare “Rilindja” është rindërtuar në vitin 2017 me një vlerë investimi prej 98.537.415 lekë me TVSH. Pra, pavarësisht se standardet e aksesueshmërisë për institucionet arsimore ekzistojnë që prej vitit 2008, Bashkia Kavajë e cila ka rindërtuar shkollën në vitin 2017, nuk i ka përmbushur këto këto standarde, duke dështuar që të sigurojë aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në këtë institucion arsimor. Bashkia Kavajë ka investuar një vlerë të konsiderueshme duke rindërtuar shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, në vitin 2017 në kundërshtim me parashikimin e mësipërm, i cili ndalon çdo financim, nëse objekti nuk përmbush kërkesat e parashikuara, për sa kohë që shkolla e rindërtuar nuk përmbush kërkesat dhe standardet e aksesueshmërisë të parashikuara në këtë vendim. Pretendimi i Bashkisë Kavajë se, problematika në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë është konstatuar në vitin 2022, është i pabazuar dhe vjen në kundërshtim me detyrimet e mësipërme ligjore.

Bashkia Kavajë, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me evidentimin e objekteve ekzistuese arsimore dhe jo vetëm, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe

afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë. Rezulton se, Bashkia Kavajë, nuk ka marrë asnjë masë për të siguruar aksesueshmërinë e objekteve apo shërbimeve në juridiskriminin e saj për personat me aftësi të kufizuara.

Duke mbajtur në konsiderat natyrën dhe llojin e ndërtesës që është objekt i ankesës në shqyrtim, si një institucion arsimor, Komisioneri vlerëson se, Shkolla 9-vjeçare “Rilindja” është një ndërtesë me frekuencë të lartë të frekuentimit, ndryshe nga ndërtesa të tjera që në varësi të natyrës së shërbimeve që ofrojnë mund të mos lindi nevoja që të frekuentohen në mënyrë të përditshme. Nga ana tjetër, Shkolla “Rilindja” është një shkollë 9-vjeçare, pjesë e arsimit të detyrueshëm dhe si i tillë ai përbën një nga detyrimet thelbësore të cilat duhet të përmbushen në kuadër të garantimit të të drejtës për arsim.

Komisioneri konstaton se, Bashkia Kavajë, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave dhe sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”. Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja” në Bashkinë Kavajë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Bashkia Kavajë nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë objekt arsimor. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja” në Bashkinë Kavajë, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja” nga ana e Bashkisë Kavajë.

Bashkia Kavajë, duhet të marrë masa për të siguruar në mënyrë të përshpejtuar aksesueshmërinë në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, në përputhje me stadardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Bashkia Kavajë, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

E. L. KUNDËR SHKOLLËS SË MESME TË BASHKUAR “MIHAL NAKO”, DIVJAKË DHE ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DIVJAKË (ZVAP DIVJAKË)

Dështimi për të përmbushur standardet e aksesueshmërisë në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, Kavajë, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët.

Vendim nr. 101, datë 26. 05. 2022

FAKTET: Mbështetur në informacionin e bërë publik në media, si dhe referuar Planit të Edukimit Individual (PEI) të vënë në dispozicion nga ana e Shkollës së mesme të bashkuar “Mihal Nako”, nxënësi E. L. është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar, diagnostifikuar me sindromën down dhe me epilepsi të gjeneralizuar. Gjithashtu rezultoi se nxënësi E. L., ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër.

Djali i ankuesit, nxënësi E. L., është regjistruar në klasën e 1 (parë) në vitin shkollor 2012- 2013, në shkollën e mesme të bashkuar “Mihal Nako”, Fierseman, Divjakë. Ai ka përfunduar klasën e 8 (tetë) gjatë vitit shkollor 2020-2021. Për vitin shkollor 2021-2022, drejtorja e shkollës së mesme të bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, nuk e ka regjistruar në klasë të 9 (nëntë), nxënësin E. L., për shkak se ka mbushur moshën 18 vjeç pak muaj përpara fillimit të vitit shkollor 2021-2022.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;

- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Rregullorja “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MASR me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.

KONKLUZIONE: Komisioneri konstatoi se, shkolla dhe ZVAP Divjakë nuk duhet të kishin refuzuar regjistrimin e nxënësit E. L. në klasën e 9 (nëntë), duke qenë se ai ka ndjekur arsimin bazë në këtë shkollë që nga klasa e 1 (parë) e deri në klasën e 8 (tetë). Fakti që shkolla dhe ZVAP Divjakë, nuk kanë patur në vëmendje interesin më të lartë të fëmijës dhe detyrimet që qeveria shqiptare është e angazhuar në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik, ka vendosur në kushte të diskriminuese nxënësin E. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, duke i mohuar të drejtën për arsim.

Në këtë kuadër, veç faktit që nxënësit i është refuzuar e drejta për regjistrimin në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë, atij nuk i është ofruar asnjë alternativë tjetër, e parashikuar në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si p.sh. regjistrimi në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme. Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se refuzimi për të regjistruar nxënësin E. L. në klasën e 9 (nëntë) nga ana e shkollës dhe ZVAP Divjakë, nuk është një veprim i mbështetur në një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Komisioneri nëpërmjet emisionit investigativ STOP²¹, në TV Klan, u njoh me faktin që, pas denoncimit nga ana e familjarëve të nxënësit E. L., lidhur me mosregjistrimin e tij në klasën e 9 (nëntë), ishte arritur që nëpërmjet ndërhyrjes së MAS-it, ai të rikthehej

21. <https://www.youtube.com/watch?v=0p-ueSnzfU>

dhe të vijonte të ndiqte mësimin në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë.

Pavarësisht faktit të rikthimit në mësim të nxënësit E. L., Komisioneri konstatoi se Drejtoria e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë dhe ZVAP Divjakë, nëpërmjet mosregjistrimit të tij në klasën e 9 (nëntë), i kanë mohuar të drejtën për të ndjekur arsimin bazë të detyrueshëm.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se Drejtoria e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë dhe ZVAP Divjakë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë diskriminuar subjektin ankues, nxënësin E. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, në të drejtën e tij për tu arsimuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të nxënësit E. L., në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë dhe ZVAP Divjakë.

ZVAP Divjakë dhe Shkolla e Mesme të Bashkuar “Mihal Nako” Fierseman, Divjakë, të marrin masa që në të ardhmen të mbahet në vëmendje mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.

P. S., NË CILËSINË E PRINDIT TË FËMIJËS G. S., KUNDËR MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT²² DHE ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR MALËSI E MADHE²³

Ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të djalit të tij, G. S., nga ana e MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe caktimin e një mësuesi ndihmës për të në vitin shkollor 2023-2024.

Vendim Nr. 119, datë 05. 07. 2023

FAKTET: P. S. ka parashtruar ndër të tjera se djali i tij, G. S., është i regjistruar në Shkollën 9-vjeçare “Kol Maçi”, në Rapsh, Hot, Malësi e Madhe. Ai vuan nga çrregullime të spektrit autik dhe për këtë arsye ka nevojë të asistohet nga mësues ndihmës. Në cilësinë e prindit, i është drejtuar disa herë institucioneve arsimore me kërkesë dhe është informuar se djalit të tij i është caktuar mësuesi ndihmës, por konkretisht sipas tij, mësuesi nuk është paraqitur asnjëherë në shkollë. Sakaq, ankuesi thekson se i është drejtuar sërish institucioneve arsimore përgjegjëse por nuk ka marrë më përgjigje.

Në vijim, sqaron se është vënë në dijeni nga ana e ZVAP Malësi e Madhe se për djalit e tij është emëruar një mësues ndihmës, por që nuk ka pranuar ushtrinë këtë detyrë. Gjithashtu, sipas P. S., në shkollën ku ndjek mësimin djali i tij, është edhe një fëmijë tjetër të cilit i është caktuar mësuesi ndihmës. Në këtë kuptim, ankuesi pretendon se djali i tij, G. S., është vënë në pozita diskriminuese nga ana e MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe, për shkak të aftësisë së kufizuar, si rezultat i faktit që nuk i është caktuar mësues ndihmës.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të djalit të tij, G. S., nga ana e MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe caktimin e një mësuesi ndihmës për të në vitin shkollor 2023-2024.

^{22.} Në vijim do t'i referohemi me akronimin MAS.

^{23.} Në vijim do t'i referohemi me akronimin ZVAP Malësi e Madhe.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e R.Sh, neni 57, neni 116
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Ligji nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*
- Neni 1 i Ligjit 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, neni 3 neni 7, Neni 17
- Ligji nr. 69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, nenet 64/3 dhe 65/3,
- Ligji nr. 18/2017 *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*,
- Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3,
- Ligji nr. Nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe neneve 93-96
- Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave *“Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar*
- Udhëzim nr.12, datë 10.06.2021 *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “mësues për shqipërinë””*

KONKLUZIONE: MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe, informuan Komisionerin ndër të tjera se: *“...janë marrë të gjitha masat për vlerësimin e nevojave të të nxënësve dhe emërimin e një mësuesi ndihmës për nxënësin G. S., por duke mbajtur në konsideratë që diagnostikimi i nxënësit është bërë gjatë vitit shkollor dhe procedura për përzgjedhjen e një mësuesi ndihmës ka nisur në gjysmë të vitit shkollor dhe nuk ka pasur asnjë pranim nga kandidatët në portal...për vitin shkollor 2023-2024, ka filluar marrjen dhe do të angazhohet maksimalisht që nxënësit G. S. t'i ofrohet një mësues ndihmës dhe i specializuar, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021, i ndryshuar, në funksion të përmbushjes së qëllimit kryesor të këtij institucioni që është arsimimi dhe ofrimi i një trajtimi të specializuar për nxënësit e kësaj kategorie...”*

Referuar informacionit të sipërcituar, Komisioneri vuri në dispozicion të ankuesit kopje të shkresave të MAS dhe ZVAP Malësi e Madhe.

Në përgjigje përsa më lart, ankuesi kërkoi nga Komisioneri mbylljen e ankesës duke qenë se problemi i parashtruar në të mori zgjidhje.

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesë të paraqitur nga P. S., kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe, pasi është arritur qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

Rekomandohet Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe, në fillim të vitit shkollor 2023-2024, të njoftojnë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me masat e marra në ofrimin e mësuesit ndihmës për nxënësin G. S.

A.B E PËRFAQËSUAR NGA F.L.²⁴ KUNDËR MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT (MAS)

Nxënëses i është mohuar e drejta e nje testi të veçantë në provimet e Maturës Shtetërore dhe rezultati i mohimit të kësaj të drejte ka sjellë penalizimin e saj me notë jo kaluese në këto provime.

Vendim nr. 235, datë 16.11.2023

FAKTET: Subjekti ankues, informon se: “Unë F.L, nëna e A.B po ju drejtohem për diskriminimin që i është bërë vajzës sime. Vajza ime (me Sindromën Down), nxënëse e Gjimnazit me Orientim Gjuhësor “Shejnaze Juka”, Shkodër, ka punuar jo me programin e zakonshëm lëndor, por me Plan Edukimi Individual (PEI) në lëndët: Matematikë, Letërsi, Gjuhë e huaj dhe Psikologji-Qytetari, gjatë viteve shkollore 2019-2022. Në bazë të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, neni 84 “Ndjekja e shkollës, vlerësimi i nxënësit me AK”, pika 7, 8, 9 e kësaj rregulloreje përcakton se këto nxënës nuk mund t’i nënshtrohen testit të zakonshëm në provimet e Maturës Shtetërore, por kërkon test specifik sipas përcaktimeve ligjore.

Pavarësisht kërkesës që është bërë nga shkolla dhe nga unë si prind për hartimin e testit të veçantë, nxënëses i është mohuar kjo e drejtë dhe rezultati i mohimit të kësaj të drejte ka sjellë penalizimin e saj me notë jo kaluese në provimet e mëposhtme: Letërsi, Lëndë me zgjedhje (Psikologji-Qytetari), si dhe më pas edhe pse e vlerësuan me notë kaluese në provimet e vjeshtës në mënyrë fiktive, rezultati përfundimtar ishte vlerësimi me notën mesatare 6, e si rezultat nuk iu dha e drejta për të vazhduar studimet në degën e Italianistikës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, (ku kërkohet mesatarja 6.5) sepse aty ka shfaqur aftësi për të mësuar, në mënyrë

24. Referuar deklaratës datë 15.05.2023, ankuesja ka deklaruar se pranon të përfaqësohet nga znj. F.L.

25. Referuar Certifikatës Familjare datë 15.05.2023, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Bashkisë Shkodër, znj. F.L është nëna e A.B.

që të mos dekurajohet, për të ecur më tej në zhvillimin e saj emocional, intelektual e për gjithëpërfshirjen e saj në shoqëri”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ti kërkohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, që të angazhohet për ti dhënë mundësi vajzës së saj, që të vazhdojë studimet në degën e Italianistikës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Shkodrës.

Nëse nuk pranohet kjo kërkesë, përsëri për arsye të përmirësimit të saj emocional dhe intelektual, të krijohen kushtet lehtësuese të vazhdojë studimet në programe auditimi (pa kredite) në fushën e artit (Pedagogji muzikore ose Pikturë e grafikë), pasi janë të vetmet mundësi të provojë të ndjekë studimet, në varësi të aftësive që do të shfaqë. Të tjerat nuk janë të përshtatshme për të, sepse nuk ka aftësitë fizike, psikologjike e intelektuale.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokoli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;*
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;
- Ligji Nr.69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- Udhëzimi N.26, datë 25.11.2019 *“Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.*

KONKLUZIONE: Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, rezultojnë se bazuar në legjislacionin e sipërcituar, nenin 49/2 të ligjit 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, dhe nenin 84/8 të Rregullores për funksionimin e IAP-ve, duhej që MAS dhe institucionet në varësi

të saj, të merrnin masa, që nxënësja A.B me aftësi të kufizuara, ti nënshtrohej një testi në përshtatje me veçoritë e saj dhe në përputhje me njohuritë që kishte marrë gjatë procesit mësimor, pasi nxënësja A.B, të gjitha lëndët mësimore gjatë gjithë viteve të shkollimit në shkollën e mesme, i kishte zhvilluar me PEI.

Pavarësisht se maturantja A.B, në përfundim të provimeve të maturës shtetërore, është vlerësuar me nota kaluese në të gjitha lëndët, rezultatet e saj (notat) nuk tregojnë realisht arritjet mësimore të saj, pasi nxënësja gjatë viteve të shkollës ka studiuar me program mësimor të veçantë dhe jo me program mësimor si të gjithë nxënësit e tjerë dhe për këtë arsye dhe rezultatet e saj në provimet e maturës shtetërore, nuk reflektojnë njohuritë dhe arritjet që ajo ka marrë gjatë viteve të shkollës së mesme, pasi mesatarja e shkollës së mesme të ankueses ishte 6.53, ndërkohë që mesatarja e maturës shtetërore pas përfundimit të provimeve ra në 5.47.

Pavarësisht faktit që ligji 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe Rregullorja e funksionimit të IAP-ve, parashikojnë të drejtën e nxënësve me aftësi të kufizuara që të zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre, Komisioneri vlerëson se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk arriti që të japë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për moszbatimin e parashikimeve ligjore të sipërcituara lidhur me hartimin e testeve të veçanta për maturanten me aftësi të kufizuara, që gjatë procesit mësimor kishte punuar/mësuar me plane edukimi individuale.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor në fuqi, në lidhje me sigurimin e testeve të veçanta për nxënësen A.B gjatë zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore 2022. Si rezultat i moszbatimit të këtij detyrimi ligjor nga ana e MAS, ankuesja nuk ka arritur që të vlerësohet me rezultatet (notat) sipas njohurive që kishte përfituar gjatë procesit mësimor, duke i mohuar dhe të drejtën për të ndjekur arsimin e lartë.

Komisioneri vlerëson se pavarësisht se në rregulloren e maturës shtetërore 2022 është parashikuar që QSHA është institucioni përgjegjës për përgatitjen e testeve të maturës shtetërore dhe Komisioni i Maturës Shtetërore në ZVAP ka detyrën për organizimin dhe administrimin e provimeve të maturës shtetërore, është Ministria e Arsimit dhe Sportit si institucion përgjegjës i zbatimit të ligjit 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”*, i ndryshuar, që në funksion të zbatimit të politikave për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të sigurojë zbatimin e legjislacionit për hartimin e testeve të veçanta për maturantët me aftësi të kufizuara. Gjatë provimeve të maturës shtetërore 2022, MAS nuk mori masa për

zbatimin e nenit 49/2²⁵ të ligjit 69/2012, i ndryshuar dhe nenit 84/8¹⁵ të Rregullores për funksionimin e IAP-ve, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MAS, ndërkohë që pa ndryshuar aktet ligjore dhe nënligjore, gjatë zhvillimit të provimeve të maturës shtetërore 2023, MAS dhe institucionet e varësisë morën masa për hartimin e testeve të veçanta për maturantët me aftësi të kufizuara.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se moszbatimi i detyrimit ligjor për hartimin e testeve të veçanta për maturantët me aftësi të kufizuara, e ka vendosur A.B përpara një pengese reale, në raport me pjesën tjetër të maturantëve që kanë zhvilluar dhe janë përgatitur gjatë gjithë viteve të shkollimit me programet standarte të mësimin, gjë e cila ndikoi në rezultatet e kësaj maturaenteje duke e penalizuar dhe me mesataren e maturës shtetërore, duke mos u kualifikuar për ndjekjen e studimeve në arsimin e lartë.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i saj, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të A.B nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në komunikim me A.B, të marrë masa për të siguruar vazhdimin e arsimit të lartë për ankuesen.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, të marrë masa për përfshirjen e parashikimit të hartimit të testeve të veçanta për personat me aftësi të kufizuara, në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2024, e në vitet në vazhdim.

25. "Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre".

M. H, I CILI PRETENDON DISKRIMINIMIN E DJALIT TË TIJ O. H, NGA GJIMNAZI “ALEKS BUDA”, TIRANË, PËR SHKAK “AFTËSISË SË KUFIZUAR

Ankuesi pretendon diskriminim të fëmijës së tij me AK që në ditën e parë në këtë gjimnaz nuk janë marrë parasysh të drejtat që rrjedhin nga Konventa Ndërkombtare për të Drejtat e Fëmijëve me aftësi të kufizuar. Nuk janë zbatuar programet e posaçme për këto persona, ngelet në klasë pa dëshirën ose pa miratimin e prindërit të fëmijës. Nuk është marrë asnjë rrethanë lehtësuese vetëm që ky fëmijë të largohet nga shkolla.

Vendim nr.67, datë 18. 03 . 2024

FAKTET: Subjekti ankues, pretendon se, djali ka qenë i regjistruar fillimisht në shkollën 9- vjeçare “Dhora Leka” dhe nuk ka patur asnjë problem. Më pas e ka regjistruar në Gjimnazin “Aleks Buda”, Tiranë vetëm me urdhër të Zyrës Vendore Arsimore. Ankuesi pretendon që në ditën e parë në këtë gjimnaz nuk janë marrë parasysh të drejtat që rrjedhin nga Konventa Ndërkombtare për të Drejtat e Fëmijëve me aftësi të kufizuar. Nuk janë zbatuar programet e posaçme për këto persona, ngelet në klasë pa dëshirën ose pa miratimin e prindërit të fëmijës. Nuk është marrë asnjë rrethanë lehtësuese vetëm që ky fëmijë të largohet nga shkolla.

Fëmija është me sidromën down dhe në këtë gjimnaz nuk ka program që t’i përshtatet fëmijës. Nga gjimnazi ankuesi është informuar që me 45 mungesa nxënësi ngelet ose përjashtohet, gjë të cilën e ka kundërshtuar, pasi këta fëmijë nuk mund të kenë të njëjtin trajtim me fëmijët e tjerë. Mësues të ndryshëm e kanë pyetur ankuesin, përse e sjellë në shkollë apo vetëm që ta heqësh nga shtëpia, duke i thënë që djalin në shkollë e mbajnë vetëm për humanizëm.

Në shkollë, në vazhdimësi fëmijës i janë bërë teste me shkrim në kundërshtim me nevojat e fëmijës, por mësuesja kujdestare në fillim është shprehur që e vlerëson dhe i vendos notat që meriton pasi ai ka programin “PEI” të veçantë. Ankuesi pretendon

që nuk ka marrë pjesë në miratimin e tij, nuk është thirrur asnjëherë që të diskutojë me mësuesit që fëmija mund të ngelet dhe në klasë. Vetëm në datë 13-14 shtator është thirrur nga Drejtoresha dhe në prezencë të mësuesve është informuar se djali është ngelës në 6 lëndë, përfshirë dhe lëndën e frengjishtes, nuk shkruan dhe nuk flet. Në dijeni të ankuesit në programin “PEI” përfshihet dhe gjuha frengjisht.

Në lidhje me këtë çështje ankuesi i është drejtuar Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), por ka marrë përgjigje vetëm nga ZVA, ndërsa MAS nuk i ka kthyer përgjigje. Si prindër ata dëshirojnë që djali të vazhdojë shkollën dhe pse nuk do Drejtoresha, pa e ditur arsyen pse nuk dëshiron të vazhdojë shkollën si përsëritës, por as klasën e XI. Arsyen e vetme është që t'a largojnë djalin nga shkolla dhe pa shpjeguar arsyen.

Në këtë kuptim, ankuesi kërkon nga Komisioneri:

- të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar të djalit të tij;
- marrjen e masave për të ndrequr situatën diskriminuese nëpërmjet zbatimit të të drejtave që rrjedhin nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, trajtimin në shkollë njëloj si të tjerët dhe këta fëmijë të mos ngelin në klasë.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollin 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”;
- Ligji Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.15, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;

- VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.
- Udhëzimi Nr.14, datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave.
- Rregullore “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga MAS me Urdhërin Nr. 31, datë 28.01.2020,
- Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021,
- Plani i ri Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025

KONKLUZIONE: Mbështetur në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit, referuar vërtetimit për përfitimim për shkak të aftësisë së kufizuar, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, O. H, është vlerësuar me dy diagnoza, e para çrregullim i spektit autik dhe e dyta aftësia e kufizuar intelektuale (prapambetje mendore).

Ky fakt është evidentuar dhe në Planit të Edukimit Individual (PEI) për vitin mësimor 2022-2023 të vënë në dispozicion nga ana e Gjimnazit “Aleks Buda”, ku nxënësi O. H, është vlerësuar si person me aftësi të kufizuar, diagnostifikuar me sindromën down dhe prapambetje mendore të rëndë.

Ndërkohë referuar Vlerësimit të ecurisë për periudhën e III-të, Komisioni i Gjimnazit, ka dal në konkluzionin se duke iu referuar rezultateve të arritura gjatë periudhës prill-qershor, është kostatuar se nxënësi O. H, ka paraqitur regres.

Në kushtet e mësipërme është rekomanduar:

- Që nxënësi të frekuentojë shkollën është e domosdoshme trajtimi i nxënësit me planin PEI edhe në vitin e ardhshëm dhe vendosja e objektivave minimale duke i përshtatur me ritmet e zhvillimit të tij dhe mundësitë që ai ka.
- Të analizohet fakti nëse nxënësi me AK mund të përballojë frekuentimin e shkollës prej një harku kohor katër orë në ditë, referuar mundësive të tij.

Nxënësi O. H, ka përfunduar klasën e X (dhjetë) gjatë vitit shkollor 2022-2023 dhe ka rezultuar ngelës në gjashtë lëndë mësimore. Gjatë gjithë vitit shkollor, referuar informacionit të administruar, është vlerësuar nga komisioni multidisiplinar dhe është trajtuar me mësues ndihmës me 18 (tetëmbëdhjet) orë mësimore në ditë.

Sa më sipër Komisioneri konstaton se nxënësi O. H, rezultoi ngelës në të gjitha lëndët që nuk ishte ndjekur me plan PEI në periudhën e parë të vitit, përveç lëndës së matematikës në të cilën rezultoi ngelës gjithashtu edhe pse ishte ndjekur me plan PEI.

Gjithashtu Komisioneri konstatoi diferencë në trajtim, sa i takon ndjekjes me plan PEI, ndërmjet nxënësit O. H, dhe nxënësit S.D, edhe pse për nxënësin O. H, ZVAP Tiranë kishte rekomanduar normë të plotë, 18 orë mësimore.

ZVAP Tiranë, nuk duhet të mjaftohet me faktin që të vihet në lëvizje vetëm në momentin kur i adresohet problematika, por duhet të përdorte të gjithë mekanizmat dhe kapacitetet e saj për të ndjekur, identifikuar por dhe kontribuar më shumë në lidhje me këta nxënës që situata të tilla mos të përsëriten. Komisioneri vlerëson se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve sa i takon rastit objekt shqyrtimi nuk ka qenë efektiv.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazit “Aleks Buda” Tiranë, nxënësi O. H, djali i ankuesit M. H, është vendosur në pozita të pafavorshme duke rezultuar ngelës në klasë në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi për nxënësit me aftësi të kufizuar

Komisioneri gjatë shqyrtimit të ankesës konstatoi:

- Nxënësi O. H, djali i ankuesit M. H, është trajtuar në mënyrë të diferencuar, të padrejtë, të pafavorshme krahasuar edhe me nxënësit tjerë me AK, duke e ngelur në klasë në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi për nxënësit me aftësi të kufizuar.
- Nxënësi O. H, ishte në vijimësi dhe nuk mund të diskutohet më regjistrimi i tij në këtë Gjimnaz, pasi ishte e njëjta situatë si një vit më parë, arsyetim i cili u mbështet gjatë procedurës hetimore dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë.
- Gjimnazi, nuk ka marrë asnjë masë paraprake për të diskutuar apo dhënë zgjidhje situatës së krijuar, por ka vendosur ndërprerjen e arsimit për nxënësin O. H, në kundërshtim me parashikimet ligjore për arsimin parauniversitar.

- Zyra Vendore e Arsimit Tiranë, nuk rezulton që të ketë dërguar dosjen e plotë me rekomandimet konkrete në lidhje me nxënësin O. H, nuk rezulton të ketë përdorur të gjithë mekanizmat dhe kapacitetet e saja për të ndjekur, identifikuar por dhe kontribuar më shumë në lidhje me nxënësit me AK, që situata të tilla mos të përsëriten.
- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, nuk ka rishikuar në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave të saj, secilin rast të personave me AK në shkollat respektive, dhe rast pas rasti të propozojë masa konkrete sipas nevojave të këtyre personave.

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se O. H, djali i ankuesit M. H, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazit “Aleks Buda” Tiranë, është vendosur në pozita të pafavorshme duke rezultuar ngelës si dhe duke iu refuzuar regjistrimi në klasën e X (dhjetë), pranë Gjimnazit “Aleks Buda”, për vitin shkollor 2023/2024, edhe pse ishte nxënës i shkollës.

VENDIM: Konstatimin e diskriminimit të nxënësit O. H, në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazit “Aleks Buda” Tiranë.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, të rishikojë në mënyrë periodike nëpërmjet strukturave të saj, secilin rast të nxënësve me aftësi të kufizuar në shkollat respektive, dhe rast pas rasti të propozojë masa konkrete sipas nevojave të këtyre personave sipas legjisllacionit në fuqi.

Gjimnazi “Aleks Buda”, Tiranë të marrë masa që të ndalojë dhe të mospërsërisë në të ardhmen praktika të ngjashme me rastin e nxënësit O. H.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Gjimnazi “Aleks Buda” Tiranë, të marrin masa që në të ardhmen të mbahet në vëmendje nga ana e tyre, mbështetja më e fuqishme në eliminimin e të gjitha barrierave dhe përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor publik.

KREU III

VENDIME NË FUSHËN E PUNËSIMIT

47

N. Z, KUNDËR: QENDRËS SHËNDETËSORE QESARAT²⁶ DHE OPERATORIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, DREJTORIA RAJONALE VLORË,

Subjekti ankues, ka pretenduar se nëpërmjet transferimit, është vënë në pozita diskriminuuese pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar dhe moshës së tij, duke mos marrë në konsideratë kontributin e tij për 32 vite punë, si dhe ka kërkuar nga Komisioneri të ndalohet diskriminimi ndaj tij, duke e rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, në Qendrën Shëndetësore Qesarat.

Vendim nr. 250 , datë 21. 12 . 2021

FAKTET: Subjekti ankues, N. Z është me profesion infermier, dhe prej 32 vitesh ushtron profesionin pranë Qendrës Shëndetësore Qesarat, Tepelenë.

Që prej vitit 1986 është trajtuar me statusin e invalidit të punës, dhe si rezultat i posedimit të këtij statusi ai punon me orar të reduktuar, 2 orë pune në ditë më pak se norma e përcaktuar.

Nëpërmjet Urdhrit të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, të Dejtorisë Rajonale Vlorë, ankuesi është transferuar nga Qendra Shëndetësore Qesarat në Qendrën Shëndetësore Lutfinjë, për të cilën shprehet se është rreth 50 km larg vendbanimit të tij.

Ai nuk është dakordësuar me këtë transferim, pasi bazuar në largësinë në të cilën ndodhet Qendra Shëndetësore Lutfinjë, e ka të pamundur lëvizjen në këtë distancë, për shkak të sëmundjes. I ndodhur nën trysni dhe pamundësi zgjedhjeje, ka pranuar këtë transferim edhe për shkak të situatës së tij familjare, pasi përkujdeset për babain

26. Hequr dorë nga pretendimet kundrejt këtij subjekti, në seancën dëgjimore të datës 08.10.2021 (referuar procesverbalit të seancës dëgjimore).

90 vjeç, si dhe vëllain me prapambetje të thellë mendore, i cili është nën kujdestarinë e bashkëshortes së tij.

Ankuesi është shprehur se ai është zëvendësuar me një punonjëse, infermiere tjetër, e cila nuk ka eksperiencën e tij në punë.

Po ashtu, ankuesi ka pretenduar se i është refuzuar leja vjetore, duke u shprehur se i është bërë presion të pranojë transferimin, në mënyrë që t'i miratohet leja vjetore dhe pas momentit të transferimit të tij, i kanë miratuar vetëm gjysmën e lejes vjetore.

Ankuesi ka pretenduar se nëpërmjet transferimit, është vënë në pozita diskriminuese pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar dhe moshës së tij, duke mos marrë në konsideratë kontributin e tij për 32 vite punë, si dhe ka kërkuar nga Komisioneri të ndalohet diskriminimi ndaj tij, duke e rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, në Qendrën Shëndetësore Qesarat.

Ligji / Legjislacioni i zbatueshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollin 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
- Ligji nr. 44/2015 *“Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* (i ndryshuar
- Ligji Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*;
- Ligji Nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*;
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar;

Komentit të Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, të Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, (miratuar në Sesionin e 19 (14 Shkurt – 9 mars 2018),

KONKLUZIONE: Komisioneri ndërmori të gjithë hapat procedural parashikuar në LMD për shqyrtimin e kesaj ankese përfshirë seancën degjimore si dhe inspektimin pranë ambjentëve të DROSHKSH Vlorë i cili kishte si objekt të tij marrjen e

informacionit drejtëpërdrejtë nga përfaqësues të këtij Institucioni, si dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u mbajt procesverbali, nëpërmjet të cilit provohet të jetë shprehur vullneti i titullarit të DROSHKSH Vlorë për rikthimin e ankuesit në QSH Qesarat, brenda muajit dhjetor 2021, si dhe për dërgimin në ditët në vijim, në rrugë postare të dokumentacionit të kërkuar nga Komisioneri.

Ankuesi paraqiti para KMD-së kërkesën për t'u tërhequr nga vijimi i shqyrtimit të ankesës së tij kundrejt DROSHKSH Vlorë, pas zotimit të DROSHKSH Vlorë, për të rikthyer në QSH Qesarat në muajin shkurt 2022, pasi konsideron se ky ishte dhe qëllimi për të cilin kishte iniciuar procedurën hetimore pranë KMD-së.

Një fakt i tillë është konfirmuar nga ana e DROSHKSH Vlorë, nëpërmjet e-mailit datë 17.12.2021, drejtuar Komisionit, lidhur me qëndrimin e këtij institucioni për rikthimin e ankuesit në qendrën e punës QSH Qesarat, brenda muajit shkurt 2022.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, DROSHKSH Vlorë, ka reaguar pozitivisht pas kërkesës së Komisionerit, duke marrë masa konkrete për rikthimin e subjektit ankues në vendin e tij të mëparshëm të punës, në QSH Qesarat.

VENDIM: Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës për shkak se subjekti është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale (DROSHKSH) Vlorë, të informojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me rikthimin e ankuesin në vendin e punës QSH Qesarat, brenda muajit shkurt 2022.

